



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 560 Akti

Nr. 560 Vendimi
Tiranë, më 14.9.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Firdes Shuli	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datën 9.9.2022 dhe 14.9.2022, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Julian Xhengo**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Julian Xhengo, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Julian Xhengo është subjekt i rivlerësimit, për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.6.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Julian Xhengo do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Firdes Shuli dhe Olsi Komici. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016.

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara: (i) nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33, të ligjit nr. 84/2016; (ii) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.

4. Me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Julian Xhengo, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Xhensila Pine. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti deklaroi në rrugë elektronike në datën 27.7.2022 se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

5. Me vendimin nr. 2, datë 26.7.2022, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh prej relatores së çështjes me rezultatet e hetimit dhe me provat e grumbulluara për të tria kriteret, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Julian Xhengo; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

6. Në datën 26.7.2022, dërguar përmes postës dhe marrë nga subjekti më 28.7.2022, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se data 5.9.2022; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 6.9.2022, subjekti i rivlerësimit, pasi ishte njohur me aktet e dosjes në datën 29.7.2022, dorëzoi në protokoll në datën 6.9.2022 prapësimet e tij dhe dokumentacionin shoqërues mbi rezultatet e hetimit administrativ kryesisht.

8. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, me vendimin nr. 3, datë 7.9.2022, trupi gjykues vendosi kalimin në seancë dëgjimore.

9. Në datën 9.9.2022, u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

10. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces administrativ kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, me qëllim garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

11. Parashikimet e pikës 2, të nenit 179/b, të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, në nenin 4, pika 5 dhe nenin 52, pika 1, të tij, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve thelbësore që përfaqësojnë elementet e një procesi sa më objektiv mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

12. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr.84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

13. Referuar vendimit nr. 2/201721 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

Vlerësimi i pasurisë

14. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit Julian Xhengo dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë në datën 27.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit Julian Xhengo është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2006, me nr. indeksi *** dhe ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private 2006 – 2017.

15. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Julian Xhengo, ka konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

16. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Julian Xhengo, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklarinimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shpresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46

të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative; (v) sugjerime të vëzhguesit ndërkombëtar sipas nenit 49 pika 11, të ligjit nr. 84/2016.

17. Hetimi administrativ, në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur në deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV) dhe në deklaratën *Vetting*; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklaratimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim vërtetimin ose jo të deklaratimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

18. *Llogari bankare e pagës në Bankën Kombëtare Tregtare me nr. ***. Bashkëlidhur vërtetimi i datës 24.1.2017. Vlera: 10.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga ILDKPKI-ja¹ dhe dokumentacionit të administruar nga Komisioni² u vërtetua se deklarimi i subjektit është i saktë.

19. *Llogari e pagës në “Credins Bank”, nr. ***. Bashkëlidhur vërtetimi i datës 20.1.2017. Vlera: 6.594,74 lekë. Pjesa takuese: 100 %.*

Nga verifikimi i të dhënave të administruara nga ILDKPKI-ja dhe nga Komisioni³ u vërtetua se deklarimi i subjektit është i saktë.

20. *Automjet “Mercedes-Benz”, tipi “220 CDI”. Burimi: të ardhura nga shitja e automjetit të mëparshëm dhe kredi në shumën 500.000 lekë e marrë në Bankën Kombëtare Tregtare. Vlera: 980.000 lekë. Bashkëlidhur kontratat nr. ***, datë 26.12.2016 dhe nr. ***, datë 26.12.2016, si dhe kontrata e kredisë lidhur më 8.2.2016. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika për këtë pasuri.*

Hetimi i Komisionit për këtë pasuri

21. Gjatë hetimit administrativ, nga aktet e administruara⁴, rezultoi se:

- Sipas certifikatës së pronësisë, datë 3.11.2016 (klubi automobilave në Itali), mjeti me nr. shasie ***, tip “Mercedes Benz”, figuron në pronësi të *** SRL.

- Sipas faturës në datën 11.11.2016, *** i shtetases M. Zh. këtë mjet me targa ***, vit prodhimi 2011, në shumën 9.500 euro dhe sipas deklaratës doganore, datë 12.11.2016, detyrimi doganor rezulton në shumën 494.809 lekë. Sipas drejtorisë së doganave, urdhër çlirimi figuron në emër të shtetases M. Zh. Pra, vlera totale e shpenzuar nga shitësja është në shumën 1.779.874⁵ lekë.

- Sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 26.12.2016, shtetasi Julian Xhengo i ka blerë shtetases M. V. Zh. automjetin në shumën 980.000 lekë, e cila do të shlyhet me regjistrimin e mjetit. Subjekti e regjistroi mjetin në emër të tij, sipas lejes së qarkullimit në datën 27.12.2016 dhe e ka deklaruar në DPV-në për vitin 2016.

- Kontrata e shitjes parashikon se: *“Lidhja dhe përfundimi i kësaj kontrate është propozuar nga shitësi, sipas paragrafit të parë të nenit 665 të Kodit Civil në datën 9.11.2016, duke vërtetuar*

¹Shihni: aneks 4/2, aneks 4/5 në dosjen ILDKPKI.

²Shihni shkresën nr. *** prot., datë 7.6.2021 të BKT-së dhe shkresën nr. *** prot., datë 3.6.2021, të ISSH-së, në dosjen e Komisionit.

³Shihni: shkresën nr. *** prot., datë 21.7.2021, të “Credins Bank”; shkresën nr. *** prot., datë 3.6.2021, të ISSH-së, aneks 19, në dosjen ILDKPKI.

⁴Shihni aneks 4/4 dhe aneks 30 në dosjen ILDKPKI, shkresën nr. *** prot., datë 3.6.2021, të DPSHTRR-së dhe dokumentet bashkëngjitur; shkresën nr. *** prot., datë 8.6.2021, të MD (RNSH) në dosjen e Komisionit.

⁵Kursi i këmbimit 1 euro = 135.27 lekë, Banka e Shqipërisë, datë 31.12.2016.

propozimin dhe ka qenë i lidhur me këtë propozim deri në momentin e pranimit nga ana e blerësit. Propozimi i shitësit është kryer, sipas nenit 665/2 të Kodit Civil dhe përgjigja e blerësit ka ardhur sot në datën që ky akt noterial mban”.

22. Nga përmbajtja e kontratës duket se: (i) shitësja M. Zh. i ka propozuar blerësit Juljan Xhengo shitjen e mjetit që në datën 9.11.2016 (dy dite më parë nga dita që ka blerë mjetin me fature të datës 11.11.2016) dhe ky ka qenë i lidhur me këtë propozim, deri në datën 26.12.2016, kur e bleu mjetin të zhdoganuar; (ii) mjeti është blerë rreth dy herë më ulët se vlera e paguar nga pala shitëse për blerjen e këtij mjeti dhe pagesën e shpenzimeve doganore.

23. Gjatë hetimit iu kërkua subjektit të japë sqarime sa i takon marrëdhënies së tij me shtetasen M. Zh., si dhe faktit përse mjetin e ka blerë rreth 1.8 herë më lirë se shpenzimet e kryera nga shitësja vetëm një muaj e gjysmë muaj më parë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se nuk e njeh personalisht dhe nuk e ka takuar shtetasen M. Zh., por ka biseduar me vajzën e saj dhe kontratën e shitblerjes te noteri nuk e ka nënshkruar në prani të shitëses, pasi noteri e kishte marrë më parë nënshkrimin e saj në banesë për shkak të gjendjes shëndetësore. Sa i takon faktit që mjeti është blerë më lirë, shpjegoi se M. R. vajza e M. Zh. e kishte nxjerrë në shitje me çmim 1.200.000 lekë, mjetin që vëllai i saj e kishte blerë në Itali për nënën e tyre, e cila sapo ishte sëmurur dhe prandaj donte ta shiste, pasi i duheshin të holla për qëllime kurimi. Për këtë arsye, kanë rënë dakord për çmimin e shitjes prej 9.800.000 lekësh, duke bërë pagesën e plotë dhe jo pjesë-pjesë, si dhe duke mbajtur parasysh dhe numrin prej 300.000 km që kishte bërë makina. Gjithashtu, subjekti sqaroi se nuk ka dijeni për rrethanat në të cilat djali i shtetasen M. Zh. e ka blerë këtë mjet në Itali. Sa i takon kohës dhe mënyrës së kalimit të shumës të shitësi, deklaroi se shumë prej 980.000 lekësh ia ka dhënë *cash* shtetasen M. R., pasi ka bërë regjistrimin e automjetit në pronësinë të tij në DRSHTRR-në Tiranë.

24. Në mbështetje të shpjegimeve, subjekti paraqiti disa dokumente shkresore⁶, nga verifikimi i të cilave rezultoi se sipas kartelës klinike M. Zh. është shtruar në spital më 20.11.2016 dhe ka dalë më 1.12.2016. Në datën 26.12.2016, ajo e shiti mjetin. Sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 31.3.2022, shtetasja M. R. deklaroi se e ndjera M. Zh. (nëna e saj), ka pasur në pronësi mjetin të zhdoganuar në datën 12.11.2016, i blerë nga vëllai i saj A. Zh. për t’ia dhuruar nënës, e cila më 20.11.2016 pësoi trombozë dhe u shtrua në spital. Për shkak të shpenzimeve dhe rrethanave mjeti nuk u regjistrua në emër të saj dhe për të përballuar shpenzimet për kurim edhe me dakordësinë e vëllait kanë vendosur ta shesin me çmimin fillestar prej 1.200.000 lekësh. Pas shumë personave që u paraqiten, ia shitën shtetasit Julian Xhengo për shumë 980.000 lekë, për arsye se shuma u duhej me urgjencë, shumë të cilën e ka marrë nga blerësi pas regjistrimit të mjetit.

25. Pas verifikimeve të kryera nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi të subjektit me shtetasit M. Zh., M. R. dhe A. Zh., apo të dhëna për përfshirje të shitëseve në veprimtari të krimin të organizuar⁷.

Në lidhje me burimin e krijimit të automjetit

26. Përpara se të analizoheshin burimet, në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në provat shkresore dhe rrethanat e analizuara më sipër, Komisioni nuk e gjeti të justifikuar objektivisht dhe financiarisht blerjen e mjetit në çmimin 980.000 lekë dhe ka vlerësuar që si vlerë e paguar për blerjen e tij të konsiderohet shuma 1.779.874 lekë (çmimi fillestar i blerjes në Itali prej 9.500 euro dhe pagesa e detyrimit doganor 494.809 lekë, përkatësisht në datat 11 dhe 12 nëntor

⁶Shihni kontratën e shitblerje nr. ***, datë 26.12.2016.; kthim përgjigje e Spitalit Rajonal Durrës datë 29.3.2022 shoqëruar me kartelën klinike për shtetasen M. Zh.; deklaratë noteriale nr. ***, datë 31.3.2022, të shtetasen M. R.

⁷Shihni shkresat: nr. *** prot., datë 14.2.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. *** prot., datë 11.2.2022, të Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Fier; nr. *** prot., datë 7.2.2022, të Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe nr. *** prot., datë 8.2.2022, të SPAK-ut; nr. *** prot., datë 1.6.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; dhe nr. *** prot., datë 3.6.2022, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

2016). Në DPV-në e vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim të ardhura nga shitja e automjetit të mëparshëm dhe kredi në shumën 500.000 lekë e marrë në Bankën Kombëtare Tregtare, analizuar si vijon:

27. Në analizë të burimit të ardhurat e deklaruara nga shitja e automjetit të mëparshëm, pas shqyrtimit të akteve në dosje⁸, rezultoi se:

27.1. Sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 3.2.2016, subjekti ia ka shitur shtetasit H. Q. Xh., mjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, në shumën 4.500 euro, shitje të deklaruar në DPV-në e vitit 2016.

27.2. Automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, ishte blerë nga subjekti, sipas kontratës nr. ***, datë 12.5.2010, nga shtetasi K. K. K. në shumën 6.500 euro. Në DPV-në e vitit 2010 subjekti ka deklaruar: (i) blerjen e mjetit me burim të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Golf” dhe shtesa nga kursimet; (ii) pakësuar gjendja *cash* nga shitja e mjetit “Volkswagen Golf”, me targa ***, në vlerën 6.000 euro.

27.3 Shitja e automjetit tip “Golf”, me targa ***, është bërë sipas kontratës së shitblerjes⁹ nr.***, datë 2.12.2009, në shumën 6.000 euro. Në DPV-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar: (i) shitur automjet tip “Golf Volkswagen”, për shumën 6.000 euro; (ii) shuma 6.000 euro *cash*.

27.4. Sa i takon blerjes se automjetit tip “Golf” me targë ***, në DPV-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar blerjen në shumën 500.000 lekë, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit. Në dokumentet e paraqitura nga subjekti në ILDKPKI në vitin 2016, rezultoi se e ka regjistruar mjetin në vitin 2009, pra, dy vjet më vonë nga blerja e tij. Gjatë procesit të rivlerësimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me të ardhurat që kanë shërbyer si burim krijimi për mjetin me targa ***, të paraqesë kontratën e blerjes së këtij mjeti, si dhe të shpjegojë rrethanat në të cilat mjeti me targa ***, i blerë në vitin 2007, është regjistruar në vitin 2009.

27.5. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti shpjegoi se burim krijimi ka qenë kredia konsumatore e marrë në “Raiffeisen Bank”, në datën 13.4.2007, në shumën 600.000 lekë dhe se në DPV-në e vitit 2007, ka deklaruar automjetin në fjalë, si dhe kredinë e marrë në shumën 600.000 lekë. Sa i takon regjistrimit të këtij mjeti në vitin 2009, subjekti shpjegoi arsyet e mosregjistrimit të mjetit në vitin 2007, për shkak të një marrëveshjeje me shitësin sipas së cilës, mjeti do t’i kthehej atij në rast të ndonjë defekti të rendë. Sipas tij, fakti që në DPV-në e vitit 2007 e ka deklaruar blerjen e këtij mjeti, tregon se realisht blerja është bërë në vitin 2007. Gjithashtu, ka shpjeguar se deklarimi i çmimit prej 500.000 lekësh ka qenë lapsus, pasi vlera e saktë ka qenë 530.000 lekë.

Në mbështetje të sqarimeve të tij, subjekti paraqiti disa dokumente shkresore¹⁰ nga verifikimi i të cilave u konstatua se shtetasi B. Z. i ka shitur subjektit mjetin “Golf Volkswagen” me targa ***, në çmimin prej 530.000 lekë dhe se kjo shumë ka si burim kredinë e marrë në datën 13.4.2007, në shumën 600.000 lekë, pra, ai ka burim të ligjshëm.

27.6. I pyetur për arsyet e shitjes së këtij mjeti me një çmim më të lartë se ai i blerjes së saj, si dhe për pagesën e tatimit në burim mbi të ardhurat e fituara nga shitja e këtyre mjeteve, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka shpjeguar se për automjetin tip “Golf”, me targa ***, blerë në vlerën 530.000 lekë, ka kryer disa shpenzime dhe kjo ka qenë arsyeja që është shitur 6.000 euro.

⁸Shihni: aneks 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së; shkresën nr. *** prot., datë 16.2.2022, të DPSHTRR-së; shkresën nr. *** prot., datë 8.6.2021, të MD (RNSH), në dosjen e Komisionit.

⁹Shihni dokumentet bashkëlidhur shkresës nr. *** prot., datë 11.2.2022, të ILDKPKI-së, në dosjen e Komisionit.

¹⁰Shihni: kontratë kredie konsumatore të datës 13.4.2007, në “Raiffeisen Bank”; kontratën e shitjes nr. ***, datë 6.1.2009; deklaratën noteriale nr. ***, datë 29.3.2022, të shtetasit B. Z.

27.7. Për shtetasit në cilësinë e palës blerëse apo shitëse të mjeteve të sipërpërmendura nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi apo përfshirje në veprimtari të krimit të organizuar¹¹.

27.8. Në përfundim të analizës së dokumenteve dhe deklarimeve të mësipërme, duke i paraqitur mjetet në renditje kronologjike sipas kohës së blerjes së tyre, ka rezultuar se:

i) Automjeti tip “Volkswagen Golf”, me targa ***, blerë në vitin 2007, në shumën 530.000 lekë ka si burim kredinë bankare në “Raiffeisen Bank”, në shumën 600.000 lekë, pra, është përfituar me burim të ligjshëm. Automjeti është shitur në datën 2.12.2009, në shumën 6.000 euro, pra, më shumë nga çmimi i blerjes, por meqenëse subjekti nuk ka provuar me dokumentacion shpenzimet e kryera për përmirësimin e këtij mjeti, në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga shitja janë konsideruar të barabarta me vlerën që ka shërbyer për blerjen e mjetit, pra, në vlerën 530.000 lekë.

ii) Automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, blerë në datën 12.5.2010, në shumën 6.500 euro¹², ka si burim shitjen e mjetit tip “Volkswagen Golf”, me targa ***, në vlerën 6.000 euro. Shuma 530.000 lekë dhe jo 6.000 euro është konsideruar si gjendje *cash* në fund të vitit 2009 dhe është përfshirë në analizën financiare të vitit 2010, si e ardhur/burim i ligjshëm për blerjen e mjetit në datën 12.5.2010. Nga analiza financiare, për periudhën 1.1.2010-12.5.2010, ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të blerë mjetin në shumën 6.500 euro, për shkak të një balance negative në vlerën 118.101 lekë.

iii) Shuma prej 4.500 euro përfituar nga shitja e mjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa *** është përfshirë si e ardhur/burim i ligjshëm për blerjen e mjetit objekt verifikimi.

28. Në analizë të burimit kredi në shumën 500.000 lekë e marrë në Bankën Kombëtare Tregtare, rezulton se sipas kontratës së kredisë bankare¹³ në datën 8.2.2016, me kredithënës Banka Kombëtare Tregtare dhe kredimarrësit Julian Xhengo, dorëzanës shtetasi K. R. O., subjektit i është dhënë një kredi në shumën 500.000 lekë. Në nenin 2 (objekti i kredisë) të kësaj kontrate, parashikohet se kjo shumë do të përdoret për rregullim shtëpie. Ndërkohë që, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se kjo kredi ka shërbyer si burim krijimi për blerjen e automjetit objekt verifikimi. Subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë fakt, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka sqaruar se *përshkrimi i objektit të kredisë në kontratë ka qenë destimin i vetë bankës, pasi ai ka paraqitur kërkesë kredie për makinë dhe së qëllimi nuk ka qenë për rregullim shtëpie. Pas interesimit të tij, punonjësit e bankës e kanë informuar se BKT-ja nuk ka patur ndonjëherë “produkt bankar” kreditim për blerjen e automjeteve të përdorura, pasi gjithmonë bankat orientohen në dhënien e qirave financiare (leasing) për financimin për blerje automjeti*. Sipas subjektit, në deklaratën *Vetting* ka deklaruar përdorimin dhe qëllimin e kredisë për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”. Në mbështetje të shpjegimeve, subjekti paraqiti dokumente shkresore lëshuar nga BKT¹⁴, me të cilat ajo ka konfirmuar kredinë në shumën 500.000 lekë, lëvruar në datën 9.2.2016, me datë maturimi më 9.2.2021. Në këto dokumente ndodhet dhe kërkesa e bërë nga subjekti në momentin e aplikimit të kredisë, sipas së cilës qëllimi i marrjes së kredisë është blerja e një automjeti.

29. Me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor, Komisioni ka kryer analizën financiare për subjektin dhe familjen e tij të origjinës së tij për periudhën 1.1.2016-12.11.2016¹⁵ (për shkak se kanë qenë në të njëjtin trung familjar), nga e cila ka rezultuar se ata kanë pasur të ardhura të ligjshme për të mundësuar blerjen e mjetit në vlerën 1.779.874 lekë. Por, duke iu referuar

¹¹Shihni shkresat e prokurorive ku subjekti ka ushtruar detyrën e shkresës në dosjen e Komisionit dhe informacionin e dërguar me shkresë përcjellëse nga SPAK-u.

¹²Ky mjet është shitur në datën 3.2.2016, në vlerën 4.500 euro, e cila është më e vogël se çmimi i blerjes së mjetit “Mercedes-Benz” në vitin 2010 dhe për këtë arsye nuk ka lindur asnjë detyrim pagese e tatimit në burim.

¹³Shihni shkresën nr. *** prot., datë 7.6.2021, të BKT-së me dokumentacionin bashkëngjitur në dosjen e Komisionit; shihni aneks 4/6 vërtetim dhe kontratë kredie bankare datë 8.2.2016, paraqitur nga subjekti dhe aneks 8, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁴Shihni kopje të praktikës së kredisë së datës 8.2.2016 dhe vërtetimin nr. *** prot., datë 8.4.2021, të BKT-së.

¹⁵Data e zhdoganimit të mjetit.

burimeve të deklaruara prej subjektit, shitja e automjetit të mëparshëm në vlerën 4.500 euro dhe kredia në vlerën 500.000 lekë (e cila u konsiderua e përdorur tërësisht për blerjen e mjetit), të dyja këto burime nuk e mbulojnë vlerën prej 1.779.874 lekësh.

30. Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me pasurinë autoveturë me targa ***, subjektit i kaloi barra e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me konstatimet: duket se:

- Subjekti është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë vlerën reale të blerjes së automjetit në DPV-në e vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting*, pasi:

i) deklarimet e subjektit mbështetur edhe nga deklaruesja M. R., sipas së cilit shitja e mjetit të subjekti në vlerën 980.000 lekë u bë për shkak të sëmundjes së shitëses M. Zh. (74 vjeç në momentin e blerjes së mjetit) dhe nevojës së saj për lekë, bien në kundërshtim me parashikimin në kontratën e shitjes nr. ***, datë 26.12.2016, sipas së cilës, *shitësja M. Zh. i ka propozuar blerësit Julian Xhengo shitjen e mjetit që në datën 9.11.2016, pra, dy ditë para blerjes nga ana e saj në datën 11.11.2016, propozim të cilin ai e pranoi ditën e lidhjes së kontratës;*

ii) është i pajustificuar financiarisht dhe objektivist blerja e mjetit nga subjekti rreth dy herë më ulët se vlera e paguar nga pala shitëse një muaj e gjysmë më parë. Për rrjedhojë, në analizën financiare vlera e konsideruar si shpenzim është 1.779.874 lekë (çmimi fillestar i blerjes në Itali prej 9.500 euro dhe pagesa e detyrimit doganor 494.809 lekë, përkatësisht në datat 11 dhe 12 nëntor 2016).

- Mbetet e paqartë nëse kredia e marrë në datën 9.2.2016 ka shërbyer rreth 10 muaj më vonë për blerjen e mjetit me targa ***, sipas kontratës së datës 27.12.2016, sikurse subjekti pretendon apo ka shërbyer për rregullim banese, sikurse është përcaktuar në kontratën e kredisë bankare në datën 8.2.2016, pasi:

i) është i pavërtetuar me ndonjë dokument shkresor fakti që kredia në shumën 500.000 lekë, është përdorur për blerjen e mjetit;

ii) ka mospërputhje të kontratës së kredisë dhe kërkesës për aplikim nga ana e subjektit, në lidhje me qëllimin e përdorimit të kredisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

31. Në parashtrimet e tij, subjekti ka kundërshtuar të gjitha pikat e barrës së provës dhe konkretisht:

31.1. Subjekti ka kundërshtuar faktin që ka porositur mjetin që në datën 9.11.2016, duke pretenduar se propozimi i parashikuar në kontratën e shitjes nuk i takon kësaj marrëdhënieje dhe se subjekti nuk e ka vënë re kur e ka nënshkruar kontratën. Sipas tij, ky përpilim ka mbetur i pandryshuar nga ndonjë tjetër akt noterial i përdorur më parë prej noterit dhe për këtë i referohet edhe faktit se paragrafi që parashikon propozimin është shkruar me germa më të vogla se pjesa tjetër e kontratës. Në funksion të këtij pretendimi, subjekti ka paraqitur disa argumente sipas së cilave: (i) shitësja nuk mund t'i ketë propozuar atij shitjen e mjetit në datën 9.11.2016, pra, dy ditë para se ajo vetë ta blinte atë, ndërkohë që vetë nuk ishte pronare e mjetit; (ii) shitësja nuk ka pasur qëllim ta blinte dhe ta shiste mjetin për shkak edhe të moshës së saj, por ka qenë djali i saj që ka pasur qëllim t'i blejë një mjet nënës, si dhe ka qenë sëmundja e shitëses që i ka detyruar ata ta shisnin mjetin; (iii) subjekti nuk ka biseduar kurrë me shitësen M. Zh., por me vajzën e saj; (iv) është e pakuptimtë që subjekti, nëse do të ishte porositës i këtij automjeti, të priste një muaj e gjysmë pas porosisë për të bërë veprimet noteriale për mjetin.

Në vijim të pretendimeve të tij, subjekti kundërshton vlerën e përfshirë nga Komisioni në analizën financiare, duke kërkuar që si e tillë të konsiderohet vlera e përcaktuar me vullnetin e palëve në kontratë, prej 980.000 lekësh. Subjekti sjell në vëmendje dy vendime të Kolegjit¹⁶,

¹⁶Vendimet nr. 11/2019 dhe nr. 5/2019, të Kolegjit.

sipas së cilave vlera e shitjes së sendeve e pasqyruar në akt noterial përbën vlerë të plotë provuese. Subjekti sqaron se nuk ka pasur arsye të deklarojë një vlerë më të ulët sesa ajo realja, por mund të kishte deklaruar vlerën 1.200.000 lekë, pasi në DPV-në e vitit 2016 ka deklaruar *cash* vlerën 200.000 lekë, të cilën nuk e ka përdorur për asgjë tjetër dhe fare mirë mund të deklaronte se këtë shumë e ka përdorur për blerjen e automjetit.

32. Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, Komisioni çmoi se pretendimet dhe argumentet e subjektit, jo vetëm që mbeten në nivel deklarativ, por janë të pabazuara, referuar fakteve dhe rrethanave si vijojnë:

- Pavarësisht se paragrafi që tregon propozimin e shitjes së mjetit që në datën 9.11.2016 është shkruar me germa më të vogla se pjesa tjetër e kontratës, kontrata e shitjes nr. ***, datë 26.12.2016, është një akt shkresor me fuqi të plotë provuese, e cila vërteton se palët kanë qenë në një marrëveshje/marrëdhënie të përbashkët (propozim-pranim propozimi) për blerjen e mjetit që në datën 9.11.2006, përderisa kontrata nuk është kundërshtuar me ndonjë provë tjetër shkresore dhe për sa kohë nuk është pretenduar se nuk është nënshkruar prej palëve.

- Subjekti nuk paraqiti dhe nuk ka bërë asnjë përpjekje për të vërtetuar pretendimin e tij me ndonjë kërkesë drejtuar noterit që ka përpiluar kontratën, i cili nga ana e tij mund dhe duhet të vinte në dispozicion aktin e redaktuar përpara kontratës së shitjes së mjetit, prej të cilit subjekti pretendon se është marrë me *copy paste* paragrafi që bën fjalë për propozimin e palës shitëse. Për më tepër, në këtë paragraf është shënuar data 9.11.2016, që është, pikërisht, dy dite përpara se shitësja të fitonte pronësinë me fature shitje të datës 11.11.2016. Po kështu, mbetet i pabesueshëm pretendimi që kontrata është firmosur pa u vënë re apo pa u lexuar, sikurse subjekti pretendon, sidomos në kushtet kur subjekti ka kërkuar parashikimin në kontratë të kushtit që çmimi i shitjes do të likuidohet pasi të regjistrohej mjeti.

- Pretendimi i subjektit, se blerja e mjetit sa $\frac{1}{2}$ e çmimit që shitësja kishte shpenzuar një muaj e gjysmë më parë ka qenë për shkak se i duheshin të holla për qëllime kurimi, është i pabesueshëm, pasi periudha 45-ditore nga dita e blerjes së mjetit nga znj. M. Zh., deri ditën që e bleu subjekti, konsiderohet një periudhë mjaft e shkurtër kohore për të bërë të besueshëm faktin që pas negociatave me disa persona u gjend përfundimisht një blerës, i cili e bleu mjetin sa $\frac{1}{2}$ e shumës së shpenzuar nga pala shitëse. Për më tepër, shtetasja M. Zh. rezulton të jetë shtruar në një spital shtetëror, çka nuk justifikon shitjen e mjetit sa $\frac{1}{2}$ e vlerës së shpenzuar, për nevoja kurimi.

- Bëhet i pabesueshëm fakti i blerjes së mjetit në emër të shtetasës M. Zh., në një periudhë që ajo ka qenë në pamundësi për ta drejtuar vetë, për shkak të moshës 74 vjeçare, me gjasa edhe me probleme shëndetësore, për shkak të sëmundjes, sipas diagnozës që është përcaktuar pak ditë pasi bleu mjetin, ndërkohe që mjeti mund të blihej në emër të vajzës M. R., e cila kujdesej për të.

- Sa i takon pretendimit se shitësja në datën 9.11.2016 nuk ka qenë pronare dhe sipas subjektit një propozim i tillë prej saj do të ishte *null*, subjekti i referohet Vendimit Unifikues 1/2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku citohet: "... *thelbi i fitimit të së drejtës së pronësisë me titull të prejardhur, qëndron në faktin që pronari i ri e fiton të drejtën e pronësisë mbi sendin vetëm në qoftë se tjetërsuesi është pronar i tij*". Sa i takon kësaj reference, Komisioni vlerëson se problematika në rastin konkret nuk qëndron te momenti i fitimit të pronësisë, por te momenti i bisedimeve midis palëve, i cili kuptohet qartësisht nga parashikimi në kontratë se *lidhja dhe përfundimi i kësaj kontrate është propozuar nga shitësi, sipas paragrafit të parë të nenit 665 të Kodit Civil në datën 9.11.2016, duke vërtetuar propozimin dhe ka qenë i lidhur me këtë propozim deri në momentin e pranimin nga ana e blerësit. Propozimi i shitësit është kryer sipas nenit 665/2 të Kodit Civil dhe përgjigjja e blerësit ka ardhur sot në datën që ky akt noterial mban*. Pra, kontrata tregon qartësisht faktin se palët kanë qenë në bisedime që në datën 9.11.2016 dhe i referohet një dispozite konkrete të Kodit Civil,

nenit 665/2, i cili parashikon, pikërisht propozimin pa afat: “Kur nuk është caktuar afat, propozuesi është i lidhur me propozimin e bërë, gjer në kohën që zakonisht apo sipas rrethanave, është e nevojshme që këtij t’i arrijë përgjigjja e palës tjetër”. Sa i takon faktit që shitësja nuk ka qenë pronare e mjetit në datën 9.11.2016 (të cilin e bleu në datën 11.11.2016), Komisioni çmon se kjo nuk përbën pengesë për propozimin që i është bërë subjektit prej saj apo prej djalit të saj, banues në Itali, dy ditë përpara se të finalizohet blerja e mjetit.

- Sa i takon pretendimit se nëse subjekti do të ishte porositës i këtij automjeti, ishte e pakuptime të priste një muaj e gjysmë pas porosisë për të kryer veprimet noteriale për mjetin, Komisioni nuk e sheh të pakuptimtë këtë fakt.

33. Bazuar në sa më sipër, në përfundim të procesit Komisioni nuk gjeti arsye bindëse të për të justifikuar objektivisht, ligjërisht dhe financiarisht blerjen e mjetit nga subjekti sa ½ e shumës që pala shitëse kishte shpenzuar vetëm një muaj e gjysmë më parë, ashtu sikurse nuk gjeti shkaqe objektive që të justifikojnë humbjen se konsiderueshme të pësuar nga pala shitëse. Për rrjedhojë, krijoi bindjen se çmimi real i paguar nga subjekti për blerjen e mjetit ka qenë të paktën 9.500 euro/1.285.065 lekë¹⁷ plus 494.809 lekë zhdoganimi. Në këto rrethana, subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë çmimin e blerjes së mjetit prej 950.000 lekësh në kontratën e shitjes, në DPV-në e vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting*, fakt i cili merr një peshë specifike të posaçme në kushtet kur të ardhurat e deklaruara si burim për blerjen e mjetit nga shitja e automjetit në vlerën 4.500 euro dhe kredi në shumën 500.000 lekë, nuk mjaftojnë për të justifikuar shumën në total 1.779.874 lekë.

34. Sa i takon çmimit të blerjes, pavarësisht pretendimit që me të drejtë subjekti parashtron se kontrata e shitjes përbën provë shkresore, në kushtet kur u vërtetua se deklarimi i çmimit në këtë kontratë nuk është i saktë, për efekt të kryerjes së analizës financiare, si shpenzim për blerjen e automjetit është konsideruar shuma 1.779.874 lekë dhe si datë e pagimit të saj, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, është konsideruar data e regjistrimit të mjetit më 26.12.2016 (sipas parashikimit në kontratë). Me qëllim kryerjen e analizës financiare përfundimtare, për të verifikuar mundësitë financiare për blerjen e mjetit, është bërë i domosdoshëm vlerësimi i periudhës/periudhave, kur subjekti ka jetuar me ose pa familjen prindërore. Subjekti në parashtrimet e tij ka vijuar të këmbëngulë që duhet të analizohet më vete nga familja prindërore për të gjitha vitet, pasi ka jetuar financiarisht i pavarur gjatë gjithë kohës. Por, duke qenë se ky pretendim mbetet në nivel deklarativ dhe, për sa kohë subjekti ka qenë në të njëjtin trung familjar dhe ka banuar në të njëjtën ndërtesë me prindërit, analiza financiare përfundimtare është bërë e përbashkët me prindërit nga fillimi i detyrës në vitin 2007 deri në fund të vitit 2015. Duke marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit në DPV-në e vitit 2016, por dhe gjatë procesit të rivlerësimit, se gjatë këtij viti (2016) ka shkuar për të banuar me qira në adresën: rruga “***”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë, në pronësi të shtetases I. B., analiza financiare e këtij viti në fund të të cilit është paguar shuma 1.779.874 lekë, është kryer vetëm për subjektin dhe bashkëjetuesen e tij.

35. Nga kjo analize e datës 26.12.2016, pasqyruar si në tabelën vijuese, duket se ata nuk kanë pasur mundësi për pagimin e shumës 1.779.874 lekë¹⁸, për shkak të një balance negative prej në shumën 397.603 lekë.

Përshkrimi	26.12.2016
Pasuri	2 048 102
Blerë automjet tip “Mercedes-Benz 220 CDI”, targa ***	1 779 874
<i>Ndryshimet e likuiditeteve</i>	268 228
Gjendja e likuiditeteve	294 156

¹⁷Kursi i këmbimit 1 euro = 135.27 lekë, datë 31.12.2016, Banka e Shqipërisë.

¹⁸Kjo balancë negative krijohet për shkak të pakësimit të të ardhurave të prindërve dhe hallës, të cilët nuk janë përfshirë në këtë analizë.

Të ardhura dokumentuar	3 101 470
Të ardhura të subjektit nga paga	1 104 305
Të ardhura të bashkëjetueses E.	865 440
Kredi personale në BKT disbursuar më 9.2.2016	500 000
Nga shitja e mjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa ***	631 725
Shpenzime	1 450 971
Shpenzime jetese për 2 persona	463 743
Shpenzime udhëtimi TIMS	93 989
Shpenzime qiraje (sipas p. standard)	360 000
Shlyer kredi bashkëjetuesja tek F. B. (marrë më 4.4.2014)	44 238
Komisione për kreditë bankare 2% të shumës së kredisë	10 000
Paguar këste kredie bankare në BKT	100 774
Paguar Karta e Kreditit e subjektit në “Credins Bank”	102 894
Shpenzime shkollimi për vajzën	25 333
Shpenzime mobilimi sipas p. standard	250 000
Mundësia për kursime	-397 603

36. Në lidhje me paqartësitë për qëllimin dhe përdorimin e kredisë së marrë në BKT në shkurt të vitit 2016 për blerjen e automjetit, subjekti ka dhënë të njëjtat sqarime sikurse gjatë hetimit administrativ, duke iu referuar vërtetimit të lëshuar nga BKT-ja, sipas së cilit kërkesa për marrjen e kredisë ka qenë me qëllim blerjen e mjetit. Në vijim, argumenton se qëllimi i pasqyruar në kontratën e kredisë “për rregullim banese” është një destinim i vendosur nga vetë banka dhe i ndryshëm nga kërkesa e paraqitur prej tij. Sipas tij, kredia konsumatore, në dallim nga kredia hipotekore mund të përdoret lehtësisht për shumë arsye të tjera, pavarësisht objektit të kontratës duke nënvizuar se ... *sqaroj se bankat nuk ofrojnë produkte bankare për financimin e blerjes së automjeteve pasi ky produkt kanalizohet nëpërmjet leasingut ose kreditimit për blerjen e automjeteve të reja jo nga bankat, pretendime të cilat qëndrojnë. Sa i takon faktit se është i pavërtetuar me ndonjë dokument shkresor përdorimi i shumës së kredisë prej 500.000 lekësh për blerjen e mjetit, subjekti deklaron se nuk mund të ketë dhe të ekzistojë ndonjë dokument i tillë, pasi edhe tërheqja e kredisë nga banka edhe pagesa e automjetit janë kryer në cash, ndërkohë që për individët nuk ka qenë detyrim ligjor kryerja e pagesës me bankë. Subjekti konkludon se ... përdorimin e kredisë si burim krijimi për blerjen e automjetit e kam deklaruar në DPV-në e vitit 2016, që përbën provë në kuptim të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, por edhe në deklaratën Vetting, nga fillon edhe procesi i rivlerësimit.*

37. Në analizë të prapësimeve dhe në një vlerësim tërësor të fakteve dhe provave, në përfundim, Komisioni i konsideroi të bazuara pretendimet e subjektit dhe e konsideroi të gjithë kredinë në shumën 500.000 lekë, si burim për blerjen e mjetit objekt verifikimi.

DETYRIMET FINANCIARE

38. Në deklaratën Vetting subjekti ka deklaruar kredi në Bankën Kombëtare Tregtare, në shumën 500.000 lekë e marrë më 9.2.2016. Shuma e detyrimit 420.295,99 lekë. Bashkëlidhur vërtetimi Nr. *** prot., datë 12.1.2017 dhe kontrata e kredisë e lidhur më 8.2.2016 (trajtuar në paragrafin 28 të këtij vendimi). Në DPV-në e vitit 2016, subjekti e ka deklaruar shumën e shlyer në 72.137,99 lekë dhe gjendjen e detyrimit të mbetur në shumën 427.862,05 lekë. Nga lëvizjet e llogarisë së subjektit në BKT është evidentuar se gjatë vitit 2016 ka paguar 10 këste në shumën totale prej 100.774 lekësh. Nga kjo shumë kanë rezultuar disa depozitime të kryera nga dy shtetas E. D. dhe E. O., për të cilët, pas verifikimeve të kryera, nuk rezultuan problematika. Gjithashtu, nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi apo përfshirje të shtetasve E. D. dhe E. O. në veprimtari të krimit të organizuar. Shuma e pagesave të kryera për shlyerjen e kredisë në BKT, në total 100.774 lekë, është përfshirë si shpenzim në analizën financiare të

subjektit për vitin 2016, nga ku ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shlyerjen e kësteve të kredisë gjatë këtij viti për shkak të një balance pozitive.

39. *Overdraft i hapur në Bankën Kombëtare Tregtare në datën 20.1.2017, me limit përdorimi në vlerën 250.000 lekë. Shuma e detyrimit: 0 (zero) lekë. Bashkëlidhur vërtetimi i datës 24.1.2017. BKT-ja¹⁹ ka konfirmuar se subjekti ka nënshkruar kontratën e overdraftit me limit në vlerën 250.000 lekë, në datën 20.1.2017, të cilin nuk e ka përdorur deri në datën 26.1.2017, kur ka plotësuar dhe dorëzuar deklaratën *Vetting*. Deklarimi i subjektit përputhet me informacionin e përcjellë nga BKT-ja.*

Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur

40. Bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit, znj. E. B., ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar se ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj dhe ka deklaruar pasuritë:

41. *Apartament banimi, me sipërfaqe 100 m², ndodhur në rrugën “***”, Korçë. Burimi i krijimit: trashëgimi. Vlera: 2.200.000 lekë. Pjesa takuese: 25 %. Bashkëngjitur certifikata e pronësisë dhe vendimi nr. ***, datë 17.3.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri.*

41.1 Nga të gjitha aktet e administruara²⁰, pas një hetimi të plotë në lidhje me origjinën, mënyrën e fitimit të bashkëpronësisë nga subjekti, investime të kryera në pasuri, etj., në përfundim të hetimit administrativ, nuk u konstatuan problematika/dyshime/kontribute të subjektit në krijimin e pasurisë, pasi: (i) u vërtetua se kjo pasuri është përfituar në mënyrë të ligjshme nga babai i bashkëshortes së subjektit i ndjeri A. T. B. në vitin 2005, pra, para se subjekti të fillonte bashkëjetesën me E. B., si dhe para fillimit të detyrës së tij si prokuror, datë 4.10.2006; (ii) personi i lidhur E. B., ka fituar bashkëpronësinë mbi këtë pasuri, për shkak të trashëgimisë ligjore në emër të babait të saj, sipas vendimit nr. ***, datë 17.3.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

42. *Tokë “arë”, me sipërfaqe 1.120 m² e ndodhur në M.-Korçë. Sipas vlerës së miratuar prej 100 lekë/m², në 112.000 lekë. Pjesa takuese: 12.5 %. Burimi i krijimit: trashëgimi. Bashkëngjitur certifikata e pronësisë dhe vendimi nr. ***, datë 17.3.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. ILDKPKI-ja, nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri. Nga të gjitha aktet e nga aktet e administruara²¹ pas një hetimi të thellë në lidhje me origjinën, mënyrën e fitimit të bashkëpronësisë nga subjekti, investime të kryera në pasuri, etj., në përfundim të hetimit administrativ, nuk u konstatuan problematika/dyshime/kontribute subjektit në krijimin e pasurisë, pasi u vërtetua se kjo pasuri është përfituar në mënyrë të ligjshme, sipas ligjit 7501 “Për tokën”, nga familja prindërore e personit të lidhur me kryefamiljar babain e bashkëshortes së subjektit, të ndjerin A. T. B., me vdekjen e të cilit është çelur trashëgimia ligjore sipas vendimit nr. ***, datë 20.1.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.*

43. *Tokë “arë”, me sipërfaqe 690 m² e ndodhur në M.-Korçë. Sipas vlerës së miratuar prej 100 lekë/m² në 69.000 lekë. Pjesa takuese: 25 %. Burimi i krijimit: trashëgimi. Bashkëngjitur certifikata e pronësisë dhe vendimi nr. ***, datë 17.3.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematikë në lidhje me këtë pasuri. Nga të gjitha aktet e administruara²², pas një hetimi të thellë në lidhje me origjinën, mënyrën e fitimit të*

¹⁹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 7.6.2021, të BKT-së me dokumentacionin bashkëngjitur në dosjen e Komisionit.

²⁰Shihni aneks 4/8 dhe 28, në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën nr. *** prot., datë 9.7.2021, të ASHK-së në dosjen e Komisionit.

²¹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 9.7.2021, të ASHK-DV Korçë me dokumentet bashkëngjitur, në dosjen e Komisionit dhe aneks 4/10 certifikatë pronësie pasurie nr. ***, zk. ***; aneks 28, në dosjen e ILDKPKI-së.

²²Shihni shkresën nr. *** prot., datë 9.7.2021, të ASHK-së me dokumentet bashkëngjitur, në dosjen e Komisionit dhe aneks 4/9, certifikatë pronësie pasurie nr. ***, z. k. ***, AMTP-së nr. ***, aneks 28, në dosjen e ILDKPKI-së.

bashkëpronësisë nga subjekti, investime të kryera në pasuri, etj., në përfundim të hetimit administrativ, nuk u konstatuan problematika/dyshime/kontribute të subjektit në krijimin e pasurisë, pasi kjo pasuri është përfituar sipas ligjit nr. 7501 “Për tokën” dhe e ka origjinën në AMTP-në nr. ***, lëshuar familjes së T. B. (gjyshi i bashkëjetueses së subjektit).

44. *Garazh me sipërfaqe 35 m², i ndodhur në Korçë. Numri i pasurisë ***. Vlera: 500.000 lekë. Pjesa: 25 %. Burimi i krijimit: trashëgimi. Bashkëngjitur certifikata e pronësisë dhe vendimi nr. ***, datë 17.3.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.* ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematikë në lidhje me këtë pasuri. Nga aktet e administruara²³, pas një hetimi të thellë në lidhje me origjinën, mënyrën e fitimit të bashkëpronësisë nga subjekti, investime të kryera në pasuri, etj., në përfundim të hetimit administrativ, nuk u konstatuan problematika/dyshime/kontribute të subjektit në krijimin e pasurisë, pasi: (i) u vërtetua se kjo pasuri është përfituar në mënyrë të ligjshme nga babai i bashkëshortes së subjektit, i ndjeri A. T. B., në vitin 2005, pra, para se subjekti të fillonte bashkëjetesën me znj. E. B., si dhe para fillimit të detyrës së tij si prokuror në datën 4.10.2006; (ii) personi i lidhur E. B. ka fituar bashkëpronësinë mbi këtë pasuri, për shkak të trashëgimisë ligjore në emër të babait të saj, sipas vendimit nr. ***, datë 17.3.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

45. *Llogari bankare e pagës në “Intesa Sanpaolo Bank”. Vlera: 179,76 lekë. Pjesa takuese: 100%.* ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri.

Nga verifikimi i dokumentacionit shkresor dhe të dhënave bankare²⁴, u konstatua se deklaratimet personit të lidhur janë të sakta.

Verifikime në lidhje me një banesë të deklaruar nga subjekti në DPFD-në e vitit 2006

46. Në deklaratën para fillimit të detyrës 2006, subjekti në rubrikën e pasurive ka deklaruar *shtëpi banimi, 1-katëshe me sip. 120 m². Shtëpia është e pahipotekuar, në proces legalizimi. Adresa: ***, Tiranë, të blerë nga të ardhurat që kanë nxjerrë prindërit nga biznesi i vogël në vitin 1999, në vlerën 2.500.000 lekë, si dhe ka deklaruar pjesën takuese 25%.*

Në DPV-të e mëvonshme dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka kryer deklaratime për këtë pasuri. I pyetur gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se kjo banesë është në pronësi të babait E. Xh. dhe se deklarimi i bashkëpronësisë në 25 % të kësaj banese në DPV-në për vitin 2006, ka qenë për shkak të moskuptimit të saktë të deklaratës, pasi duke qenë se ishin 4 anëtarë në familje ka menduar se është korrekte qenia bashkëpronar në ¼ pjesë. Por, sipas tij, ai nuk ka qenë realisht bashkëpronar në këtë pasuri dhe kjo ka qenë arsyeja e mosdeklarimit të pasurisë në DPV-të në vijim. Sa i takon mosdeklarimit të pasurisë në deklaratën *Vetting*, subjekti i është referuar faktit se në datën 24.1.2017, kur është plotësuar kjo deklaratë, nuk ka qenë në një përbërje familjare me prindërit nga të cilët është ndarë në 18.10.2016.

Në lidhje me këtë pasuri, gjatë hetimit administrativ, rezultoi se:

47. Sipas certifikatës së pronësisë lëshuar në datën 7.7.2017, nga ZVRPP-ja Tiranë, pasuria nr. ***, me adresë rruga ***, Tiranë, e llojit truall me sipërfaqe 214.2 m² nga të cilat 115 m² ndërtesë, figuron në pronësi të E. A. Xh. (babai i subjektit). Sipërfaqja kartelës së pasurisë, ndërtesa është godinë banimi 3 kate, e regjistruar në datën 20.8.2013, sipas lejes së legalizimit nr. ***, datë 31.5.2012²⁵.

48. Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se në momentin e marrjes së detyrës në vitin 2006, ka pasur si adresë banesën e prindërve të tij, *rruga “****”, ***, nr. ***, Tiranë.* Në këtë

²³Shihni shkresën nr. *** prot., datë 9.7.2021, të ASHK-DV Korçë me dokumentet bashkëngjitur në dosjen e Komisionit, aneks 4/11 certifikatë pronësie, kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 4.3.2005; aneks 28, në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁴Shihni shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2021, të “Intesa Sanpaolo Bank”, shkresën nr. *** prot., datë 3.6.2021, të ISSH-së, në dosjen e Komisionit dhe aneks 19 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁵Shihni aneks 36 në dosjen ILDKPKI dhe shkresën nr. *** prot., datë 11.2.2022, të ILDKPKI-së, në dosjen e Komisionit.

banesë ka banuar në periudhën shkurt 2008 – janar 2016 dhe vazhdon të jetojë nga qershori 2017, si dhe ka qenë në përbërje familjare²⁶ me prindërit e tij E. Xh. dhe M. Xh. nga momenti i fillimit të detyrës deri më 17.10.2016.

49. Sipas certifikatës familjare të datës 29.7.2020, subjekti ka qenë pjesë përbërëse e familjes prindërore deri në datën 17.10.2016 (më 26.1.2017 është plotësuar deklarata *Vetting*). Sipas nenit 3, pika 13, *“Person i lidhur” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe Komisionerin Publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit, shtetasi E. A. Xh. është person i lidhur. Sipas nenit 32 të ligjit, pika 1 e tij, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, duhet të deklaronte pasurinë objekt verifikimi në deklaratën *Vetting*, deklarim që nuk e ka kryer.*

50. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka pretenduar se: (i) prindërit e tij nuk kanë qenë persona të lidhur, për shkak se nuk kanë qenë në certifikatën familjare së bashku me të në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* dhe kjo ka qenë arsyeja e mosdeklarimit të prindërve në këtë deklaratë; (ii) babai dhe nëna nuk janë persona të tjerë të lidhur, duke sjellë në vëmendje vendimet nr. 15/2019, nr. 20/2020 dhe nr. 21/2020, të Kolegjit, pasi nuk ka asnjë marrëdhënie interesi mes tij dhe prindërve që të rrjedhë nga një marrëdhënie interesi pasuror apo biznesi (huadhënie, huamarrje, dhurim etj.), përveç faktit që ai dhe familja e tij banojnë në banesën e tyre.

51. Pavarësisht nga sa pretendon subjekti, prindërit e tij kanë qenë në të njëjtin trung familjar me subjektin gjatë periudhës së rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, janë persona të lidhur me subjektin, në kuptim të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016. Po kështu, subjekti ka deklaruar pjesën takuese prej 25% në këtë pasuri në DPFID-në për vitin 2006 (pra, bashkëpronësi me prindërit) dhe ka jetuar e vijon të jetojë në këtë banesë (me përjashtim të vitit 2016, kur pretendon të jetë shkëputur për të jetuar me qira). Në përfundim të hetimit administrativ nga Komisioni u vlerësua që prindërit e subjektit plotësojnë kriteret për të qenë persona të tjerë të lidhur në kuptim të pikës 14, të nenit 3, të ligjit. Për të gjitha këto arsye, është bërë e domosdoshme kryerja e veprimeve hetimore në lidhje me këtë pasuri, jo vetëm me qëllim verifikimin e burimit të ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e saj, por edhe heqjen e çdo dyshimi në lidhje me një bashkëpronësi të mundshme të subjektit të padeklaruar apo kontribute të tij në investim.

52. Në funksion të këtyre qëllimeve, nga ana e Komisionit janë kryer veprimet hetimore si vijojnë:

52.1. Me kërkesë të Komisionit, ASHK-ja²⁷ ka konfirmuar se: (i) subjekti nuk figuron aplikues për legalizimin e ndërtimeve pa leje, si dhe ASHK DV Tiranë, ka konfirmuar se nuk rezultojnë të ketë pasuri të regjistruar në emër të subjektit; (ii) shtetasi E. Xh. rezultojnë aplikues për legalizim të ndërtimeve pa leje, nr. *** prot., viti 2005, Njësia nr. ***, Tiranë dhe është pajisur me vendim legalizimi nr. ***, datë 31.5.2012, Godinë Banimi *** kate, Njësia Administrative Tiranë²⁸.

²⁶Subjekti ka bashkëngjitur certifikatën familjare të datës 29.7.2020, sipas së cilës gjendja familjare me datë 17.10.2016, përbëhet nga subjekti dhe prindërit e tij dhe gjendja familjare me datë 18.10.2016 përbëhet vetëm nga subjekti.

²⁷Shihni shkresat: nr. *** prot., datë 17.6.2021, të ASHK-Drejtoria e Përgjithshme; nr. *** prot., datë 30.6.2021, të ASHK-DV Tiranë Jug; nr. *** prot., datë 21.7.2021, të ASHK DV Tiranë Veri, në dosjen e Komisionit.

²⁸Shihni shkresën nr. *** prot., datë 25.2.2022, të ASHK-së, në dosjen e Komisionit.

52.2. ASHK²⁹ Drejtoria Vendore Tiranë Veri ka përcjellë praktikën e legalizimit të shtetasit E. Xh. për lejen e legalizimit nr. ***, datë 31.5.2012, për objektin “godinë banimi 3 kate”, ku nga aktet e dosjes rezultojnë se:

- shtetasi E. Xh., në datë 17.3.2005 ka vetëdeklaruar objektin shtëpi banimi 1 kat, me vit ndërtimit 1993, sipërfaqe e zënë 210 m², sipërfaqe ndërtimi 106.5 m²;
- sipas procesverbal konstatimi të datës 14.4.2009, të Drejtorisë Rajonale Aluizni Qarku Tiranë, objekti i vetëdeklaruar në datën 17.3.2005 nga E. Xh., rezultojnë me bazë 115 m² me sipërfaqe të përgjithshme 331 m², me 3 kate;
- sipas procesverbal verifikimi të datës 7.3.2012 të mbajtur nga specialistët pranë Drejtorisë së Aluiznit Qarkut Tiranë, objekti rezultojnë 2k+P (3k), e llojit banesë;
- sipas akt kualifikimit nr. ***, datë 7.3.2012, pasqyrohen të dhënat: parcela ndërtimore me sip. 214.5 m², baza e objektit 115 m², nr. i kateve 3, ndërtuar në pronë shtetërore;
- sipas procesverbalit, datë 11.4.2012, të mbajtur nga specialistet e ALUZINI-t Drejtoria Qarkut Tiranë, rezultojnë se nga verifikimi në terren, është konstatuar që objekti i vetëdeklaruar nga z. E. Xh., ndryshon me të dhëna të vetëdeklarimit, pasi në vetëdeklarim është 1-katëshe, ndërsa gjendja faktike është me 3 kate dhe gjatë periudhës së fotografimit ajror kati i dytë nuk ka qenë i mbuluar;
- sipas planimetrive të kateve rezultojnë: kati përdhe me sipërfaqe ndërtimi 115 m², verandë 10 m² sipërfaqe banimi 125 m²; kati i parë sipërfaqe ndërtimi dhe banimi 125 m²; kati i dytë sipërfaqe ndërtimi dhe banimi 81 m²;
- sipas kontratës kalimi të pronësisë së parcelës ndërtimore nr. ***, datë 21.3.2012, me palë shitësi *** dhe blerës E. Xh., është kryer kalimi në pronësi të parcelës ndërtimore me sipërfaqe 214.2 m², pasi blerësi ka paguar vlerën e parcelës ndërtimore;
- sipas lejes së legalizimit nr. ***, datë 31.5.2012, rezultojnë objekt banimi 3 kate në emër të z.E. Xh., me sipërfaqe parcele 214.2 m², sipërfaqe ndërtimi 115 m² dhe sipërfaqe totale banimi 331 m² me 3 kate;
- pasuria e llojit truall me sipërfaqe 214.2 m² nga të cilat 115 m² ndërtesë u regjistrua në pronësi të z. E. A. Xh. si pasuria nr. ***³⁰.

52.3. FSHU-ja³¹ konfirmuar se në emër të shtetasit E. A. Xh., identifikohen tri abonentë me kontrata furnizimi: nr. *** e hapur në datën 23.12.2011, Nr. *** e hapur në datën 23.12.2011, Nr. *** e hapur në datën 15.11.2000, në instancën Tiranë. Nga adresat e përshkruara në verifikimet e ardhura nga terreni, të tria këto kontrata ndodhen në të njëjtën adresë, “****” dhe “****”, fakt që tregon se për banesën trekatëshe janë lidhur tri kontrata për energjinë elektrike, pra, aktualisht banesa përbëhet nga tri apartamente banimi.

52.4. UKT-ja³² ka konfirmuar se në emër të shtetasit E. Xh., nuk rezultojnë asnjë e dhënë për kontrata për shërbime të regjistruara në sistem në emër të tij. I pyetur për këtë fakt, subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3 ka shpjeguar se UKT-ja³³ e ka informuar se për banesën e babait të tij, rruga “****”, sht. prv. nr. ***, është lidhur kontrata Nr. ***, me status “aktiv”, por që në sistem është hedhur gabimisht “****” në vend të “****”.

²⁹Shihni shkresat nga ASHK-DV Tiranë Veri: nr. *** prot., datë 9.6.2022 dhe nr. *** prot., datë 22.6.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

³⁰Shihni certifikatë pronësie lëshuar më 7.7.2017 dhe kartelë pasurie në aneksin 36 të dosjes së ILDKPKI-së.

³¹Shihni shkresat: nr. *** prot., datë 14.2.2022, të FSHU-së në dosjen e Komisionit, M. Xh. dhe S. M. nuk rezultojnë abonentë dhe nr. *** prot., datë 8.6.2021, në dosjen e Komisionit, Julian Xhengo dhe E. Xh. nuk figurojnë abonentë, nr. *** prot., datë 24.3.2022, të FSHU-së në dosjen e Komisionit.

³²Shihni shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2022 dhe nr. *** prot., datë 10.6.2021, të UKT-së në dosjen e Komisionit, dhe për shtetasit M. Xh., S. M., Julian Xhengo dhe E. Xh. nuk rezultojnë kontrata.

³³Shihni shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2022, të UKT-së, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, me email datë 18.5.2022.

Në lidhje me investimet dhe periudhat e investimit, kryen verifikimet si vijojnë:

53. Sipas procesverbalit, datë 22.1.2016, të ILDKPKI-së³⁴, subjekti ka deklaruar se: (i) shtëpia është blerë në vitin 1999 në vlerën 2.500.000 lekë, kur ka qenë e ndërtuar vetëm 1 kat, si dhe nuk ka dokument që vërteton blerjen, pasi pasuria ka qenë e paregjistruar. Gjatë viteve, babai i tij ka ndërtuar dy kate të tjera, ku nga kati i tretë, gjysma është verandë gjysma është papafingo; (ii) objekti është ngritur me kontributet e babait pa firmë ndërtimi dhe vlera totale për dy katet ka shkuar rreth 4.000.000 lekë; (iii) gjatë periudhës nga dalja në reformë e në vazhdim, babai i tij është trajtuar me të ardhurat për pagesë ushtarake, si dhe pension. Shtëpia është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në emrin e babait E. Xh. dhe ka dorëzuar certifikatën për vërtetim e pronësisë lëshuar në datën 7.7.2014.

54. Nga verifikimi në *geoportali*, duket se sipas fotografimeve të viteteve 1999, 2001 dhe 2007 ekziston ndërtesa me 1 kat. Sipas fotografimit të viteve 2015 dhe 2018 vërehet se ndërtesa ka pësuar ndryshime si në lartësi dhe në çati. Me qëllim evidentimin e ndryshimeve që ka pësuar ndërtesa, u kërkuan të dhëna nga ASIG-u, i cili ka informuar dhe përcjellë pamjet imazherike të territorit ku gjendet pasuria nr. ***, z. k. ***, Tiranë, sipas *ortofotove* të viteve 1994, 1999, 2001, 2007, 2015 dhe 2018, me data përkatëse të fotografimit³⁵.

55. Nga informacioni i përcjellë nga ASIG-u, rezultoi se:

- Sa i takon kuotave mbi lartësinë e ndërtesave për vitet 1994, 1999 dhe 2001, duke qenë se ASIG-u shërben foto 2D, nuk mund të nxirret kuota e lartësisë së objektit. Ndërsa, nga fotografimet e datës 2.11.1999 dhe datë 27.4.2001, duket se ekziston ndërtesa por fotografimi nuk është i qartë.

- Sa i takon kuotave sipas fotografimit të vitit 2007-2008, nga fotografimi ajror në datën 12.4.2007, duket se ndërtesa është 1-katëshe mbuluar me soletë, ndërsa sipas fotografimit ajror, datë 29.5.2015, kuotat e ndërtesës janë më të larta dhe ndërtesa duket se është trekatëshe dhe me çati të pjerrët.

- Sa i takon kuotave nga fotografimi i vitit 2018, datë 27.5.2018, duket se kanë të njëjtën lartësi me atë të vitit 2015. Pra, nga viti 2015 deri në 2018 nuk ka shtim katesh.

56. Nga fotot bashkëlidhur dosjes së legalizimit, pasuria objekt verifikimi duket të jetë nën të njëjtën çati me një banesë tjetër dhe nuk është e qartë nëse e gjithë godina përbehet nga dy pasuri të ndryshme. Ndërkohe që, sipas procesverbalit, datë 11.4.2012, të mbajtur nga specialistet e ALUZINI-t Drejtoria Qarkut Tiranë, rezultoi se nga verifikimi në terren është konstatuar që objekti i vetëdeklaruar nga E. Xh., ndryshon me të dhëna të vetëdeklarimit në: sipërfaqe parcele, sipërfaqe bazë dhe numër katesh (ndryshime të evidentuara edhe nga Komisioni). Në këto kushte, për të qartësuar situatën, me njoftimin e rezultateve të hetimit iu kërkua subjektit të paraqesë dokument që vërteton pronësinë e banesës ngjitur me banesën e babait të tij, si dhe foto aktuale të godinës vërtetuar me datën e fotografimit, ku të duken hyrjet e të dyja banesave. Në parashtrimet e tij, subjekti paraqiti: (i) certifikatë për vërtetim pronësie, kartelë pasurie, hartë treguese të regjistrimit, sipas të cilave vërtetohet se shtetasi A. B. është pronar i pasurisë nr. ***, z. k. ***, me adresë ***; (ii) 7 foto të datës 5.9.2022, ku paraqiten hyrja e banesës së shtetasit E. Xh., hyrjet në banesën e shtetasit A. B., si dhe muri ndarës i ndërmjet dy oborreve. Nga këto dokumente evidentohet se pasuria nr. *** kufizohet në veri me pasurinë nr. ***, pasuria në pronësi të babait të subjektit dhe, për rrjedhojë, Komisioni hoqi dyshimin për ndonjë investim shtesë të babait të subjektit të rivlerësimit dhe/apo të subjektit.

57. Me kërkesë të Komisionit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dhe nr. 3, subjekti shpjegoi se:

³⁴Shihni shkresën nr. *** prot., datë 11.2.2022, të ILDKPKI-së dhe dokumentacioni bashkëngjitur, në dosjen e Komisionit.

³⁵Shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.2.2022 dhe shkresën nr. *** prot., datë 21.2.2022, të ASIG-ut në dosjen e Komisionit.

- Në vitin 1999 prindërit e tij kanë blerë nga shtetasi P. Ç. një shtëpi njëkatëshe e ndodhur në zonën e ***, Tiranë (sot rruga “****”), e pa regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, për të cilën babai i tij ka lidhur aktmarrëveshje, datë 14.9.1999, për blerje në shumën 2.500.000 lekë.

- Sa i takon ndërtimit të 2 kateve të tjera të kësaj banese, ka sqaruar se kati i dytë ka filluar të ndërtohej në periudhën mars/prill të vitit 2007 dhe në vitin 2009 ka përfunduar kati i dytë dhe kati i tretë gjysmë ndërtim dhe gjysmë verandë, të cilët janë bërë tërësisht të banueshëm në vitin 2012.

- Në vijim iu kërkua të sqarojë ecurinë e punimeve për ndërtimin e shtëpisë, sipas llojit të punimeve ose sipas vlerës së shpenzuar për çdo vit, ku subjekti ka sqaruar³⁶ se në vitin 2007 janë kryer punime betoni për ngritjen e kolonave dhe hedhjen e soletës në një vlerë afërsisht 400.000 lekë. Nga shtator 2008 - maj 2009 janë kryer punime për ngritjen e të dy kateve, si dhe rregullimin e një dhome gjumi dhe një tualeti në katin e dytë, me vlerë punimesh rreth 3.100.000 lekë. Më pas, në vitet 2009-2012, kanë përfunduar punimet për katin e dytë, ndarjen me mure dhe suvatimet e brendshme të katit të tretë, i cili në atë kohë ishte i pabanueshëm, me vlerë punimesh afërsisht në shumën 700.000 lekë. Pra, në total subjekti ka deklaruar një vlerë investimi në shumën 4.200.000 lekësh për periudhën 2007 – 2012. Sa i takon mobilimit të tri kateve ka sqaruar në fund të vitit 2007 ka shpenzuar për mobilim në total shumën 947.300 lekë.

Në mbështetje të deklarimeve si më sipër, subjekti paraqiti disa dokumente shkresore³⁷.

Në lidhje me vlerën e investimeve

58. Për të përlllogaritur vlerën e investimeve, bazuar në të gjitha provat dhe faktet si më sipër, Komisioni iu referua:

58.1 Periudhës së investimeve, ku si e tillë është konsideruar:

- Kati përdhe ka qenë ekzistues i ndërtuar që në momentin e blerjes së tokës, në vitin 1999.

- Ndërtimi i katit të parë dhe të dytë ka filluar pas datës 12.4.2007, nisur nga fotografimi ajror, nga ku duket se banesa është 1 kat (ai ekzistues) dhe ka mbaruar në datën 14.4.2009, kur është hartuar procesverbali i verifikimit në terren. Nga fotografitë e banesës³⁸ në këtë datë, më 14.4.2009, duket se banesa është përfunduar, por akoma ka nevojë për punime për t’u bërë funksionale/e banueshme.

- Në datën 23.12.2011, rezulton të jenë lidhur dy kontrata për furnizimin e energjisë elektrike, çka shërben si tregues se, duke filluar nga kjo datë, të dyja katet e ndërtuara janë bërë plotësisht të banueshëm. Për këtë arsye, përfundimi i investimeve do të konsiderohet në këtë datë dhe gjatë periudhës 14.4.2009 – 23.12.2011, është konsideruar të jenë bërë kryesisht punime të brendshme.

58.2. Sipërfaqeve ndërtimore, ku si të tilla janë ato të përcaktuara te planimetritë e banesës dhe konkretisht kati i parë ka sip. 125 m² dhe kati i dytë 81 m².

58.3. Ndarjes së volumit të punimeve në vite, si vijon:

Në mungesë dokumentacionit tekniko-ligjor, apo çdo dokumentacioni tjetër, janë marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit në pyetëtorin nr. 3, të cilat informojnë se:

- për vitin 2007 janë investuar 400.000 lekë ose 10% e punimeve; shtator 2008 deri në maj 2009 janë investuar 3.100.000 lekë ose 74% e punimeve; qershor 2009 deri në dhjetor 2011

³⁶Shihni përgjigje të pyetëtorit nr. 3, paraqitur me *email* datë 18.5.2022.

³⁷Shihni dokumentet bashkëngjitur pyetëtorit nr. 2, dërguar me *email* më 3.4.2022: (i) deklaratë notoriale nr. ***, datë 8.10.2019; (ii) aktmarrëveshje, datë 14.9.1999, deklaratë notoriale datë 14.9.1999.

³⁸Këto fotografi janë gjetur nëpërmjet faqes elektronike të ASIG dhe google maps

janë investuar 700.000 lekë ose 16% e punimeve³⁹. Në bazë këtyre përlllogaritjeve, të cilat përkojnë edhe me logjikën e ndërtimit të një banese, është konsideruar se:

- deri në datën 14.4.2009 janë kryer 85% të punimeve të ndërtimit të banesës;
- pjesa tjetër, pra, 15% është kryer nga prill 2009 deri në fund të dhjetorit të vitit 2011.

Sa i takon ndarjes së sipërfaqes së ndërtimit për çdo vit, ajo është përlllogaritur duke konsideruar numrin e ditëve që i takon çdo viti/periudhe kur është ndërtuar banesa dhe duke prezumuar që për çdo ditë është ndërtuar një sipërfaqe e barabartë.

58.4. Çmimeve të EKB-së për qytetin e Tiranës, sikurse është treguar në tabelën vijuese.

Nga këto përlllogaritje ka rezultuar se vlera e investimit në banesën objekt verifikimi, e përfshirë si shpenzim në analizën financiare për të gjitha vitet e ndërtimit gjatë të cilave subjekti ka banuar në këtë banesë, është 5.600.736 lekë.

<i>Vendimi</i>	<i>Koha e ndërtimit</i>	<i>Çmimi për sip. ndërtimi</i>	<i>Sip. e ndërtuar çdo vit</i>	<i>Vlera e ndërtuar sipas viteve</i>
Udhëzim nr. 2, datë 4.4.2007	<i>nga prill 2007</i>	24 993	94	2 358 525
Udhëzim nr. 1, datë 20.8.2008	2008	27 439	43	1 191 297
Udhëzim nr. 1, datë 20.8.2009	<i>deri prill 2009</i>	27 439	37	1 023 925
	<i>nga maj 2009</i>	27 439	8	225 120
Udhëzim nr. 3, datë 3.2.2010	2010	34 260	11	393 084
Udhëzim nr. 4, datë	2011	36 427	11	408 787
Totali			206.0	5 600 736

Burimi i të ardhurave që kanë shërbyer për investimin e vlerës 5.600.736 lekë

59. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se për investimin në banesë kanë shërbyer: (i) kursimet, ndër vite, nga puna e prindërve; (ii) të ardhura nga puna e babait në tregun e Medresesë si tregtar për periudhën shtator 1999 – dhjetor 2000; (iii) të ardhura nga puna e babait me fugon për transport pasagjerësh; (iv) të ardhura të përfituara nga një hua shumë 3.500.000 lekë. Subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore për të vërtetuar këto deklarime, në analizë të të cilave, të ardhurat nga pensionet u konsideruan si të ardhura të ligjshme, ndërkohë që nuk u vërtetuan të ardhura të ligjshme të pretenduara në pikat (ii) dhe (iii).

60. Sa i takon huas në shumë 3.500.000 lekë, subjekti deklaroi se është marrë hua nga babai i tij te kushëriri i tij A. Xh., i cili ka një shoqëri ndërtimi “****” sh.p.k., sipas kontratës së huadhënies nr. ***, datë 4.8.2008, pa afat dhe pa interes për ndërtimin e banesës në Tiranë. Me qëllim verifikimit e kësaj huaje dhe burimit të saj me të ardhura të ligjshme të huadhënësit, u kryen disa veprime hetimore nga te cilat rezultoi se:

60.1. Me shkresën e datës 21.7.2022, noterja F. L. notere e Dhomës së Noterëve Korçë, informoi dhe vuri në dispozicion faqen nr. *** të regjistrimit noterial të vitit 2008, në rreshtin me numër rendor *** të të cilit, pasqyrohet qartë regjistrimi i veprimit noterial kontrate huaje në shumë 3.500.000 lekë, me nr. ***, datë 4.8.2008, si dhe faqen e indeksit të regjistrimit të veprimeve noteriale, ku është regjistruar kjo kontratë.

60.2 Në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së në datën 22.1.2016, subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara në lidhje me burimet që kanë shërbyer për këtë pasuri, pa e deklaruar

³⁹Përqindjet janë përlllogaritur duke përcaktuar pjesën specifike që zë vlera e investuar gjatë secilës nga 3 periudhat e deklaruar, nga viti 2007 deri në fund të vitit 2011, mbi koston totale të deklaruar 4.200.000 lekë.

huan si burim krijimi. Ndërkohë, gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar si burim krijimi edhe huan e marrë nga babai i tij.

60.3. Sa i takon huas, në përgjigje të pyetësorëve nr. 3 dhe 4, subjekti ka deklaruar se:

- Shuma prej 3.500.000 lekësh i është dhënë babait të tij në *cash* me kontratën e huas nr. 590/292, datë 4.8.2008.

- Në datën 2.7.2008, nga llogaria e shoqërisë “****” sh.p.k., pranë BKT-së, është tërhequr shuma prej 5.000.000 lekësh nga z. A. Xh., ortak me 45% të kuotave të kësaj shoqërie, e cila është përdorur për dhënien e huas prej 3.500.000 lekësh te babai i subjektit.

- Burimi i të ardhurave për krijimin e shumës së dhënë hua janë të ardhurat e shoqërisë, fakt i cili është pasqyruar edhe në bilancin e shoqërisë për vitin 2007.

- Subjekti sjell në vëmendje se për vitin 2008, shoqëria ka gjeneruar një të ardhur prej 319.627.851 lekësh dhe fitim *neto* pas tatimit në shumën 48.501.560 lekë. Konkretisht, subjekti ka sqaruar se: “*Shuma prej 5.000.000 lekë është tërhequr nga llogaria likuiduese e shoqërisë ‘***’ sh.p.k. me Nr. ***, pranë Bankës Kombëtare Tregtare dhe është e regjistruar në kontabilitetin e shoqërisë në dokumentin kontabël ‘***’ me veprimin kontabël: Debitohet llogaria ‘Të drejta dhe detyrime të Ortakëve’, me përshkrimin ‘shlyerje e detyrimit të ortakut’ dhe kreditohet llogaria *** ‘Banka llogari likuiduese’, për shumën 5,000,000 lekë. Në fund të vitit ushtrimor në mbyllje të rezultatit financiar dhe hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2008 llogaria ‘Të Drejtat dhe Detyrimet ndaj Ortakëve’, e cila në fillim të vitit ushtrimor rezulton me teprice kreditore të mbartur nga vitet e mëparshme në shumën prej 26.112.515 lekë, është zero.*

Shuma e mësipërme (26.112.515 lekë) është e pasqyruar në pasiv të pasqyrave financiare të vitit 2007 në zërin e bilancit ‘Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve (e cila në fund të vitit 2008 teprica paraqitet me gjendje zero lekë).

Gjatë vitit ushtrimor 2008, ortakët e shoqërisë kanë tërhequr të gjithë këtë shumë që është shpërndarë në mënyrë proporcionale midis tyre”.

Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore⁴⁰.

60.4. Pas verifikimit të kryer në faqen *online* të QKB-së, ka rezultuar se shoqëria “*****” sh.p.k. me NIPT ***, është themeluar në datën 5.8.1994, regjistruar në datën 2.7.1996, me objekt aktiviteti në fushën e ndërtimeve civile e industriale etj., z. A. Xh. rezulton të jetë administrator i shoqërisë “*****” sh.p.k. dhe ortak i saj me 45% të kuotave të saj⁴¹. Gjithashtu, u verifikuan edhe bilancet e viteve 2007 dhe 2008, të janë të njëjta me ato të sjella nga subjekti.

60.5. U pyet subjekti, për shlyerjen e kësaj huaje nga babai i tij, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 3 ka deklaruar se babai i ka kthyer *cash* kushëririt A. Xh. shumën 500.000 lekë në fund të vitit 2016, së bashku me hallën e subjektit; shumën 500.000 lekë në dhjetor të vitit 2020; si dhe shumën 2.000.000 lekë në rrugë bankare në datën 18.2.2021. Këto shlyerje janë vërtetuar edhe nga z. A. Xh., në deklaratën e tij noteriale të datës 27.6.2022. Detyrimi i mbetur është në shumën 500.000 lekë. Komisioni verifikoi mundësinë financiare të babait të subjektit për të paguar shumat e mësipërme, nga ku ka rezultuar se: (i) babai i subjektit nuk ka pasur mundësi financiare të shlyejë shumën 500.000 lekë në vitin 2016; (ii) babai i subjektit ka pasur mundësi financiare të shlyejë shumën 500.000 lekë në fund të vitit 2020 dhe shumën 2.000.000 lekë në vitin 2021.

⁴⁰Shihni deklaratën noteriale nr. ***, datë 27.6.2022; bilancin kontabël të shoqërisë “*****” sh.p.k. për vitin 2008. Auditimi është kryer nga Eksperti Kontabël i Autorizuar, z. Dh. P., në datën 28.3.2009.

⁴¹Nga momenti i themelimit A. Xh. ka pasur 50% të kuotave dhe nga janar 2008 e deri sot zotëron 45% të kuotave.

61. Nga analiza e të gjitha fakteve dhe dokumenteve si më sipër, rezultoi se subjekti ka provuar marrjen e huas nga babai i tij ne vitin 2008, sipas kontratës së huas nr. ***, datë 4.8.2008. Sa i takon burimit të ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e huas, nga shqyrtimi i bilanceve të viteve 2007 dhe 2008, ka të dhëna që tregojnë një lidhje të mundshme midis shlyerjes së detyrimit të shoqërisë ndaj ortakut A. Xh.⁴² dhe tërheqjes e dhënies të shumës 5.000.000 hua te babai i subjektit. Pavarësisht këtyre të dhënave, bilancet vjetore tregojnë gjendjen e shoqërisë në datën 31 dhjetor të një viti, por jo detaje të kontabilizimit të veprimit, çka do të thotë që bazuar në bilancet e viteve 2007 dhe 2008, nuk mund të përcaktohet me saktësi: (i) sa është detyrimi i dhënë e pastaj i kthyer i secilit ortak; (ii) nëse shuma 5.000.000 lekë e tërhequr nga z. A. Xh. i takon, pikërisht, këtij detyrimi; (iii) nëse kjo shumë është përdorur, pikërisht, për t'u dhënë hua te babai i subjektit, apo për të kryer veprime të tjera në favor të shoqërisë “****” sh.p.k.

Verifikime të tjera për efekt të kryerjes së analizës financiare

62. Për efekt të kryerjes së analizës financiare, u pyet subjekti për pasuri të tjera të prindërve të tij, i cili paraqiti disa dokumente shkresore⁴³ për automjete në pronësi të babait të tij, të dhëna që përputhen me informacionin e paraqitur nga DPSHTRR-ja⁴⁴, e cila ka konfirmuar se shtetasi E. A. Xh. ka pasur në pronësi 4 automjete. Blerja e këtyre automjeteve është përfshirë në analizën financiare të subjektit dhe familjes së tij, në vitet kur është kryer shpenzimi. Vlerat e përfituara nga shitja e secilit prej tyre, e cila në çdo rast është konsideruar e barabartë me vlerën e blerjes së tyre, janë përfshirë si të ardhura në analizën financiare të viteve përkatëse.

62.1. Për efekt të përlogaritjes së shpenzimeve të jetesës, u pyet subjekti, mbi përbërjen faktike familjare dhe përballimin e shpenzimeve të saj, për të cilat në përgjigje të pyetësorit nr. 3 ka dhënë sqarime të detajuara dhe ka paraqitur disa dokumente shkresore.

62.2. Nga shkresa e përcjellë nga DPRTSH-ja⁴⁵ është evidentuar se ish-bashkëjetuesja, znj.S.M., ka në pronësi të saj automjetin tip “SMART”, me targa ***, i cili është blerë në vitin 2010 në vlerën 2.000 euro. Blerja e automjetit është përfshirë si shpenzim në analizën financiare të subjektit.

62.3. Sa i takon të ardhurave/likuiditeteve të prindërve të subjektit, nga ana e Komisionit:

- janë administruar të ardhura nga pensionet e prindërve të subjektit bazuar në informacionin e ISSH-së⁴⁶ (E. Xh.: për periudhën korrik 2009 – nëntor 2013, ka përfituar pension të parakohshëm ushtarak me masë mujore përfundimtare paga *bruto* 11.769, paga e kontributeve 11.769; për periudhën nga dhjetor 2013 përfiton pension pleqërie me masë mujore aktuale paga *bruto* 24.579, paga e kontributeve 24.579; për periudhën nga dhjetor 2013 përfiton pension suplementar me masë mujore aktuale paga *bruto* 11.393, paga e kontributeve 11.393. Z. M. Xh. për periudhën nga janar 2012 përfiton pension pleqërie me masë mujore aktuale paga *bruto* 12.293, paga e kontributeve 12.293;

- janë administruar informacione nga “Raiffeisen Bank”⁴⁷, e cila ka konfirmuar se shtetasi E. Xh., ka llogari nr. ***, me gjendje zero (0) lekë;

⁴²Nisur nga kuotat që zotëron secili prej ortakëve, shuma e detyrimit të kthyer që do t'i takonte z. A. Xh. do të ishte 26.112.515 lekë x 45% = 11.750.632 lekë.

⁴³Shihni dokumentet bashkëngjitur pyetësorit nr. 2, dërguar me *email* më 5.4.2022:kontratë shitblerje nr. ***, datë 4.12.1999, së bashku me deklaratën doganore të zhdoganimit të automjetit me targa ***, shitur me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 4.6.2005; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 17.1.2005, me targa ***, shitur me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 19.2.2009; kontratë për blerjen e automjetit me targë *** nuk ka mundur për momentin ta siguroj shitur me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 10.2.2012; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 16.10.2013 për mjetin me targa ***, shitur me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 21.4.2016.

⁴⁴Shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.2.2022, të DPSHTRR-së, bashkëngjitur dosjet e mjeteve, në dosjen e Komisionit.

⁴⁵Shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.2.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴⁶Shihni shkresën nr. *** prot., datë 9.2.2022, të ISSH-së në dosjen e Komisionit.

⁴⁷Shihni shkresën nr. *** prot., datë 10.2.2022, të “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

- janë administruar informacione nga DPT-ja⁴⁸, e cila ka konfirmuar se prindërit e subjektit, nuk rezultojnë të kenë ose të kenë patur aktivitet tregtarë të regjistruar në emër të tyre, nuk janë subjekte të deklarimit individual të të ardhurave dhe nuk rezultojnë të punësuar;
- janë administruar informacione nga QKB-ja⁴⁹, e cila ka konfirmuar se prindërit e subjektit nuk figurojnë të jenë pajisur me NIPT si persona fizike apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare.

Analiza financiare

63. Bazuar në të dhënat e administruara, u krye analiza financiare për pasurinë objekt verifikimi dhe në përfundim të hetimit administrativ, duket se subjekti së bashku me familjen prindërore nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për investimin në vlerën 5.600.736 lekë, për shkak të një balance negative në total në shumën 2.343.522 lekë, e krijuar gjatë viteve 2008 – 2010, sikurse është treguar në tabelën vijuese.

Përshkrimi	2007	2008	2009	2010	2011
PASURI	2 893 137	1 214 010	1 638 350	1 195 079	209 859
Automjet "Volkswagen Golf", ***	530 000		-530 000		
Automjet "Mercedes-Benz" ***				902 265	
"Mercedes-Benz" *** babai			370 000		
Automjet "SMART", *** e bashkëjetueses				208 215	
Shtëpi banimi 3 kate	2 358 525	1 191 297	1 249 044	393 084	408 787
<i>Ndryshimet e likuiditeteve</i>	<i>4 612</i>	<i>22 714</i>	<i>549 306</i>	<i>-308 485</i>	<i>-198 928</i>
Gjendja e likuiditeteve	4 612	27 326	576 632	268 147	69 219
Detyrime	862 166	-345 659	-62 823	-75 080	-378 605
Kredi "Raiffeisen Bank", 7 vjet, më 13.4.2007	600 000				
Shlyer kredi personale në "Raiffeisen Bank"	-30 448	-53 044	-62 823	-75 080	-378 605
Kredi "Raiffeisen Bank", 7 vjet, më 24.8.2007	300 000				
Shlyer kredi personale në "Raiffeisen Bank"	-7 386	-292 614			
Pasuri neto	2 030 971	1 559 669	1 701 173	1 270 159	588 464
TË ARDHURA dokumentuar	3 146 848	1 272 048	1 662 779	1 835 888	1 971 476
Të ardhura të subjektit nga paga	1 267 577	1 004 873	1 062 495	1 106 322	1 041 501
Të ardhura nga pensionet e babait	-	207 367	187 039	153 293	158 604
Të ardhura të bashkëjetueses nga shtator 2007		59 808	75 920	377 931	565 129
Nga shitja e makinës së babait			240 000		
Të ardhurat e hallës			97 325	198 342	206 242
Shuma te kursyera nga familja/prindërit	1 879 271	-	-	-	-
SHPENZIME	773 809	719 814	756 402	1 107 020	974 039
Shpenzime jetese	182 160	500 940	637 560	819 720	819 720
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	5 212	46 809	28 982	209 019	119 444
Shpenzime transporti të brendshëm		31 781			
Shpenzime qiraje (sipas p. standard)	84 000	42 000			
Komisione për kreditë bankare	12 000				
Paguar interesa kredie bankare (stm. RZB)	70 437	98 284	89 860	78 280	34 875
Shpenzime mobilimi sipas pyetësorit standard	120 000				
Shpenzuar kredia e marre	300 000				
Mundësia për kursime	342 068	-1 007 435	-794 796	-541 291	408 973

64. Në këtë analizë janë konsideruar sa më poshtë:

- Janë përfshirë të ardhurat e subjektit, bashkëjetueses së subjektit, S. M., të ardhura nga pensioni i babait dhe i hallës (duke filluar nga maj 2009).
- Janë përfshirë si të ardhura, shumat e dy kredive të marra nga subjekti në "Raiffeisen Bank" dhe konkretisht: kredia prej 600.000 lekësh në datën 13.4.2007, e cila ka shërbyer si burim për blerjen e mjetit të subjektit dhe kredia 300.000 lekë më 24.8.2007. Meqenëse subjekti nuk ka

⁴⁸Shihni shkresën nr. *** prot., datë 17.2.2022, të DPT-së, në dosjen e Komisionit.

⁴⁹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 10.2.2022, të QKB-së, në dosjen e Komisionit.

deklaruar destinacionin e kësaj kredie, ajo është konsideruar edhe si shpenzim i kryer brenda këtij viti.

- Shuma të kursyera nga familja/prindërit, duke filluar nga viti 2003 deri më 4.10.2006, datë e emërimit të subjektit në detyrë⁵⁰.

- Shpenzimet e jetesës janë përlogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së dhe përbërjes familjare⁵¹:

- janë përfshirë si pasuri automjetet e blera nga secili prej pjesëtarëve të familjes, për këtë periudhë dhe likuiditetet në banka për secilin nga anëtarët e familjes.

- Nuk është përfshirë në këtë analizë si e ardhur e ligjshme shuma prej 3.500.000 lekësh e marrë hua nga babai i subjektit nga kushëriri i tij, në vitin 2008.

65. Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me pasurinë objekt verifikimi me nr. ***, në pronësi të shtetasit E. A. Xh., subjektit i kaloi barra e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, duket se:

- As subjekti dhe as personi i lidhur E. Xh. nuk kanë deklaruar pasurinë nr. ***, z. k. ***, në deklaratën *Vetting*, sipas detyrimit të nenit 32, pika 1, të ligjit nr. 84/2016.

- Në lidhje me huan n shumën 3.500.000 lekë marrë nga E. Xh. në vitin 2008, referuar fakteve e rrethanave si vijojnë:

i) ka mospërputhje në deklarimin e burimeve të krijimit të pasurisë në procesverbalin e ILDKPKI-së në janar të vitit 2016, ku nuk është përmendura huaja si burim, me deklaratet gjatë hetimit, ku huaja është shtuar si një nga burimet e krijimit të pasurisë;

ii) babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për shlyerjen e huas tek A. Xh., për vitin 2016;

iii) nuk është provuar plotësisht se burimi i huas në shumën 3.500.000 lekë, vjen nga shoqëria “****” sh.p.k.;

iv) kjo hua nuk është konsideruar si burim i ligjshëm për investimin në këtë pasuri.

- Nuk justifikohet tërësisht me të ardhura të ligjshme krijimi i pasurisë, konkretisht, vlera e investimeve për ndërtimin e dy kateve në vlerën pre 5.600.736 lekësh, gjatë periudhës që subjekti ka qenë në detyrë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

66. Në analizë të parashtrimeve të tij, në mënyre të përmbledhur, subjekti:

66.1. Ka vijuar të pretendojë se nuk ka pasur detyrimin të deklarojë në deklaratën *Vetting* pasurinë nr. ***, për shkak se pasuria nuk është në pronësi të tij, ndërsa e ka deklaruar periodikisht adresën e kësaj pasurie, për ato vitet kur ai ka banuar atje. Gjithashtu, sipas subjektit, babai i tij nuk ka pasur detyrim për të deklaruar pasurinë, pasi ai nuk duhet të konsiderohet si person i lidhur duke iu referuar dhe disa vendimeve të Komisionit, që nuk i ka trajtuar prindërit e subjekteve të rivlerësimit si persona të lidhur, pavarësisht se ata kanë figuruar në një certifikatë familjare deri në vitin 2016.

66.2. Ka kundërshtuar konstatimin në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për investimin në banesën e babit të tij, duke vijuar të këmbëngulë se prindërit e tij nuk kanë qenë

⁵⁰Kjo analizë është bazuar në metodologjinë kumulative, pasi i takon periudhës para emërimit në detyrë të subjektit dhe fillon në vitin 2003, pasi para këtij viti shpenzimet e jetesës së familjes janë më të ulëta se të ardhurat e ligjshme të dokumentuara, kështu që këto të ardhura kanë shërbyer vetëm për nevoja bazike jetese të familjes dhe jo për krijim kursimesh. Në këtë analizë janë përfshirë subjekti, motra e tij dhe 2 prindërit me çdo të ardhur, likuiditetet dhe shpenzimet e tyre.

⁵¹Përbërja familjare është si vijon: 2 persona subjekti dhe bashkëjetuesja për vitin 2007 dhe 2 muajt e vitit 2008; nga mars 2008 janë 4 persona pasi janë përfshirë edhe nëna dhe babai; nga maj 2009 janë 5 persona pasi është shtuar edhe halla dhe nga dhjetor 2009 janë 6 persona pas lindjes së vajzës së subjektit.

persona të tjerë të lidhur, duke iu referuar disa vendimeve të Kolegjit. Megjithatë, subjekti ka paraqitur prova dhe argumente në lidhje me huan prej 3.500.000 lekësh që ka qenë një nga burimet kryesore të krijimit të kësaj pasurie, duke pretenduar se kjo hua ka qenë me të ardhura të ligjshme, ashtu sikurse ka pretenduar që babai i tij ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për të shlyer shumën 500.000 lekë huadhënësin në vitin 2016. Gjithashtu, sa i takon mosdeklarimit të huas gjatë pyetjes në ILDKPKI, në janar të vitit 2016, subjekti pretendon se nuk është pyetur për vlerën e gjithë investimit, por vetëm për shumën 2.500.000 lekë, të cilën e ka deklaruar si vlere të pasurisë në DPV-në për vitin 2008. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore.

66.3. Ka pretenduar se vlera e investimit në pasuri është 4.772.956 lekë dhe jo 5.781.171 lekë që ishte përlogaritur nga Komisioni. Në funksion të këtij pretendimi, subjekti ka pranuar ndarjen e Komisionit në dy periudha⁵², por ka kundërshtuar metodologjinë e ndjekur prej tij për ndarjen e sipërfaqes së ndërtuar sipas viteve brenda këtyre dy periudhave, duke kërkuar që për këtë ndarje të konsiderohen deklarimet e tij gjatë hetimit administrativ. Sipas ndarjes së mësipërme të ndërtimit, ndër vite, duke përdorur çmimin e viteve përkatëse të EKB-së, subjekti ka përlogaritur një vlerë totale të investimit 5.781.171 lekë. Mbi këtë vlerë subjekti ka zbritur vlerën e TVSH-sw, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, tatim fitimit dhe fondin rezervë, për shkak se shtëpia e babait është një ndërtim informal i kryer nga punëtorë të njohur, si dhe e kanë ndihmuar familjarë e të afërm⁵³. Për këtë reduktim, subjekti i referohet vendimit nr. 15, datë 17.7.2019, të Kolegjit, sipas të cilit ka përlogaritur kostot e ndërtimit të objektit informal rreth 26 % më pak se kosto e përcaktuar nga EKB-ja, të cilit i ishte referuar fillimisht Komisioni. Pas zbritjeve të mësipërme vlera e ndërtimit e përlogaritur nga subjekti, ka rezultuar të jetë në total 4.772.956 lekë.

66.4. Në lidhje me pamundësinë e babait për të shlyer huan në shumën 500.000 lekë tek A.Xh., subjekti ka kundërshtuar konstatimin e Komisionit, duke pretenduar se babai i tij ka pasur kursime për të kryer këtë pagesë me burim shitjen e makinës së tij prej 2.000 euro dhe kursime nga pensioni për vitet 2015 dhe 2016, duke përlogaritur shpenzimet e jetesës së nënës dhe hallës së tij, të barabarta me pensionet e tyre⁵⁴.

Vlerësimi i Komisionit

67. Sa i takon pretendimit se prindërit e tij nuk kanë qenë persona të lidhur dhe kjo është arsyeja e mosdeklarimit të pasurisë objekt verifikimi në deklaratën *Vetting*, është i pabazuar pasi, sipas nenit 3, pika 13 të ligjit, ata kanë qenë pjesë e përbërjes familjare të tij për periudhën e rivlerësimit, 8.10.2013 – 8.10.2016, sipas parashikimit të nenit 3 pika 4, i cili i referohet pikës 3 të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti është shkëputur nga trangu familjar në datën 18.10.2016. Sipas nenit 32 të ligjit, pika 1 e tij, personat e lidhur me subjektin duhet të plotësojnë deklaratën e pasurisë ku të paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Shkëputja nga trangu familjar tre muaj më parë se të plotësohej deklarata *Vetting*, nuk e përjashtonte subjektin nga detyrimi që në deklaratën *Vetting* të deklaronte personat që kanë qenë në të njëjtin trug me të gjatë periudhës së vlerësimit, e cila ka përfunduar 10 ditë më parë se subjekti të shkëputej nga trangu familjar.

⁵²Deri më 14.4.2009 është realizuar 85% e projektit ndërtimor dhe 15% e tij nga maj 2009 deri në vitin fund të vitit 2011.

⁵³Shihni paragrafët 63-66 të parashtrimeve të subjektit ku subjekti i referohet dhe paraqet "Marrëveshjen për përcaktimin e treguesve minimalë për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në ndërtim", e nënshkruar ndërmjet Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, lidhur në datën 17.5.2006. Gjithashtu, në paragrafët 67-68 të parashtrimeve të tij, asi i referohet Udhëzimit të Këshillit të Ministrave dhe bazuar në të dhe në Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 8.5.2003, "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit". Sipas këtyre dokumenteve vlera e objektit bazuar në çmimet e EKB-së reduktohet në masën 17.44%.

⁵⁴Pensionin e nënës për vitin 2015-2016 dhe i hallës për vitin 2016, janë më të ulëta se shpenzimet e jetesës për 1 person sipas standardit të ILDKPKI-së, për këto vite.

67.1 Në këto kushte, pretendimet e subjektit janë të pabazuara dhe në përfundim, Komisioni vlerëson se ka pasaktësi në deklaratën *Vetting*, për shkak se subjekti nuk i ka deklaruar prindërit si persona të lidhur të cilët duhet të deklaronin pasurinë objekt verifikimi dhe jo vetëm sipas kërkesave të ligjit. Pavarësisht se në përfundim, Komisioni nuk evidentoi problematika në këtë pasuri, ndarja e subjektit nga trangu familjar tre muaj përpara se të plotësonte deklaratën *Vetting*, duket se është bërë pikërisht për t'iu shmangur deklaramit të pasurisë në këtë deklaratë. Argumenteti që subjekti ka paraqitur për shkaqet e shkëputjes nga trangu familjar tre muaj më parë plotësimi të deklaratës *Vetting*, janë të paqarta dhe jobindëse. Ndërsa i pyetur në seancë dëgjimore, subjekti shprehet se shkak për ndarjen nga familja është bërë celebrimi me bashkëjetuesen e dytë, znj. E. B., ndërkohë që, celebrimi me këtë shtetase është bërë në korrik të vitit 2017⁵⁵.

67.2 Nga ana tjetër, subjekti nuk ka kryer asnjë deklaram për këtë pasuri në DPV-të pas vitit 2006 dhe sidomos në deklaratën *Vetting*, ku kishte mundësi të jepte sqarime të hollësishme e dokumente shkresore në lidhje me këtë pasuri të deklaruar në DPV-në e vitit 2016, si pasuri në bashkëpronësi. Mungesa e deklarimeve, ndër vite, por dhe në deklaratën *Vetting*, përkatësisht nga subjekti dhe babai i tij, në lidhje me këtë pasuri, kanë vështirësuar punën e Komisionit në vlerësimet e tij, në lidhje me sipërfaqet, vlerën e investimeve, periudhat përkatëse, si dhe burimet e të ardhurave që kanë shërbyer për investim.

67.3 Për më tepër, subjekti ka deklaruar shkëputjen nga banesa në janar të vitit 2016, për të banuar me qira në apartamentin e shtetasës I. B. dhe rikthimin pas një viti, për të banuar përsëri në banesën prindërore, ku vijon të banoje edhe sot. Por, si gjatë hetimit, ashtu edhe në parashtrime subjekti ka dështuar në vërtetimin e marrëdhënies së qiramarrjes me shtetasen I.B. (trajtuar të paragrafi 74), çka e bën të dyshimtë deklaramin e shkëputjes nga shtëpia objekt verifikimi për vetëm për vitin 2016, që është edhe viti kur subjekti ka bërë shkëputjen nga trangu familjar⁵⁶.

68. Sa i takon pretendimit se prindërit e tij nuk kanë qenë persona të tjerë të lidhur, është e vërtetë se sipas standardit të Kolegjit, vetëm fakti i përdorimit të banesës së prindërve nga ana e subjekteve të rivlerësimit, nuk mjafton për t'i konsideruar ata si persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 14, të ligjit nr. 84/2016. Por, jo në pak raste, Kolegji mban qëndrimin se ky fakt nuk e përjashton Komisionin në kryerjen e hetimeve për të verifikuar një pasuri të mundshme të fshehur subjekteve të rivlerësimit apo kontribute të tyre në këto pasuri, në rastet kur ka të dhëna e dyshime. Në këtë këndvështrim, si dhe referuar fakteve sipas të cilave: (i) subjekti ka deklaruar bashkëpronësinë në 25% të banesës në DPV-në për vitin 2006 dhe, më pas, ka ndërprere deklarimet për këtë pasuri; (ii) ka banuar në mënyrë të pandërprerë prej vitit 2008 deri në vitin 2016, për t'u shkëputur në një periudhe prej një viti, për t'u rikthyer në vitin 2017; (iii) ka bërë shkëputjen nga trangu familjar vetëm tre muaj përpara plotësimi të deklaratës *Vetting*, është bërë i domosdoshëm kryerja e disa veprimeve hetimore në lidhje me pasurinë apo dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për investimin në të, në përfundim të të cilave nuk mund të arrihet në përfundimin se subjekti ka lidhje apo kontribute në këtë pasuri.

69. Sa i takon huas së marrë nga babi i tij në vitin 2008, në analizë të dokumenteve që subjekti ka vënë në dispozicion në parashtrime⁵⁷, por, dhe gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se: (i) ka një marrëdhënie huadhënie midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe ortakut A. Xh. në vitin 2008; (ii) shuma e këtyre huave të dhëna nga ortakët te shoqëria “****” sh.p.k.⁵⁸ është e

⁵⁵Shihni certifikatën e martesës në përgjigje të pyetësorit standard.

⁵⁶Përtej dyshimeve, për efekt të analizës financiare përfundimtare, është konsideruar se subjekti është shkëputur nga familja prindërore në janar të vitit 2016, ashtu sikurse ai ka deklaruar (trajtuar në paragrafin 34 të këtij vendimi).

⁵⁷Shihni kartelat e mbajtjes së librave kontabël për vitin 2008, për tre llogaritë e ortakëve dhe lëvizjet e llogarive të shoqërisë “****” sh.p.k. në disa banka të nivelit të dytë, për periudhën 1 janar deri më 31.8.2008.

⁵⁸Shihni tre kartelat e ortakëve, ku është evidentuar se detyrimi i shoqërisë “****” sh.p.k. ndaj ortakëve është në shumën totale 26.112.515 lekë e përbërë nga: 9.139.380 lekë detyrim ndaj Sh. Xh. + 11.750.632 detyrim ndaj A. Xh. +5.222.503 detyrim ndaj A. Xh., e njëjta shifër është e pasqyruar në bilancet e viteve 2006 – 2008.

pasqyruar edhe te kartelat e ortakëve dhe është regjistruar në bilanc. Konkretisht, në bilancin e vitit 2007, në zërin detyrime/ortakë, gjendja e detyrimit në datat 31 dhjetor të viteve 2006 dhe 2007, është e barabartë me shumatoren e detyrimit të pasqyruar në kartelat e të tre ortakëve në fund të vitit 2007. Ky zë i bilancit, ka gjendjen 0 (zero) në bilancin e vitit 2008, çka tregon se i gjithë detyrimi i shoqërisë ndaj ortakëve, i mbartur nga viti 2006, është shlyer gjatë vitit 2008; (iii) në datën 27.2008, z. A. Xh. ka tërhequr nga shoqëria huan e kthyer prej saj, në shumën 5.000.000 lekë, veprim ky i evidentuar të jetë kryer nga llogaria e shoqërisë “****” sh.p.k., në BKT.

69.1. Në përfundim të procesit, u vlerësua se subjekti ka provuar bindshëm se: (i) shuma 5.000.000 lekë është marrë nga shoqëria “****” sh.p.k., si hua e kthyer nga kjo e fundit te ortaku A. Xh.; (ii) këto të ardhura janë të ligjshme, pasi ato janë të regjistruara në librat e kontabilitetit dhe në pasqyrat financiare të shoqërisë, të cilat janë objekt auditimi nga DRT-ja; (iii) shuma 5.000.000 lekë, e cila përbën një të ardhur personale të z. A. Xh., është tërhequr prej tij në datën 2.7.2008 dhe është dhënë në formën e huas te babai i subjektit një muaj më pas; (iv) pavarësisht se nuk është provuar kalimi në rrugë bankare i shumës së huas prej 3.500.000 lekësh nga A.Xh. tek babai i subjektit, marrëdhënia e huas midis babait të subjektit dhe A. Xh. është materializuar me një akt noterial të kohës. Në këto kushte shuma prej 3.500.000 lekësh është përfshirë si burim i ligjshëm në analizën financiare të subjektit dhe familjes së tij, për vitin 2008.

69.2. Sa i takon mosdeklarimit të huas pranë ILDKPKI-së, është e vërtetë që sipas procesverbalit subjekti është pyetur në lidhje me shtëpinë e banimit 1-katëshe me sip. 120 m², me vlerë 2.500.000 lekë, sikurse subjekti pretendon. Por, në deklaratimet e tij, subjekti ka sqaruar se shtëpia e blerë në vitin 1999 në shumën 2.500.000 lekë, është investuar gjatë viteve në vazhdim me kontributin e babait, duke u ngritur dy kate të tjera me vlerë rreth 4.000.000 lekë. Si burim për krijimin e kësaj shume, subjekti ka deklaruar me detaje të ardhura të prindërve, por nuk ka deklaruar huan e marrë nga babai i tij në vitin 2008. Gjithsesi, modeklarimi i huas gjatë pyetjes pranë ILDKPKI-së, në kushtet kur nuk u evidentuan problematika në lidhje me huan dhe burimet e saj, nuk ka pasoja për subjektin e rivlerësimit.

70. Sa i takon pretendimit se investimi në pasuri është në vlerën 4.772.956 lekë dhe jo në vlerën prej 5.600.736 lakësh përlllogaritur nga Komisioni, në analizë të të gjitha pretendimeve për ndarjen e sipërfaqeve/volumeve të ndërtimit në vite, në përfundim, Komisioni çmoi se të gjitha pretendimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ. Për më tepër, Komisioni çmon se: (i) subjekti ka filluar bashkëjetesën me znj. S. M. në shtator të vitit 2007 dhe ndërtimi i një kati ka qenë nevojshëm për çiftin; (ii) ndarja e deklaruar dhe e propozuar nga subjekti nuk përputhet me logjikën e ndërtimit të një objekti, pasi në vitin e parë ndërtohet të paktën karabinaja e një objekti/banese; (iii) deklarimi i subjektit gjatë hetimit administrativ⁵⁹ se në vitin 2007 janë kryer punime betoni për ngritjen e kolonave dhe hedhjen e soletës në një vlerë afërsisht 400.000 lekë, nuk përkon me marrëveshjen e sjellë nga subjekti me parashtrimet, pasi sipas kësaj marrëveshjeje⁶⁰, faza e punimeve që përshkruan subjekti gjatë hetimit administrativ⁶¹ përbën 44% të punimeve të të gjithë ndërtesës dhe në çdo rast, ajo nuk mund të kushtojë 400.000 lekë ose 10% të vlerës së deklaruar nga subjekti edhe në parashtrime. Përkundrazi, 44% e punimeve është një vlerë, e cila i përafrohet më shumë përlllogaritjeve të kryera nga Komisioni i cili, në mungesë të një dokumentacioni tekniko-ligjor të ndërtimeve informale, ka ndërtuar një metodologji përlllogaritjeje të bazuar pikërisht në marrëveshjen e sipërcituar.

71. Sa i takon pretendimit për reduktim të kostove të ndërtimit, në kushtet kur banesa është ndërtuar pa firmë ndërtimi, por nga familjarë, miq e të njohur, sipas deklaratimeve të subjektit, vlerësohet se nuk është i bazuar pretendimi për zbritjen nga kostoja totale e ndërtimit e vlerës

⁵⁹Shihni pyetësorin nr. 3, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶⁰Shihni Tabela nr. 3. f.11 e marrëveshjes.

⁶¹Shihni pyetësorin nr. 3, administruar në dosjen e Komisionit.

që zë përqindja e TVSH-së në këtë ndërtim, pasi ajo është paguar nga subjekti tregtar pranë të cilit ai i ka blerë materialet për ndërtimin e objektit⁶². Ndërsa, sa i takon zërave *fitimi i planifikuar dhe fondi rezervë* si pjesë e kostos së ndërtimit, bazuar në manualët e preventivimit të punimeve të ndërtimit dhe formatit të analizës teknike të punimeve të ndërtimit, miratuar me udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, si dhe duke konsideruar si udhëzues vendimin nr. 6, datë 17.3.2022, të Kolegjit çmohet të zbritet nga kosto e ndërtimit vlera 10% për të gjitha vitet e ndërtimit 2007 – 2011. Në këto rrethana, vlera përfundimtare e investimit ndryshoi nga 5.600.736 lekë në 5.040.663 lekë.

72. Në lidhje me pretendimin se babai i tij ka pasur kursime për të shlyer shumën 500.000 lekë në fund të vitit 2016 te kushëriri A. Xh., vlen të theksohet se analiza e prindërve ishte kryer nga Komisioni, pasi ajo përforconte dyshimin për mosmarrjen dhe mospërdorimin e huas nga babai i subjektit, ndërkohë që në parashtrimet e tij subjekti ka provuar të kundërtën, pra, që huaja është marrë dhe ka qenë me të ardhura të ligjshme. Sidoqoftë, meqenëse prindërit e subjektit nuk janë subjekte deklarues mundësia për kursime pozitive e subjektit gjatë viteve të mëparshme⁶³ është atribut edhe i të ardhurave të prindërve dhe hallës së tij. Për më tepër, vlerësohet se pretendimi i subjektit qëndron derisa nuk u provuan lidhje financuese të subjektit me shtëpinë e babait dhe pagesat e bëra prej babait, për më tepër, pas shkëputjes së subjektit nga trangu familjar në tetor të vitit 2016, vlerësohet se shlyerja e huas nuk është objekt analize nga ana e Komisionit.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, nga analiza e rishikuar financiare pa marrjes në konsideratë të disa pretendimeve, analizuar hollësisht si më sipër, ka rezultuar se subjekti dhe familja e tij kanë pasur të ardhura të ligjshme për investimin në pasurinë objekt verifikimi.

Konstatime të tjera

73. Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se ka bashkëjetuar me shtetasen S. M. në periudhën shtator 2007 – janar 2015. Subjekti e ka deklaruar bashkëjetuesen vetëm në DPV-në e vitit 2008, ndërsa në DPV-të për vitet 2012 – 2015 nuk ka kryer asnjë deklaram për bashkëjetuesen. Po kështu, znj. S. M., e cila në vitin 2014, kur i ka lindur detyrimi, nuk ka plotësuar formularin e deklaramit të pasurisë. I pyetur për arsyen e mosdeklaramit si person i lidhur të bashkëjetueses S. M. në DPV-të për vitet 2012 -2015, si dhe nëse bashkëjetuesja ka pasur pasuri të cilat duheshin deklaruar, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, subjekti në përgjigje të pyetësin⁶⁴ nr. 2, ka dhënë sqarimet e tij, duke pretenduar se sipas ligjit nr. 85/2012, i ndryshuar, në nenin 7 të tij është përcaktuar se: “*Për qëllim të deklaramit periodik vjetor, ndër personat e lidhur me zyrtarin, mbartin detyrimin për deklaram vetëm bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë.* Me të njëjtin argument, subjekti ka justifikuar edhe mosdeklaramin e bashkëjetuesës për vitet 2013 dhe 2014. Sa i takon mosplotësimin të deklaramit të pasurisë nga ish-bashkëjetuesja për vitin 2014, subjekti pretendon se këtë deklaramit e ka plotësuar në mars të vitit 2015, ndërkohë që bashkëjetuesja ishte ndërprerë në janar të vitit 2015 dhe, për këtë arsye, nuk është plotësuar formulari prej saj.

73.1. Pavarësisht argumenteve të paraqitura, subjekti duhet të deklaramit shtetasen S. M. si person i lidhur në DPV-në për vitet 2012 dhe 2013, si dhe të dorëzonte deklaramitën e pasurisë të plotësuar nga kjo shtetase në vitin 2014. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është dhënë mundësia të vijojë të japë sqarime të mëtejshme në lidhje me këto konstatime. Në parashtrimet e tij, subjekti ka dhënë të njëjtat deklaramit sikurse edhe gjatë hetimit sa i përket

⁶²Referojuni ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa “a” sipas të cilit *tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) paguhet: a. për të gjitha furnizimet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve të kryera kundrejt pagesës prej një personi të tatueshëm, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

⁶³Shihni analizën financiare e cila është me surplus/balancë pozitive nga viti 2012 (pas ndërtimit të banesës) deri në vitin 2015.

⁶⁴Shihni dokumentet bashkëngjitur pyetësin nr. 2, dërguar me *email* më 5.4.2022, vërtetim nr. ***, datë 15.7.2020 i QSUT-së “Nënë Tereza”.

mosdeklarimit të bashkëjetueses në DPV-në 2014, ndërsa sa i përket mosdeklarimit të bashkëjetueses në DPV 2012-2013, subjekti e pranon këtë pasaktësi, që sipas tij ka ardhur nga kopjimi i interesave të viteve paraardhëse dhe duke iu referuar dy vendimeve të Kolegjit dhe një vendimi të Komisionit, kërkon që ky i fundit ta çmojë këtë pasaktësi të llojit formal dhe pa pasoja.

73.2. Në përfundim të procesit, vlerësohet se subjekti ka qenë i pasaktë në deklaratimet e tij për vitet 2012, 2013 dhe 2014, për shkak të mungesës së deklaratimeve në lidhje me ish-bashkëjetuesen S. M., por në kushtet kur nuk u vërtetuan pasuri në pronësi apo bashkëpronësi me këtë shtetase, përveç një makine të në pronësi të saj, e cila është përfshirë si shpenzim në analizën financiare të vitit 2010, këto pasaktësi nuk vlerësohen penalizuese për subjektin e rivlerësimit.

74. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se në periudhën janar 2016 - janar 2017 ka banuar me bashkëjetuesen E. B. me qira në adresën: rruga “****”, pall. ****, shk. ****, ap. ****, Tiranë, në apartamentin 2 + 1, të shtetasës së quajtur G. (mbiemrin nuk e di). Vlera e qirasë mujore është deklaruar 30.000 lekë/muaj. Gjithashtu, është deklaruar se nuk disponon kontratë qiradhënie. Në deklaratën *Vetting*, nuk ka deklaruar përdorimin e kësaj banese, sikurse ligji e kërkon, por e ka deklaruar si adresë banimi. Gjatë hetimit administrativ, subjektit iu kërkua të japë informacion të plotë mbi identitetin e qiradhënësit, të paraqesë kontratën e qirasë, duke paraqitur dhe dokument pronësie të apartamentit dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi : “I. B., e bija e J. dhe L., lindur më 26.1.1960, në Durrës, ID ****. Pasuria në të cilën kam banuar me qira ka të dhënat nr. ****, z. k. ****, vol. ****, f.****, apartament shkalla ****, kati ****, nr. ****, rruga “****”. PAGESA E QIRASË ËSHTË BËRË CASH ÇDO MUJ NË SHUMËN 30.000 LEKË NGA BASHKËSHORTJA. Subjekti nuk paraqiti dokumente shkresore.

74.1 Me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, iu kërkua subjektit të vërtetojë me dokumente shkresore pronësinë e qiradhënëses, si dhe marrëdhënien e qirasë. Në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar se fillimisht, kjo pasuri është legalizuar në emër të shtetasit A. M. B. dhe, më pas, në datën 3.2.2017, kjo pronë është regjistruar në emër të shtetasve I., A. dhe M. B., në bazë të dëshmisë së trashëgimisë nr. ****, datë 10.9.2016. Sa i përket marrëdhënies së qirasë, ka sqaruar se kontrata e qirasë me shtetasen I. B. është lidhur verbalisht për shkak se afati i kësaj kontrate qiradhënieje nuk ka qenë mbi 1 vit që të kërkohej formë shkresore (neni 803/4 i Kodit Civil) dhe ka paraqitur: (i) praktikën e plotë të dosjes nga hipoteka për pasurinë apartament në emër të tre shtetasve trashëgimtarë ligjore të shtetasit A. B., bashkëshortja I. B.⁶⁵ dhe dy vajzat, A. A. B., M. A. B.; (ii) kopje të librezave të CEZ dhe UK Tiranë në emër të A. B.; (iii) listë me pagesat e kryera të energjisë elektrike gjatë vitit 2016 dhe 2017, ku nuk duket nga kush janë paguar detyrimet. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument shkresor që të provojë marrëdhënien e qirasë. Në seancë pretendoi se i është refuzuar një deklaratë nga I. B., për shkak të mospagimit të detyrimeve tatimore nga ana e saj, pretendim që mbetet, gjithashtu, në nivel deklarativ, por edhe i paqartë për sa kohë pagimi i detyrimeve tatimore nuk i takonte vetëm znj. I. B. dhe, për më tepër, tatimi mbi të ardhurat nga qiraja mund të paguhej edhe me vonesë. Në këto kushte, mbetet e paqartë nëse subjekti ka banuar vërtet për një vit në apartamentin në fjalë.

75. Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar adresë tjetër vendqëndrimi, rruga “****”, Tiranë. Në pyetësorin standard, subjekti nuk ka dhënë asnjë informacion sa i takon kësaj adrese, ndërkohë që për këtë periudhë ka deklaruar se ka qëndruar në adresën rruga “****”, pall. ****, shk. ****, ap. ****, Tiranë, trajtuar më lart. Subjektit iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me adresën në rrugën “****”, Tiranë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se një

⁶⁵Pas verifikimeve të kryera nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi për shtetasen I. J. B. apo përfshirje në veprimtari të kriminit të organizuar. Shihni shkresat: nr. **** prot., datë 12.4.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. **** prot., datë 15.4.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. **** prot., datë 19.4.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. **** prot., datë 15.4.2022, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

adresë e tillë është deklaruar gabimisht prej tij duke ngatërruar emrin e rrugës ku ndodhej me qira, pasi e kishte pyetur bashkëshorten që i ka thënë këtë emër rruge. Subjekti, ndër të tjera, deklaroi se: “Nga një konsultim me aplikacionin Google Maps i ka rezultuar që rruga ‘***’ ndodhet në pjesën e Unazës nga sheshi ‘****’ (apo zona e *** siç thirret rëndom) deri në blv. ‘***’. Siç vërehet, adresa rruga ‘****’ e deklaruar në DPV-në për vitin 2016, është adresë tërësisht e ndryshme dhe në pikëpamje hapësinore larg adresës, ku pretendohet të kenë jetuar bashkëshortet në vitin 2016, rruga ‘****’.

Po kështu, ngelet e paqartë përse në DPV-në e vitit 2016 e plotësuar në datën 30.3.2017 është deklaruar një adresë vendqëndrimi tërësisht ndryshe nga ajo e deklaruar në deklaratën *Vetting*, plotësuar dy muaj më parë, në datën 26.1.2017, ndërkohë që subjekti ka pasur të gjithë mundësinë e verifikimit të adresës në deklaratën *Vetting*, në momentin e plotësimit të DPV-në e vitit 2016. Në këto rrethana, pretendimi se adresa rruga ‘****’, është deklaruar gabim për shkak të ngatërrimit të rrugës nga bashkëshortja, duket i pabesueshëm.

76. Subjekti i ka bashkëngjitur deklaratën *Vetting* AMTP-në nr. ***, datë 20.3.1993, në emër të A. T. B. (babai i bashkëjetueses). Në lidhje me këtë AMPT, nga ana e Komisionit u kryen verifikimet si vijojnë:

- ILDKPKI-ja⁶⁶ ka administruar shkresën e ZVRPP-së Korçë, e cila ka konfirmuar se znj. E. B. figuron bashkëpronare në pasuritë nr. ***, nr. ***, nr.***, nr. *** të llojit arë në fshatin ***, Korçë, ndërsa me kërkesë të Komisionit, ASHK-DV Korçë⁶⁷ nuk i ka konfirmuar këto pasuri.

- Gjatë procesit u pyet subjekti për këtë fakt, i cili ka shpjeguar se nga dokumentacioni i ASHK-Korçë⁶⁸ rezulton se bashkëshortja ka qenë pjesë e përbërjes familjare në datën 1.8.1991 dhe me AMTP-në nr. ***, datë 20.3.1993, në emër të A. T. B., familja e saj ka përfituar tokë arë dhe këto pasuri rezultojnë të regjistruara në pronësi të vjehrrës L. S. B., si dhe ka sqaruar se në plotësimin e deklaratës *Vetting*, i është referuar certifikatave të pasurive në të cilat figuron si bashkëpronare bashkëshortja dhe se nuk pasur ndonjë interes të mos i deklarojë, të cilat kanë origjinë dhe burim qartazi të ligjshëm.

- Duke qenë se bashkëjetuesja nuk ka kryer deklarime në lidhje me këtë pasuri, nga ana e Komisionit u kryen disa verifikime, në përfundim të të cilave rezultoi se: bashkëjetuesja ka qenë pjesë e familjes sipas certifikatës së gjendjes familjare datë 1.8.1991, e cila ka në pronësi pasuritë nr. ***, nr. ***, nr. *** dhe nr. ***, në z. k. ***. Për rrjedhojë, është bashkëpronare në pjesë 1/4 në këto pasuri, të cilat nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting*.

- Pavarësisht argumenteve të subjektit, bashkëjetuesja e tij duhet të deklaronte pjesën takuese në pasuritë nr. ***, nr. ***, nr. *** dhe nr. ***, përfituar nga ligji 7501, sipas AMTP-së nr. ***, datë 20.3.1993, sipas nenit sipas nenit 32 të ligjit, pika 1 dhe shtojcës 2, të ligjit nr. 4/2016. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është dhënë mundësia të vijojë të japë sqarime të mëtejshmen lidhje me këtë konstatim.

- Në parashtrimet e tij, subjekti ka pretenduar se mosdeklarimi është pa pasoja, për sa kohë pasuritë janë përfituar sipas ligjit nr. 7501. Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, pasaktësia në deklaratën *Vetting* qëndron, por nga ana e Komisionit vlerësohet si e paqëllimshme dhe pa pasoja, për shkak se këto pasuri janë përfituar me ligjin nr. 7501/1991, shumë kohë përpara njohjes së subjektit me bashkëjetueses dhe, për më tepër, në deklaratën *Vetting* subjekti ka paraqitur AMTP-në nr. ***, datë 20.3.1993, në emër të babait të bashkëjetueses.

⁶⁶Shihni aneksin 28 në dosjen e Komisionit.

⁶⁷Shihni shkresën nr. *** prot., datë 9.7.2021, të ASHK-së, në dosjen e Komisionit.

⁶⁸Shihni dokumentet bashkëngjitur pyetësorit nr. 2, dërguar me email datë 5.4.2022: certifikatë gjendje familjare 1.8.1991; AMTP nr. ***, datë 20.3.1993; certifikata të pasurive nr.***; nr. ***, nr. ***, nr. ***; z. k. ***; shkresë nr. *** prot., datë 17.3.2022, të ASHK-së; vendim gjykate për lëshimin e trashëgimisë ligjore të shtetasit A. B.

77. Nga verifikimi në sistemin AMF-së, rezulton se subjekti figuron si përdorues i mjetit me targa ***, markës “SMART”, me vit prodhimi 1999, në pronësi të S. M. (ish- bashkëjetuesja e subjektit), në periudhat 8.7.2010 – 7.7.2011 dhe 18.7.2013 – 17.7.2014⁶⁹.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se ky automjet ka qenë në pronësinë e ish- bashkëjetueses S. M. dhe si burim krijimi i automjetit janë të ardhurat e tij dhe ish- bashkëjetueses nga pagat. DPSHTRR-ja⁷⁰ ka konfirmuar se shtetasja S. M. ka pasur në pronësi mjetin me targa *** dhe sipas dokumentacionit rezultoi se e ka blerë në vitin 2010, në shumën prej 1.500 euro, shtetasit E. N. K.

Pas verifikimeve të kryera⁷¹, nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi të shtetasit E. N. K.

Vlera e blerjes së mjetit është përfshirë si shpenzim në analizën financiare të subjektit për vitin 2010, nga e cila ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të blerë këtë mjet⁷². Znj. S. M. është përfshirë në analizën financiare të subjektit për periudhën e bashkëjetesës nga shtator 2007 deri në fund të dhjetor 2014.

Analizë financiare për periudhën e rivlerësimit

78. Në përfundim të hetimit administrativ, pamundësia financiare totale për të krijuar pasuritë dhe likuiditetet, si dhe për të mbuluar shpenzimet për periudhën nga fillimi i detyrës deri në fund të vitit 2016, është -2.343.522 lekë dhe vinte për shkak të investimit të banesës së ndërtuar nga babai E. Xh., me të ardhura të pajustificuara tërësisht, balancë për të cilën subjekti i kaloi barra e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Në parashtrimet e tij, subjekti ka kundërshtuar analizën për periudhën tetor 2006 – 2016 ku ai është analizuar se bashku me prindërit dhe hallën, duke pretenduar se duhej analizuar më vete. Sipas subjektit, nga të gjitha deklaratimet e tij, del e qartë se ai nuk ka jetuar në një ekonomi të përbashkët me prindërit dhe hallën. Për këtë arsye, subjekti ka paraqitur dy analiza financiare të veçanta, nëpërmjet të cilave pretendon se ka provuar në mënyrë bindëse krijimin e pasurive me burime të ligjshme, duke arritur kështu një nivel të besueshëm të kriterit të pasurisë dhe konkretisht:

- i) analiza e subjektit nga shtator 2007 – janar 2015 me bashkëjetuesen S. M. dhe lindjen e vajzës D., si dhe me bashkëjetuesen E. Xh. për vitin 2016. Sipas subjektit, analiza financiare e tij me bashkëjetues/et rezulton me një balancë negative totale në shumën 89.982 lekë;
- ii) analizë të veçantë për prindërit e subjektit së bashku me hallën, e cila sipas subjektit ka rezultuar gjithashtu me balanca pozitive;
- iii) analizë financiare të përbashkët të subjekti me prindërit, sipas së cilës, përsëri rezultati financiar del pozitiv, me përfshirjen si burim për ndërtimin e banesës të huas prej 3.500.000 lekësh.

79. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, pasi janë marrë në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit, trajtuar në mënyrë të detajuar në këtë vendim, rezultati financiar përfundimtar për periudhën nga fillimi i detyrës deri në fund të vitit 2016, është përmirësuar nga -2.343.522 lekë në -735.352 lekë.

0	1	2	3	4	5
Vitet	Pasuri	Detyrime	Të ardhura	Shpenzime	Mundësia për kursime 4-3-5
2006	0	0	193 557	55 389	138 168

⁶⁹Shihni dhe shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2022, të AMF-së në dosjen e Komisionit.

⁷⁰Shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.2.2022, të DPSHTRR-së, bashkëngjitur dosjet e mjeteve, në dosjen e Komisionit.

⁷¹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 9.3.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. *** prot., datë 9.3.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. *** prot., datë 7.4.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

⁷²Këtu ndikon vlera e investuar gjatë këtij viti, në ndërtimin e banesës së babait.

2007	2 657 285	862 166	3 146 848	773 809	577 920
2008	3 403 584	3 154 341	1 272 048	760 485	262 321
2009	264 401	-62 823	1 662 779	756 402	579 153
2010	762 687	-75 080	1 835 888	1 107 020	-108 899
2011	-239 806	-378 605	1 971 476	974 039	858 638
2012	-343 268	220 000	2 262 297	1 462 974	1 362 591
2013	311 043	0	2 296 051	1 014 141	970 868
2014	-149 447	0	2 488 270	1 758 452	879 265
2015	141 173	0	1 817 869	1 194 118	482 578
2016	1 138 979	425 853	1 989 868	1 903 195	-626 453

Metodologjia e përdorur për analizën financiare

80. Në analizën financiare, për çdo pasuri të krijuar dhe/ose shpenzim të kryer, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, duke krahasuar në çdo rast informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore me deklaratimet e subjektit. Subjekti është analizuar së bashku me familjen e origjinës nga fillimi i detyrës, pasi ka qenë në të njëjtin trung familjar deri në datën 18.10.2016 dhe ka banuar në banesën e ndërtuar dhe në pronësi të babait. Kjo analizë është kryer duke marrë në konsideratë:

Të ardhurat

Subjekti është analizuar së bashku me prindërit e tij, për të gjithë periudhën e rivlerësimit 4.10.2007 – 31.12.2016, për shkak se ai ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me ta dhe, për rrjedhojë, në analizën financiare janë konsideruar të ardhurat e dokumentuara të:

- subjektit: bursë nga Shkolla e Magjistraturës⁷³ dhe pagat duke filluar nga data e emërimit në detyrë⁷⁴;
- të ardhurat e nënës dhe babait⁷⁵ të subjektit, nga pensionet e tyre, janë përfshirë edhe të ardhurat e motrës së subjektit⁷⁶, e cila ka jetuar me familjen e origjinës deri në fund të vitit 2005;
- të ardhura të hallës nga pensioni i saj, nga maj 2009 deri në fund të periudhës së rivlerësimit;
- të ardhura të akumuluar nga kursimet e prindërve në datën 4.10.2006, të rezultuara nga analiza financiare e subjektit dhe e familjes së tij, para detyrës;
- të ardhura nga paga të bashkëjetueses S. M. nga shtator 2007 – dhjetorit 2014 dhe ardhura të bashkëjetueses E. Xh. nga janar 2016 e në vijim;
- është përfshirë si e ardhur çdo shumë e përfituar nga shitja e automjeteve, e cila në çdo rast është konsideruar sa vlera e kontratës kur është shitur më pak nga çfarë është blerë ose e barabartë me vlerën e shitjes, kur është shitur më shumë nga sa është blerë.

Shpenzimet

- Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur sipas standardit të përdorur nga ILDKPKI-ja dhe përbërjes familjare të subjektit si vijon: para fillimit të detyrës subjekti ka qenë në një ekonomi të përbashkët familjare me prindërit dhe motrën e tij deri në fund të vitit 2005; me emërimin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, tetor 2006 – dhjetor 2007, subjekti

⁷³Vërtetim nr. ***, datë 26.10.2016, nga Shkolla e Magjistraturës.

⁷⁴Vërtetim nr. ***, datë 18.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për periudhën e punësimit nga data 4.10.2006 deri më 31.12.2007; vërtetim nr. ***, datë 18.10.2016 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për periudhën e punësimit dhjetor 2007 deri në qershor 2008 dhe vërtetim Prok.TR datë 20.1.2017 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën e punësimit qershor 2008 – 31.12.2016.

⁷⁵Shkresa nr. *** prot., datë 8.10.2019, nga ISSH-ja Tiranë.

⁷⁶Vërtetim nr. ***, datë 23.1.2017, nga Shkolla e Magjistraturës për periudhën 2003 - shtator 2004 dhe vërtetim datë 18.1.2017 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për periudhën tetor 2004 - 2005.

nuk ka qenë në një ekonomi të përbashkët me prindërit; nga shtatori 2007 – janar 2015 ka jetuar me bashkëjetuesen S. M. dhe gjatë vitit 2016 ka bashkëjetuar me shtetasen E. B.

- Shpenzimet e udhëtimit janë bazuar në raportin e sistemit *TIMS* dhe sqarimeve të dhëna nga subjekti gjatë procesit të hetimit administrativ. Metodologjia e përlllogaritjes së këtyre shpenzimeve është ajo e përcaktuar në vendimin (JR) nr. 11, datë 22.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

- Shpenzimet e transportit nga banesa në vendin e punës janë përlllogaritur bazuar në distancën e përshkruar, koston ditore të karburantit dhe ditët e punës së një muaji që janë 22.

- Shpenzimet e qirasë për periudhën nga fillimi i detyrës dhe deri në qershor të vitit 2008.

- Janë përfshirë si shpenzime interesat dhe çdo shpenzim i lidhur me kreditë bankare në “Raiffeisen Bank” dhe BKT; gjithashtu, edhe pagesat e kartës së kreditit në BKT.

- Shpenzimet e mobilimit janë konsideruar sipas deklarimeve të subjektit, të kryera gjatë hetimit administrativ.

- Është përfshirë si shpenzim për vitin 2007, kredia në shumën 300.000 lekë marrë në muajin gusht të vitit 2007, në “Raiffeisen Bank”, megjithëse subjekti nuk ka deklaruar qëllimin e marrjes së kredisë apo destinacionin e përdorimit të saj.

- Është përfshirë çdo shpenzim i evidentuar gjatë hetimit administrative, si dhe nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit dhe ILDKPKI-së.

Pasuritë

- Vlera e investimit të banesës së babait është përlllogaritur bazuar në çmimet e EKB-së për metër katror për sipërfaqe ndërtimi, në qytetin e Tiranës, për vitet 2007 – 2011, e ndarë sipas volumit të punimeve të këtij ndërtimi informal, bazuar në deklaratimet e subjektit dhe dokumenteve zyrtare mbi përqindjen e volumit sipas llojit të punimeve. Vlera e përlllogaritur është reduktuar në masën 10%, që përbëhet nga zërat *fitimi i planifikuar* dhe *fondi rezervë si pjesë e kostos së ndërtimit*, bazuar në manualin e preventivimit të punimeve të ndërtimit dhe formatit të analizës teknike të punimeve të ndërtimit, si dhe duke konsideruar si udhëzues vendimin nr. 6, datë 17.3.2022, të Kolegjit:

- vlera e parcelës ndërtimore 214,2 m² në Tiranë, paguar në vitin 2013;

- janë përfshirë të gjitha automjetet e blera nga subjekti dhe çdo anëtar i familjes, në vlerën e kontratës së shitjes;

- likuiditetet janë trajtuar si pjesë e pasurive në një zë të veçantë. Këtu janë përfshirë gjendjet e llogarive bankare⁷⁷ të subjektit dhe familjarëve që kanë jetuar me të, në fund të çdo viti/date të analizuar dhe gjendjet *cash*, sikurse janë deklaruar nga subjekti në DPV-të dhe sqarimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit;

- ndryshimi i likuiditeteve, pakësimi ose shtesa nga viti në vit, është pasuria e krijuar nga subjekti për çdo vit;

- shuma e pasurive dhe likuiditeteve përbën totalin e pasurisë së akumuluar nga subjekti, nga fillimi i detyrës deri në fund të periudhës së vlerësimit.

Detyrimet

- te detyrimet janë përfshirë dy kreditë e marra pranë “Raiffeisen Bank” në vitin 2007 dhe shlyerjet e secilës prej tyre; si dhe

⁷⁷Shkresat: nr. *** prot., datë 10.2.2022, nga “Raiffeisen Bank”; nr. *** prot., datë 21.7.2021, nga “Credins Bank”; nr. *** prot., datë 10.6.2021, nga “Intesa Sanpaolo Bank”; nr. *** prot., datë 7.6.2021, nga BKT-ja.

- është përfshirë si detyrim huaja në shumën 3.500.000 lekë, e marrë nga babai i subjektit të kushëriri i tij.

Rezultati financiar është i përlogaritur për çdo vit, për çdo datë/periudhë të krijimit të pasurisë/ve, si dhe në total. Mundësia për kursime rezulton si shumatore e të ardhurave – (shpenzime + pasuri *neto*), për çdo vit dhe për të gjithë periudhën e rivlerësimit.

Vlerësim përfundimtar në lidhje me kriterin e pasurisë

81. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D, pikat 2 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, balancat negative prej 397.603 lekësh për blerjen e mjetit në vitin 2016 dhe balanca negative prej 735.352 lekësh për periudhën kur subjekti ka qenë në detyrë, nuk janë të mjaftueshme për penalizim të subjektit nëse do të kishte ngelur si konstatim i vetëm i vlerësimit pasuror. Por, këto balanca, vlerësuar në raport me rrethanat të tjera të evidentuara gjatë procesit të rivlerësimit të pasurisë si: deklarime të pasakta e kontradiktore në përpjekje për të fshehur vlerën reale të paguar për blerjen e automjetit apo mosdeklarimi i prindërve si persona të lidhur në deklaratën *Vetting*, janë marrë në konsideratë në vlerësimin përfundimtar të çështjes, duke u konsideruar si elemente që cenojnë besimin e publikut të figura e subjektit si pjesë e sistemit të drejtësisë.

Rivlerësimi i figurës

82. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Julian Xhengo, me datë 21.6.2021, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 24.6.2021, të KDZH-së, ku është evidentuar se formulari për kontrollin e figurës është plotësuar saktësisht nga subjekti dhe është vlerësuar i përshtatshëm për ushtrimin e detyrës. Në vijim, me raportin e datës 21.6.2021, të deklasifikuar pjesërisht, ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Julian Xhengo bazuar në disa informacione konfidenciale të organeve ligjzbatuese, ku evidentohet se gjatë periudhës në të cilën z. Julian Xhengo ushtronte detyrën si prokuror, dyshohet se është përfshirë në veprimtari korruptive në vitet 2015-2016, si dhe disponohen të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

82.1. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me konstatimet dhe përfundimet e arritura nga DSIK. Në parashtrimet e tij, subjekti parashtron se informacioni i përcjellë në raportin e DSIK-së nuk përmban asnjë nga elementët e parashikuar nga neni 38/pikat 3, 4 e ligjit nr. 84/2016, dhe se, nuk përcakton ndonjë rrethanë konkrete për konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm, apo që në vitet 2015-2016 të jetë përfshirë në veprimtari korruptive. Sipas subjektit, në raportin e parë pozitiv të DSIK-së është vlerësuar edhe periudha 2015 - 2016 dhe është i paqartë se si ka ndryshuar vlerësimi për të njëjtën periudhë kohore. Sipas tij, raporti i dytë i DSIK-së nuk ka asnjë bazë, nuk jep asnjë të dhënë, asnjë rrethanë, asnjë provë apo burim prove, asnjë veprim konkret për ekzistencën e ndonjë kontakti të papërshtatshëm apo për përfshirje në veprimtari korruptive dhe se ky raport i paplotë nuk plotëson kushtet e nenit 38/pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi i Komisionit në lidhje me figurën

Me qëllim rivlerësimit sa më objektiv të kriterit të kontrollit të figurës, nga Komisioni u kryen veprimet verifikuese si vijojnë:

83. Nga ana e trupit gjykues u verifikuan informacionet e vëna në dispozicion nga institucionet ligjzbatuese, si dhe u ndërmorën disa hapa hetimorë me qëllim verifikimin e tyre. Konkretisht:

83.1. Me kërkesë të Komisionit, SPAK-u⁷⁸ ka informuar se nuk rezulton që në emër të shtetasit Julian Xhengo të jetë regjistruar ndonjë regjistrim penal, si dhe ka informuar se:

a) Ndaj subjektit është regjistruar kallëzimi penal nr. *** prot., datë 14.4.2020 dhe pas verifikimeve është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 29.4.2020. Ndaj këtij vendimi është bërë ankim dhe Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar ka vendosur rrëzimin e kërkesës së ankuesit, i cili është lënë në fuqi me vendim të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar.

b) Ndaj subjektit ka ardhur material kallëzues nga shtetasi K. Z., trajtuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan⁷⁹, e cila ka informuar se kallëzimi është regjistruar me nr. ***, datë 30.6.2021 dhe me vendimin datë 14.7.2021 është vendosur mosfillimi i procedimit për subjektin⁸⁰.

c) Në kuadër të procedimit penal nr. ***, viti 2019, i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, rezulton se emri i subjektit dhe shtetasve të tjerë funksionarë të drejtësisë janë përmendur nga kallëzuesi i veprës penale si persona që kanë shpërdoruar detyrën dhe të korrumpuar. Në lidhje me këtë material kallëzues SPAK-u⁸¹ ka informuar se është regjistruar procedimi i cili është në fazën e hetimeve dhe nuk ka emra të regjistruar.

83.2. Në lidhje me shtetasit J. M., A. G. (A. G.) e A. G., janë kryer verifikimet si vijojnë:

a. Gjatë procesit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këta shtetas dhe relatat me ta. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka sqaruar se këta shtetas nuk i njeh dhe nuk ka pasur ndonjë lloj kontakti/takimi dhe nuk ka marrëdhënie shoqërore apo të karakterit pasuror (huadhënie, huamarrje, dhurim etj.).

b. Sa i përket shtetasit A. G., subjekti sqaroi se në vitin 2015 ka kryer veprime me qëllim ekstradimitin e këtij shtetasi drejt Republikës së Italisë brenda afateve ligjore dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe lejimin e ekstradimitit për në Republikën e Italisë. Me kërkesë të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁸² vunë në dispozicion praktikën e ekstradimitit të shtetasit A. I. G., datëlindje 19.11.1975, nga shqyrtimi i akteve të të cilave, ndër të tjera, rezultoi se: (i) me kërkesë datë 5.3.2015 Ministria e Drejtësisë e Republikës së Italisë ka kërkuar ekstradimitin e shtetasit A. G.; (ii) me kërkesë të datës 27.4.2015 të prokurorit Julian Xhengo, dërguar më 28.4.2015 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është kërkuar lejimi i ekstradimitit të shtetasit A. G. për në Republikën e Italisë; (iii) me vendimin nr. *** akti, datë 12.6.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, është vendosur pranimi i kërkesës së prokurorit, lejimi i ekstradimitit të shtetasit A. G. nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë i akuzuar për veprën penale “plagosje me pasojë vdekjen”. Në këtë vendim, ndër të tjera, është arsyetuar se kërkesa për ekstradim është në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara. Për rrjedhojë, nuk rezultuan veprime procedurale apo ligjore që të vërtetonin të dhënat/dyshimet se subjekti ka ushtruar veprimtari të kundërligjshme gjatë trajtimit të kësaj çështjeje.

c. Bazuar në informacionin e SPAK-ut⁸³, vetëm për shtetasin J. M. ka të dhëna për një procedim penal ndaj tij për një nga veprat penale të krimit të organizuar.

⁷⁸Shihni shkresën nr. *** prot., datë 28.6.2021, të SPAK-ut në dosjen e Komisionit.

⁷⁹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.3.2022, të Prokurorisë së Shkallës së Parë Durrës, në dosjen e Komisionit.

⁸⁰Shihni shkresën nr. *** prot., datë 25.3.2022, të Prokurorisë së Shkallës së Parë Elbasan, në dosjen e Komisionit.

⁸¹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 15.3.2022 të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

⁸²Shihni shkresën nr. *** prot., datë 30.5.2022, të Prokurorisë pranë Shkallës së Parë Tiranë dhe shkresën nr. *** prot., datë 8.6.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

⁸³Shihni shkresën nr. *** prot., datë 15.3.2022, të SPAK-ut në dosjen e Komisionit.

d. Subjekti nuk ka trajtuar çështje që i përkasin shtetasve J. F. M., A. I. G. dhe A. I. G.⁸⁴.

e. Nga të dhënat e sistemit *TIMS* nuk rezultuan udhëtime të subjektit me të tre këta shtetas.

Bazuar në informacionin e administruar, nuk u vërtetuan kontakte të subjektit me shtetasin Jurgen Molla, i cili është i përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar dhe as me dy shtetasit e tjerë.

83.3. Në lidhje me çështjen penale që i takon shoqërisë “***” sh.p.k., sipas informacioneve konfidenciale ngriheshin dyshime për veprimtari të kundërligjshme të subjektit të rivlerësimit. Me qëllim verifikimin e veprimeve hetimore të kryera nga subjekti dhe vlerësimin sa më objektiv në raport me këto informacione, Komisioni administroi dosjen penale të kësaj çështjeje nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁸⁵. Në lidhje me këtë çështje është paraqitur edhe denoncimi nga shtetasi Q. B.⁸⁶, i cili ngre pretendimin për korrupsion ndaj subjektit, sa i takon trajtimin të kallëzimit nga ana e tij për punonjësit e AKBN-së, për shpërdorim detyre, testim investimesh të pakryera fatura dhe situacione fiktive për shoqërinë “***” sh.p.k. (trajtuar te rubrika “vlerësimi i aftësive profesionale”).

84. Nga të dhënat në sistemin *TIMS* rezultoi se subjekti ka dalë në datën 30.8.2013, nga pika kufitare H. H. me mjetin me targë ** me shtetasit A. D., E. B. dhe shofer N. P.. Në datën 31.8.2013, me të njëjtin mjet, rezultoi të kenë hyrë në Shqipëri shtetasit A. D. dhe N. L. P., por jo subjekti i rivlerësimit, i cili rezultoi të ketë hyrë në Shqipëri më 5.8.2014, pra një vit më vonë, me mjetin me targë ***, në pronësi të tij, konfirmuar edhe nga Policia e Shtetit⁸⁷. Siç duket: (i) ka mospërputhje në deklarimin e subjektit, sipas të cilit ka udhëtuar me mjetin me targë ***, në datat 30.8.2013 - 31.8.2013 dhe të dhënave të sistemit *TIMS*, konfirmuar edhe nga Policia e Shtetit, sipas të cilave, subjekti nuk ka hyrë në Shqipëri në datën 31.8.2013, as me këtë mjet as me ndonjë mjet tjetër, por ka hyrë në datën 5.8.2014 me mjetin e tij me targë ***; (ii) subjekti ka hyrë në territorin shqiptar një vit pas daljes, vit gjatë të cilit ka ushtruar detyrën e prokurorit. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këto konstatime. Në parashtrimet e veta subjekti deklaroi se mosregjistrimi i kthimit të tij në sistemin *TIMS* në datën 31.8.2013, mund të jetë për shkak të ndonjë gabimi në veprimtarinë e punonjësit të policisë në doganë, duke theksuar se teorikisht dhe praktikisht nuk ka asnjë mundësi që ai të ketë qenë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për një periudhë gati 1-vjeçare, pasi edhe nga Komisioni është vërtetuar se ai është paraqitur në punë. Nisur dhe nga të dhënat e administruara nga raporti profesional dhe dosjet penale në kuadër të denoncimeve nga publiku, del që ka punuar gjatë kësaj periudhe dhe sqarimet e subjektit u vlerësuan të besueshme nga Komisioni.

85. Në përgjigjet të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi mjeti me targë ***, është në pronësi të shtetasit P. Gj. për të cilin nuk ka të dhëna kush mund të jetë ky shtetas. Nga të dhënat në sistemin AMF, pronar i këtij mjeti ka qënë shtetasi S. Sh., konfirmuar edhe nga DPSHTRR-ja⁸⁸. Nga aktet e dosjes të vënë në dispozicion nga ky institucion, rezultoi se ky shtetas e ka blerë automjetin më 27.10.2009 dhe ia ka shitur shtetasit A. N. P. më 3.5.2014. Pas kësaj date, automjeti ka ndryshuar disa herë pronësinë, por nuk rezultoi të ketë qene ndonjëherë në pronësi të shtetasit P. Gj., sikurse subjekti ka deklaruar. Pas verifikimeve të kryera në lidhje me

⁸⁴Shihni shkresat: nr. *** prot., datë 9.3.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. *** prot., datë 9.3.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. *** prot., datë 7.4.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

⁸⁵Shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.6.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

⁸⁶Shihni denoncim nr. *** prot., datë 26.10.2021, në dosjen e Komisionit.

⁸⁷Shihni shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2022, të Policisë së Shtetit, në dosjen e Komisionit.

⁸⁸Shihni shkresën nr. *** prot., datë 26.4.2022, të DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

shtetasin S. R. S.⁸⁹ nuk rezultoi të jetë hetuar/proceduar nga subjekti, ndërsa SPAK-u⁹⁰ ka informuar se në ngarkim të këtij shtetasi etj., është regjistruar procedimi penal nr.***, për veprën penale parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal dhe në përfundim të hetimeve, është vendosur dërgimi në gjyq më 24.12.2014. Nga të dhënat e sistemit *TIMS* nuk rezultoi që subjekti të ketë udhëtuar me shtetasin S. Sh. Në lidhje me shtetasin N. L. P. u kërkua informacion pranë prokurorive Vlorë, Fier, Tiranë dhe SPAK⁹¹, ku nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi me subjektin apo përfshirje në veprimtari të krimit të organizuar. Gjithashtu, SPAK dhe GJKKO kanë informuar se avokati N. P. ka nuk ka qenë avokat mbrojtës i shtetasit S. Sh.

85.1. Në përfundim të hetimit administrativ, sa i takon udhëtimit të subjektit të rivlerësimit me mjetin me targë *** rezultoi se: (i) nga aktet e dosjes nuk rezulton që ky mjet të ketë qenë ndonjëherë në pronësi të shtetasit P. Gj., sikurse subjekti ka deklaruar; (ii) subjekti nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë emrin e pronarit të mjetit, që pas verifikimeve rezultoi të jetë shtetasi S. S., person i përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me konstatimet e mësipërme.

85.2. Në parashtrimet e veta, subjekti ka sqaruar se deklarimi i emrit të shtetasit P. Gj., gabimisht si pronar i mjetit, ka ardhur pas një informacioni nga një punonjës i DRSHTRR-së Tiranë nëpërmjet komunikimit me *WhatsApp* (të cilit ai i ka kërkuar emrat e pronarëve të automjeteve, pasi Komisioni i ka kërkuar shpjegime). Për të vërtetuar këtë pretendim subjekti paraqiti printim të një liste me emra, ku në rubrikën “historiku i lejeve dhe targave” në kolonën përdorues vërehet emri P. Gj. Sipas subjektit, pikërisht, ky emër është deklaruar si pronar i mjetit gabimisht. Subjekti pretendon se për herë të parë nëpërmjet rezultateve të hetimit ka mësuar faktin që automjeti në atë kohë ka qenë në pronësi të shtetasit S. R. Sh., për të cilin deklaroi se nuk e ka njohur asnjëherë, si dhe nuk ka pasur asnjë lloj kontakti/marrëdhënie të çfarëdolloj natyre me të.

85.3. Sa i takon argumenteve të paraqitura nga subjekti, Komisioni i vlerëson jobindëse pasi:

- Është e vërtetë se në akte të ndryshme të dosjes së mjetit, P. Gj. duket të jetë nëpunës në Drejtorinë Rajonale Berat, por në asnjë rast nuk rezulton të jetë pronar ose përdorues i mjetit. Subjekti, mundej dhe duhet të verifikonte pronarin e mjetit gjatë periudhës së udhëtimit, ashtu sikurse me saktësi ka verifikuar dhe deklaruar emrat e pronarëve të mjeteve të tjerë me të cilët ka udhëtuar, qoftë nëpërmjet një informacioni zyrtar nga DPSHTRR-ja, qoftë nëpërmjet pyetjes së shtetasve me të cilët ka udhëtuar, gjë që nuk e ka bërë. Për më tepër, djali i avokatit N. P. i cili ka pasur drejtimin e mjetit, rezultoi të ketë blerë mjetin nga shtetasi S. Sh.

- Deklarimi i subjektit se për herë të parë ka mësuar që mjeti në fjalë ka qenë në pronësi të shtetasit S. Sh., bëhet i pabesueshëm në kushtet kur me këtë mjet ka udhëtuar së bashku me një kolegun e tij, ish subjekt rivlerësimi, i cili është pyetur dhe përgjigjur në lidhje me këtë fakt të evidentuar në vendimin për përfundimin e procesit të rivlerësimit të tij, vendimi i të cilit është bërë publik.

Në këto kushte, deklaratimet e subjektit mbeten të dyshimta dhe duket se janë me qëllim për të fshehur faktin që mjeti ka qenë në pronësi të shtetasit S. Sh., person me precedent penal. Në përfundim të procesit, Komisioni nuk evidentoi kontakte të subjektit me shtetasin S. Sh., por

⁸⁹Shihni shkresat: nr. *** prot., datë 9.3.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. *** prot., datë 9.3.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. *** prot., datë 7.4.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

⁹⁰Shihni shkresën nr. *** prot., datë 15.3.2022, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

⁹¹Shihni shkresat: nr. *** prot., datë 12.4.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. *** prot., datë 15.4.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. *** prot., datë 19.4.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. *** prot., datë 15.4.2022, të SPAK-ut; nr. *** prot., datë 25.7.2022, të SPAK-ut dhe nr.*** prot., datë 22.7.2022, të GJKKO-së në dosjen e Komisionit.

mosveprimet e tij për një përgjigje të saktë dhe shteruese në lidhje me pronësinë e tij mbi mjetin me targe ***, janë marrë në konsideratë në vlerësimin përfundimtar të çështjes.

86. Në përfundim të vlerësimit të figurës, Komisioni nuk mund të arrijë në përfundimin se subjekti Xhengo është i papërshtatshëm, por nga hetimi administrativ në lidhje me këtë kriter, përfshirë edhe konstatimet në analizimin e çështjes “****” sh.p.k. (trajtuar te aftësitë profesionale) Komisioni çmoi se ka elemente që cenojnë besimin e publikut te subjekti, si pjesë e sistemit të drejtësisë.

Vlerësimi profesional

87. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Julian Xhengo, bazuar në: (i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 5.7.2022; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti për analizimin e aftësive profesionale nga KLP-ja

88. Analiza e kryer nga KLP-ja, në vlerësimin e aftësive, është bazuar në: (i) formularin e vetëdeklarimit; (ii) tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjet penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iv) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore. Në përfundim, KLP-ja, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, ka vlerësuar në mënyrë të përmbledhur subjektin e rivlerësimit, si vijon:

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Julian Xhengo, tregon korrektësi në zbatimin të ligjit, ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet. Aktet janë përgatitur në respektim të dispozitave procedurale penale dhe urdhrit nr. ***, datë 5.9.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore” (dosjet 4 dhe 5). Aktet e përpiluara prej tij janë administruar në sekretarinë e prokurorisë, në respektim të plotë të urdhrit. Në vlerësimet e punës të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se për vitin 2014 është vlerësuar “shumë mirë”, për vitin 2015 është vlerësuar “mirë”, për vitin 2016 është vlerësuar “shumë mirë”, për aftësitë profesionale të treguara prej tij.

b) Arsytimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Julian Xhengo shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Përmbajtja e akteve u ka dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për zgjidhje, ka analizuar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mënyrën e caktimit të dënimit, parashikuar nga neni 47 i Kodit Penal. Niveli i arsytimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Prokurori Julian Xhengo, në periudhën e rivlerësimit, ka deklaruar se i janë caktuar gjithsej 1098 çështje penale, nga të cilat 1025 janë çështje të përfunduara dhe 73 çështje të mbartura. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Julian Xhengo është eficient dhe efektiv.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Julian Xhengo, merr pjesë në gjykim si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë, tregon profesionalizëm në gjykim dhe në qëndrimin që mban për çështjet në gjykim. Nga vlerësimet e punës së subjektit për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se për vitin 2014 është vlerësuar “shumë mirë”, për vitin 2015 është vlerësuar “mirë” për vitin 2016 është vlerësuar “shumë mirë”, për aftësitë organizative të treguara prej tij, sipas treguesve vjetorë të punës.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, të njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe disponimin e Gjykatës.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga vlerësimet e punës së subjektit për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se: Për vitin 2014 është vlerësuar “shumë mirë”, për vitin 2015 është vlerësuar “mirë” për vitin 2016 është vlerësuar “shumë mirë”, për etikën profesionale të treguar prej tij.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Julian Xhengo, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Për vitin 2014 është vlerësuar “shumë mirë”, për vitin 2015 është vlerësuar “mirë”, për vitin 2016 është vlerësuar “shumë mirë”, për aftësitë e komunikimit të treguara prej tij.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Për vitin 2014 është vlerësuar “shumë mirë”, për vitin 2015 është vlerësuar “mirë” për vitin 2016 është vlerësuar “shumë mirë”, për aftësitë e bashkëpunimit të treguara prej tij në raport me institucionet e tjera ligjzbatuese, publikun dhe personat e tretë.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Julian Xhengo ka qenë pjesëmarrës në trajnime të tjera të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës jashtë periudhës së rivlerësimit dhe trajnime të kryera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

Informacioni i marrë nga burime të ligjshme

89. Informacionet e marra nga tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016

Nga analiza e katër dosjeve nuk rezultuan konstatime të tjera të ndryshme nga KLP-ja në raportin e saj. Për dosjen 4, që i përket procedimit penal nr. ***, regjistruar në datën 29.5.2014, me të pandehur shtetasin A. G., pas verifikimit të akteve nga Komisioni, u konstatua se procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 29.5.2014, me të pandehur shtetasin A. G., i akuzuar për veprën penale “drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, dërguar për gjykim në datën 15.9.2014. Subjekti Julian Xhengo, në datën 29.5.2015, ka regjistruar emrin e personit që i atribuohet vepra penale, më 11.6.2015 ka konkluduar në vendimmarrjen “Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës”, i përpiluar sipas standardit të akteve të kësaj natyre dhe i është njoftuar të pandehurit në datën 11.6.2015. Ka paraqitur “Kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2015”, para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

89.1. Në përfundim të hetimit administrativ, duket se: (i) prokurori ka marrë në pyetje në cilësinë e të pandehurit shtetasin A. G. para se t’i njoftohej akuza; (ii) nga data e njoftimit të akuzës 11.6.2014 deri në përfundim të afatit 3-mujor datë 28.8.2014, nga prokurori nuk është kryer ndonjë veprim hetimor, ndërsa zgjatja e afatit të hetimeve vetëm për njohjen me aktet nuk është një arsye objektivist e justifikueshme, për më tepër, në kushtet kur i pandehuri ka qenë në paraburgim⁹². Për rrjedhojë, zgjatja e afateve ka çuar në zvarritje të hetimeve.

89.2. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektivit iu kërkuan sqarime e dokumente në lidhje me këto konstatime. Në parashtrimet e veta subjekti ka paraqitur sqarime bazuar në dokumente shkresore, si vijon:

- Në lidhje me konstatimin se i pandehuri është marrë në pyetje në cilësinë e personit të pandehur përpara se atij t’i njoftohej vendimi për njoftimin e akuzës, pretendon se bëhet fjalë për një gabim material në datën që pasqyrohet në procesverbalin e pyetjes së të pandehurit, i ardhur për shkak të ngarkesës në punë dhe se në hartimin e akteve procedurale është praktikë e zakonshme që tekstet të merren me *copy paste*. Sipas tij, gabimi material në datën e këtij akti procedural nuk sjell ndonjë pasojë për pavlefshmërinë e tij apo të akteve të tjera të mëpasshme.

- Në lidhje me konstatimin se zgjatja e afatit të hetimeve vetëm për njohjen e të pandehurit me aktet nuk është objektivist e justifikueshme, ka sqaruar se shkak për zgjatjen e afatit të hetimeve me tre muaj të këtij procedimi penal kanë qenë, së pari, ngarkesa në punë dhe së dyti, fakti që i pandehuri nuk ka dhënë një adresë të saktë për njoftimin e tij për kryerjen e veprimeve procedurale përkatëse.

- Sa i takon konstatimit se i pandehuri ka qenë në kushtet e paraburgimit, ka sqaruar se është jo i saktë, për shkak se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 31.5.2014, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj personit nën hetim A. G., ndërsa Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 26.6.2014, ka vendosur ndryshimin e këtij vendimi duke i caktuar këtij shtetasi masën e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti paraqiti: fashikullin penal në ngarkim të z. A. G., vendimin nr. ***, datë 31.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimin nr. ***, datë 26.6.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë; të dhënat statistikore për ngarkesën në punë për periudhën 2014 – 2021.

89.3. Në analizë të parashtrimeve, në përfundim të procesit, Komisioni çmoi se:

- Pretendimi në lidhje me datën e pyetjes së shtetasit A. G., nga Komisioni vlerësohet i drejtë, duke pasur në konsideratë faktin që nuk kanë ardhur pasoja në lidhje me pavlefshmërinë e akteve procedurale.

⁹²Shihni udhëzimin nr. ***, datë 8.3.2007, të Prokurorit të Përgjithshëm: “4.2 Kur të pandehurit janë të paraburgosur, veçanërisht kur ata janë të mitur, gra apo të moshuar, hetimet paraprake duhen përfunduar në kohën më të shkurtër të mundshme ...”.

- Pretendimet në lidhje me zgjatjen e afatit të hetimeve nuk qëndrojnë, pasi në vendimin për zgjatjen e afateve, shkaqet e pretenduara nga subjekti nuk rezultojnë të jenë cituar dhe arsyetuar, si dhe gjatë afatit tremujor nuk rezultoi të jetë kryer ndonjë veprim për njoftimin e të pandehurit për njohjen me aktet. Ndonëse A. G. nuk ka bërë ankim kundër vendimit për zgjatjen e afateve, sikurse subjekti pretendon, kjo nuk justifikon zgjatjen e hetimeve apo moskryerjen e veprimeve hetimore nga subjekti.

- Sa i takon pretendimit se shtetasi A. G. nuk ka qenë në masë arresti në burg, qëndron, pasi subjekti paraqiti vendimin nr. ***, datë 26.6.2014, të Gjykatës së Apelit, e cila ka vendosur ndryshimin e masës duke i caktuar këtij shtetasi masën e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

Në konkluzion të gjithë sa më sipër, nga Komisioni vlerësohet se në këtë çështje ka pasur zvarritje të çështjes, pasi subjekti i rivlerësimit brenda afatit 3-mujor të hetimeve, për një periudhë prej 2 muaj e 17 ditë, nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, dhe më pas, ka vendosur zgjatjen e afateve të hetimit me argumentin e vetëm të njoftimit të akteve. Këto shkelje janë të përsëritura nga subjekti i rivlerësimit dhe janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar të çështjes.

Informacioni i marrë nga të dhënat arkivore

90. Nga të dhënat arkivore të vena në dispozicion nga KLP-ja, rezultoi se Prokuroria e Përgjithshme, me urdhrin nr. ***, datë 1.10.2014, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “vërejtje” ndaj subjektit të rivlerësimit Julian Xhengo, pasi nga ana e tij janë kryer shkelje për shkak të zvarritjeve të theksuara dhe të pajustificuara të proceseve gjyqësore për shkaqe të papërligjura në ligj. Gjithashtu, ka pasur 6 kallëzime penale ndaj subjektit të rivlerësimit, të cilat janë trajtuar nga prokuroritë kompetente dhe, në përfundim, është vendosur mosfillimi i procedimit penal si dhe 18 praktikë-ankesa trajtuar nga Prokuroria e Përgjithshme. Nisur nga këto të dhëna, nga Komisioni janë analizuar me kujdes praktikat e ankimeve, nga ku rezultoi se tetë praktika janë ankesa të paraqitura si denoncime nga publiku (trajtuar në vijim), ndërsa për tre praktika iu kërkua subjektit të japë sqarime, si vijon:

90.1 Praktika nr. ***, e vitit 2018, nga shtetasi R. B., i cili i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me ankesë, administruar në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun me nr. ***, datë 17.10.2018. Në ankesë ankohet se prokurori Julian Xhengo, prej muajsh po zvarrit hetimin duke mos kryer detyrat e tij ligjore dhe kushtetuese dhe duke i dhënë mundësi të kallëzuarve të thellojnë dhe më tepër pasojat e veprës penale.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkuan të japë sqarime e të paraqesë dokumente shkresore se çfarë është vendosur në lidhje me këtë ankesë, si dhe në lidhje me pretendimet e shtetasit R. B. për zvarritjen e hetimit duke dokumentuar të gjitha veprimet e tij hetimore.

90.2. Në parashtrimet tij, subjekti dha sqarime në lidhje me pretendimet e denoncuesit dhe veprimet e hetimore të kryera prej tij. Ai sqaroi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. ***, datë 13.12.2019, ka vendosur deklarin e pafajshëm të të pandehurit dhe, mbi bazën e ankimit të paraqitur prej subjektit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 8.6.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm. Në mbështetje të pretendimeve të tij subjekti ka paraqitur shkresë të Gjykatës së Lartë datë 31.8.2022 bashkëngjitur aktet e dosjes hetimore në ngarkim të të pandehurit E. B.

Nga analiza e sqarimeve dhe provave të paraqitura, nga Komisioni u vlerësua se sqarimet e subjektit të rivlerësimit qëndrojnë dhe se pretendimet e denoncuesit gjenden të pabazuara.

90.3. Praktika nr. ***, e vitit 2018, nga shtetasi T. M., i cili i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me ankesë/kallëzim penal, administruar në Sektorin e Marrëdhënieve me

Publikun me nr. ***, më 23.1.2018. Në kallëzim apo ky shtetas ka kallëzuar penalisht prokurorin Julian Xhengo për “shpërdorim detyre” në lidhje me hetimin e njëanshëm të procedimit penal nr. ***, datë 3.1.2013 dhe dosjes nr. *** të vitit 2015.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me vijimësinë e trajtimit të kallëzimit të shtetasit T. M. duke i shoqëruar me dokumentacion. Subjekti paraqiti shkresë të Prokurorisë së Rrethit Durrës datë 9.3.2018, vendim të prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për mosfillimin e procedimit penal nr. *** të kallëzuar nga shtetasi T. M. Në këtë vendim arsyetohet se, nga verifikimet e kryera nuk rezultoi që prokurori Julian Xhengo të ketë kryer apo moskryer me dashje veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin që përbën mospërmbyshje të rregullt të detyrës, nuk rezultuan të dhëna që prokurori Julian Xhengo në marrjen e vendimit të jetë ndikuar nga interesa të kundërligjshme. Vendimmarrja dhe kërkesa që i është drejtuar gjykatës është kompetencë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe është marrë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe provat e administruara gjatë hetimit të procedimit penal.

90.4. Praktika nr. *** e vitit 2016 nga shtetasja V. Q., e cila i është drejtuar me ankesë Prokurorisë së Përgjithshme, ku pretendon për pabazueshmërinë e qëndrimit të prokurorit Julian Xhengo në trajtimin e çështjes së kallëzuar prej saj. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 24.6.2016, ka konstatuar se qëndrimi i mbajtur nga prokurori i seancës është i gabuar, si dhe i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Tiranë të analizojë dhe shqyrtojë pretendimet e ankueses, lidhur me qëndrimin e prokurorit Julian Xhengo në hetimin dhe gjykimin e procedimit penal që i përket veprës penale “mashttrim” me pasoja të rënda, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal.

90.5. Komisioni verifikoi aktet bashkëlidhur praktikës, nga analiza e të cilave rezultoi se çështja penale nr. *** ka zgjatur pothuajse 1 vit e 9 muaj, ku konstatohen zvarritje për shkak se: (i) prokurori ka regjistruar procedimin penal pas 7 muaj e gjysmë pas regjistrimit të kallëzimit, pra përtej afatit 30-ditor; (ii) pas regjistrimit të procedimit penal nuk është kryer ndonjë veprim hetimor për një periudhë kohore pothuajse 4-mujore; (iii) vetëm në periudhën 15.1.2015 - 15.2.2015 nga OPGJ-ja janë pyetur persona që kanë dijeni mbi rrethanat e hetimit dhe marrjen e dokumenteve dhe pas 7 muajve, pa kryer veprime hetimore.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkuan sqarime dhe dokumente në lidhje me këto konstatime:

90.6. Në parashtrimet e veta subjekti ka sqaruar, si vijon:

- Në lidhje me konstatimin për mosrespektimin e afatit 30-ditor të përcaktuar në udhëzimin nr. ***, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, subjekti pretendon se ka ndodhur për shkak të mbingarkesës në punë në atë periudhë.

- Sa i takon konstatimeve në pikat (ii) dhe (iii) subjekti nuk dha sqarime konkrete dhe të qarta.
- Në parashtrimet e tij subjekti dha sqarime të shumta sa i takon pretendimit të denoncueses për pabazueshmërinë e qëndrimit të prokurorit, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit F. Ç. Ai pretendon se qëndrimi i mbajtur prej tij në veprimet e kryera për zbardhjen e rrethanave të kësaj çështjeje penale është i drejtë.

Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti paraqiti dosjen e procedimit penal nr. ***, procesverbale të seancave gjyqësore, shkresë⁹³ datë 13.9.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë bashkëlidhur vendimin e formës së prerë nr. *** akti, datë 22.5.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me anë të së cilës është vendosur rrëzimi i kërkesës së znj. V. Q. ndaj vendimit të pushimit të çështjes penale nr. ***.

⁹³Shihni dokumentet e paraqitura nga subjekti, protokolluar me nr. ***, datë 13.9.2022, pranë Komisionit.

90.7. Në analizë të parashtrimeve të subjektit dhe dokumentacionit shkresor, në përfundim të procesit, subjekti nuk arriti të kundërshtojë barrën e provës në lidhje me problematikat si vijojnë:

- Subjekti ka regjistruar procedimin penal pas një kohe relativisht të gjatë prej 7 muaj e gjysmë pa arsye ligjore, ndërkohë që në bazë të udhëzimit nr. ***, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, kërkohet kryerja e një minimumi verifikimesh dhe afati i regjistrimit të procedimit është maksimumi 30 ditë.

- Pas regjistrimit të procedimit subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë mbi 7 muaj. Pas urdhërimit të Prokurorit të Përgjithshëm nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë mbi 3 muaj, për të cilat subjekti nuk dha sqarime konkrete, duke treguar kështu një mënyrë pune jo efektive që nuk pajtohet me pozicionin e tij.

Këto shkelje janë të përsëritura nga subjekti i rivlerësimit dhe janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar të çështjes.

Informacion i marrë nga denoncimet

91. Gjatë hetimit administrativ janë paraqitur 25 denoncime nga publiku sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Në shtatë nga këto denoncime nuk referoheshin shkelje ligjore të kryera nga subjekti i rivlerësimit ose ngiheshin pretendime mbi vendimmarrje të padrejtë të subjektit, vlerësimi i të cilave, në zbatim të pikës 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 është jashtë tagrit të vlerësimit nga Komisioni, ndërsa për 18 denoncime janë kryer verifikimet si vijojnë:

92. Dy denoncime nga shtetasi B. K.⁹⁴, i cili ngre pretendime se subjekti ka bërë arrestime të paligjshme, ka mashtruar gjykatën, është i lidhur me mafian dhe grup kriminal. Në datën 25.10.2016, ky shtetas ka bërë kallëzim penal ndaj subjektit, pasi pretendon se ka falsifikuar firmën e tij në vendimin për zgjatjen e hetimeve, kur ai ishte në burgun ***, e cila është hetuar nga Prokuroria e Rrethit Durrës ku ushtron detyrën si prokurore motra e tij, se në bashkëpunim me të tjerë ka porositur vrasjen e vëllait të tij si përgjigje ndaj kallëzimit penal të bërë ndaj subjektit më 21.5.2015. Denoncuesi pretendon se subjekti nuk paraqitet në shumë seanca duke zvarritur procesin deri në vitin 2017.

92.1. Me qëllim verifikimin e pretendimit për zvarritje të procesit ndaj shtetasit B. K., me kërkesë të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁹⁵ vuri në dispozicion fashikujt e procedimit penal nr. ***. Në përfundim të hetimit administrativ, nga shqyrtimi i akteve të dosjes, duket se:

i) regjistrimi i procedimit penal është bërë pas 2 muajsh e gjysmë nga data e regjistrimit të kallëzimit penal, tej afatit 30-ditor të parashikuar nga udhëzimi nr. ***, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm;

ii) pas regjistrimit të procedimit penal nuk është kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë 2-vjeçare.

iii) nga aktet në dosje nuk rezulton të ketë memo apo kërkesë me shkrim të të pandehurve që kanë kërkuar kryerjen e veprimeve të tjera hetimore para vendimit për zgjatjen e afatit të hetimit, por vetëm një memo e datës 25.4.2014 nuk rezulton që prokurori të jetë shprehur me vendim, sipas nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale;

iv) arsyetimi për njohje të akteve dhe kryerja e veprimeve që mund të kërkohen nga të pandehurit nuk janë objektivisht të justifikueshme për zgjatjen e afatit, gjithashtu rezulton të jetë kryer vetëm pyetja e një të pandehuri nga ana e prokurorit pas vendimit për zgjatjen e afatit;

⁹⁴Shihni denoncimin protokolluar me nr. ***, datë 18.1.2018 dhe nr. *** prot., datë 14.10.2020, në dosjen e Komisionit.

⁹⁵Shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.6.2018 dhe shkresën nr. *** prot., datë 6.6.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

v) mbetet e paqartë data e dërgimit të çështjes në gjykatë, si dhe nëse kërkesa u është njoftuar të pandehurve, duke qenë se kërkesa e datës 29.5 ose 6.2014 për dërgimin në gjykatë nga i pandehuri B. K. mban nënshkrimin më 8.5.2014.

Subjektit i është kërkuar të japë shpjegime për gjithë konstatimet e mësipërme duke paraqitur dokumentacion edhe në lidhje me pretendimin për mosparaqitje në seancat gjyqësore.

Veç sa më sipër, denoncuesi pretendon se prokurori me arrestimin e tij qëllimisht ka mbrojtur kushërinin i tij D. Xh., drejtor i *billingut*. Nga kërkimi në internet rezulton një artikull⁹⁶ i datës 1.10.2010, ku shtetasi D. Xh., drejtor i departamentit të faturimit CEZ Shpërndarja, jep shpjegime mbi projektin *** synon leximin e matësve nëpërmjet transmetimit në distancë duke përdorur një pajisje ***. Ndërkohë, në dosje bëhet fjalë për një me kallëzim penal më 20.1.2011 të ZMK-së kundër drejtuesve të shoqërisë, një nga drejtuesit e të cilit ka qenë shtetasi D. Xh. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkuan sqarime dhe dokumente në lidhje me këtë konstatim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

93. Në parashtrimet e veta subjekti ka sqaruar si vijon:

- Në lidhje me konstatimin e parë, subjekti ka sqaruar se më 8.2.2011 ka sekuestruar dokumentacion pranë ERE dhe se në datën 16.3.2011 janë administruar pranë shoqërisë “CEZ Shpërndarje” të gjitha dokumentet shkresore. Subjekti pretendon se për shkak të volumit të këtij dokumentacioni është i justifikueshëm regjistrimi i procedimit penal dy muaj e gjysmë pas regjistrimit të kallëzimit.

- Në lidhje me konstatimin e dytë se për një periudhë gati dyvjeçare nuk janë bërë veprime hetimore, subjekti ka sqaruar *me procesverbalin e datës 27.10.2011 në formë elektronike, janë administruar të dhënat mbi anomalitë nga lista e paraqitur dhe leximet e kaluara normalisht në procesin e billing-ut si lexime, userat përkatës të operatorëve të sistemit të billing-ut (faturimit), si dhe lista e anomalive dhe shpjegimet përkatëse për secilën anomali*. Subjekti pretendon se për shkak të sasisë relativisht të konsiderueshme të dokumentacionit për rreth 10.000 abonentë, është kërkuar shumë kohë për analizim dokumentacioni.

- Në lidhje me konstatimin se arsyetimi për njohje të akteve dhe kryerja e veprimeve që mund të kërkohen nga të pandehurit nuk janë objektivist të justifikueshme për zgjatjen e afatit të hetimeve, subjekti pretendon se një arsyetim i tillë nuk është objektiv dhe i bazuar dhe se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë rrethanat praktike të kryerjes së veprimeve hetimore dhe përmbushjes së detyrimeve procedurale. Nisur nga numri i të pandehurve 15, që secili ka pasur mbrojtës dhe duheshin njoftuar, ky fakt ka krijuar vështirësi për kryerjen e veprimeve procedurale.

- Në lidhje me paqartësinë e datës së dërgimit të çështjes në gjykatë, si dhe nëse kërkesa u është njoftuar të pandehurve, subjekti ka sqaruar se kërkesa për gjykimin mban datën 29.5.2014 dhe është nënshkruar nga të pandehurit në datën 8.5.2014, fakte të vërtetuara nga aktet e dosjes të paraqitura nga subjekti, nga ku rezulton se me shkresën nr. ***, datë 16.6.2014, çështja është dërguar në Gjykatë.

- Në lidhje me pretendimet e ankuesit, mbi mosparaqitjet e subjektit në seancat gjyqësore subjekti ka paraqitur procesverbalet e seancave, ku sipas tij ai ka njoftuar Gjykatën në të gjitha rastet për arsyet, përfshirë këtu qenien i gatshëm dhe detyrimin për të përfaqësuar Prokurorinë në seancat për vleftësimin e arrestimeve në flagrancë, caktimin e masave të sigurimit, për nevoja të ekstradimit dhe seancat e mëtejshme për lejimin e ekstradimit të këtyre shtetasve drejt shteteve të tjera, periudhat e lejeve të zakonshme.

⁹⁶<http://www.arkivalajmeve.com/Faturen-e-dritave-e-lexon-kompjuteri.1046933506/>

- Në lidhje me kërkesën që *subjekti të japë sqarime në lidhje me shtetasin D. Xh. dhe relatat me të, si dhe në lidhje me faktin se a duhet të shqyrtonte çështjen penale objekt verifikimi*, ka sqaruar se shtetasin D. Xh. e ka parë vetëm një herë në jetën e tij kur ai është thirrur nga të pandehurit për të dëshmuar në seancën e datës 17.10.2016 dhe se vetëm në seancën e datës 20.1.2015 është ngritur pretendimi se subjekti ka arrestuar qëllimisht të pandehurit me qëllim shmangien e kushëririt D. Xh. nga përgjegjësia penale, që sipas subjektit u bë nga të pandehurit me synimin e vetëm të largimit të tij nga përfaqësimi i kësaj çështjeje. Subjekti pretendon se pas konsultimit me drejtuesin dhe zv/Drejtuesin e Prokurorisë, i është komunikuar që nuk konstatonin asnjë shkak njëanshmërie dhe se ai është lejuar të vazhdojë të përfaqësojë çështjen në gjykim. Sipas subjektit, ai nuk është ndodhur përpara asnjë prej shkaqeve të parashikuara në nenet 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale. Në prapësimet e tij subjekti nuk dha informacion mbi marrëdhënien e tij me shtetasin D. Xh., ndërsa në seancën e datës 9.9.2022 deklaroi se shtetasi D. Xh. është kushëri i largët i tij. Sipas subjektit, nëse të pandehurit kishin pretendime për shtetasin D. Xh. përse askush prej tyre nuk ka paraqitur ndonjë kallëzim penal ndaj tij. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti paraqiti fashikujt e procedimit penal nr. ***, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe CD audio dhe CD⁹⁷ për leximin *** (nuk hapen), shkresë nr. *** prot., datë 8.9.2022, të Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas së cilës ndaj shtetasit D. S. Xh. i datëlindjes 23.9.1975 nuk rezulton të jetë paraqitur material kallëzues.

Vlerësimi i Komisionit

94. Në analizë të parashtrimeve të subjektit, në përfundim të procesit u evidentua se pretendimet e subjektit qëndrojnë pjesërisht, ndërkohë që ngelen problematikat si vijojnë:

- Subjekti ka regjistruar procedimin penal pas një kohe relativisht të gjatë, tej afatit 30-ditor, ndërkohë që në bazë të udhëzimit nr. ***, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, kërkohet kryerja e një minimumi verifikimesh dhe afati i regjistrimit të procedimit është maksimumi 30 ditë.

- Pas regjistrimit të procedimit, subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për periudha relativisht të gjatë prej 6 muajsh dhe 1 vit e 5 muaj, pa shkaqe ligjore, duke treguar kështu një mënyrë pune joefektive.

- Në lidhje me memon e paraqitur nga palët 25.4.2014, për të cilën subjekti nuk rezulton të jetë shprehur me vendim, subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim. Ndërkohë që duhet të kishte një vendim të marrë prej tij, sikurse parashikohet në nenin 110 të Kodit të Procedurës Penale: *“1.Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim. 2. Organi procedues shprehet me vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve”*. Gjithashtu, subjekti nuk dha asnjë sqarim në lidhje me disa memo të cilave ai i referohet, ndër të tjera, në vendimin për zgjatjen e afateve të hetimit datë 1.3.2014. Në kushtet kur e vetmja memo e administruar mban datën 25.4.2014, është e paqartë dhe e padokumentuar se cilave memo subjekti i referohet.

- Sa i takon pretendimeve për mosparaqitjen në seanca gjyqësore subjekti ka paraqitur procesverbalet e seancave, ku sipas tij ai ka njoftuar gjykatën për arsyet, në të gjitha rastet. Nga verifikimi i këtyre procesverbaleve rezultoi se subjekti nuk është paraqitur në total në 22 seanca gjyqësore, nga të cilat: në një prej tyre ka paraqitur kërkesë me shkrim në gjykatë, pasi nuk ka mundur të lexojë CD, në 2 seanca ka munguar pa paraqitur shkaqe të arsyeshme, në 1 seancë ka munguar pasi ka njoftuar verbalisht se është me pushime, por nuk ka njoftim zyrtar, në 1 seancë ka njoftuar se është me leje të zakonshme, pa e dokumentuar këtë fakt, në 4 seanca ka munguar, por nuk përcaktohet arsyeja, në 7 seanca ka njoftuar se është në seanca masa sigurie, pa e dokumentuar këtë fakt, në 1 seancë ka njoftuar se është në seancë ekstradimi, pa e

⁹⁷Shihni shkresën nr. *** prot., datë 12.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, paraqitur nga subjekti pranë Komisionit me datë 12.9.2022, protokolluar me nr. ***.

dokumentuar këtë fakt, në 1 seancë ka njoftuar se është i zënë me dy çështje, pa e dokumentuar këtë fakt, në 1 seancë ka njoftuar se ka babain në spital, pa e dokumentuar këtë fakt, në 2 seanca ka njoftuar për arsye shëndetësore, pa e dokumentuar këtë fakt, në 1 seancë nuk ka qenë formuar trupi gjyqësor. Siç vërehet, përveç rastit kur subjekti ka vërtetuar shkakun e mosparaqitjes në seancë duke paraqitur kërkesë me shkrim pasi nuk ka mundur të lexojë CD dhe rastit kur nuk është formuar trupi gjyqësor, në asnjë rast tjetër subjekti nuk ka justifikuar me akte shkresore shkaqet e pretenduara prej tij për mosparaqitjen në seanca gjyqësore.

Në konkluzion të gjithë sa më sipër, Komisioni vlerëson se pavarësisht natyrës së çështjes dhe volumit të dokumenteve të administruara, këto rrethana nuk justifikojnë periudhat e gjata të mosveprimeve nga subjekti të konstatuara nga Komisioni. Në përfundim u vlerësua se në trajtimin e çështjes objekt verifikimi subjekti ka pasur: (i) tejkalim dhe, për pasojë zvarritje në regjistrimin e procedimit penal pa shkaqe të justifikuara; (ii) pavarësisht se subjekti nuk ka regjistruar emrat e personave që i atribuohet vepra penale deri në datën 1.12.2013, moment nga i cili do të fillonte afati i hetimeve sipas parashikimit të nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale, vlerësohet se ka zvarritje të hetimeve, pasi për periudha kohore relativisht të gjata, pa shkaqe ligjore subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor; (iii) ka mosmarrje të një vendimi në lidhje me memon e paraqitur nga një prej të pandehurve. Këto shkelje janë të përsëritura nga subjekti i rivlerësimit dhe janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar të çështjes. Veç këtyre, në rastin konkret, ka pasur zvarritje të procesit gjyqësor për shkak të mosparaqitjes së subjektit në seanca gjyqësore, pa shkaqe ligjore dhe/ose pa arsye të justifikuara objektivisht dhe ligjërisht.

Sa i takon relatave me shtetasin D. Xh.

95. Në parashtrime, subjekti nuk ka dhënë asnjë deklaram në lidhje me relatat me këtë shtetas dhe nuk ka bërë përpjekje për të vërtetuar me akte të gjendjes civile lidhjen gjinore me të. Sa i takon deklaramit se ka konsultuar me eprorët pretendimin e ngritur në seancën gjyqësore të datës 20.1.2015 nga të pandehurit, për njëanshmëri për shkak të kushëririt të tij D. Xh., subjekti nuk e ka provuar këtë fakt me ndonjë akt shkresor.

95.1 Me qëllim verifikimit, nëse subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, gjatë procesit të vendimmarrjes, Komisioni iu referua fakteve dhe rrethanave si vijojnë:

- Nga kërkimi në internet rezulton artikulli i publikuar në datën 1.10.2010 nga gazeta “Shqip” me titull “Faturën e dritave e lexon kompjuteri”. Sipas këtij artikulli, z. D. Xh., drejtor i departamentit të faturimit CEZ Shpërndarja, ka dhënë shpjegime rreth faturave të reja të energjisë dhe projektit ***.

- Në procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 20.1.2015, në faqet ***-*** shkruhet: *“Gjykata mbas konsultimit në vend, pyet prokurorin nëse ke shkak njëanshmërie. Prokurori: Nuk kam shkak njëanshmërie, por në kushtet kur ka një pretendim të tillë nga ana e avokatit, unë kërkoj ndërprerjen e seancës për t’u konsultuar me eprorët”.*

- Në procesverbalin e datës 22.9.2016, faqe ***, prokurori Julian Xhengo është pyetur nga gjykata nëse dëshmitari D. Xh. është pyetur si dëshmitar gjatë hetimeve paraprake nga ana e tij. Prokurori ka deklaruar se *nuk e ka kërkuar këtë dëshmitar dhe se do të verifikojë fashikullin e hetimeve, pasi është voluminoz.* Në këtë seancë gjykata i ka lënë si detyrë prokurorit të verifikojë nëse ky dëshmitar është pyetur.

- Në procesverbalin e seancës gjyqësore të mbajtur në datën 7.10.2016, në faqen ***, subjekti ka deklaruar: *“Kam verifikuar dhe rezulton se dëshmitari ka bërë deklarime pasi është pyetur”.*

- Në procesverbalin e seancës gjyqësore të mbajtur në datën 17.10.2016, në faqet ***-***, dëshmitari D. Xh., ndër të tjera, ka deklaruar: *“Kam qenë drejtues i faturimeve në kompaninë CEZ, jam marrë në vitin 2010 në pyetje nga prokuroria, nuk kam punuar në kohën kur ka*

ardhur prokuroria në ndërmarrje, unë nuk kam shkruar në gazetën shqip, nuk jam proceduar nga prokuroria për sa kam qenë aty. Në muajin shkurt jam larguar, kam dhënë dorëheqjen të vitit 2011". Në këtë seancë i pandehuri N. S. e ka pyetur nëse ka lidhje me prokurorin e çështjes dhe z. D. Xh. ka deklaruar se: "Kemi lidhje, e kam kushëri të largët, por këtu po e njoh".

- Në procesverbalin e seancës gjyqësore të mbajtur në datën 1.11.2016, në faqet ***, i pandehuri E. T. pyet dëshmitarin D. Xh. nëse ka dhënë intervistë në gazetën shqip. Si viheshin dhe hiqeshin të dhënat e faturave, i cili është përgjigjur se: "... nuk kam dhënë intervistë në gazetën shqip". Në faqen *** të këtij procesverbali, i pandehuri B. K. shprehet se është i paligjshëm prokurori i çështjes dhe gjykata është shprehur se i tërheq vëmendjen B. K. Në këto momente i pandehuri B. K. largohet nga salla, i cili konteston prezencën e prokurorit.

- Në sistemin e gjendjes civile, nga ku rezultoi se subjekti dhe shtetasi D. Xh. kanë atësi të ndryshme, përkatësisht E. dhe S. Xh. Dy prindërit e tyre kanë atësi të ndryshme, përkatësisht A. dhe J., çka nënkupton se ata nuk janë vëllezër.

95.2. Per nje vleresim sa me objektiv te çështjes, Komisioni iu referua dispozitave ligjore, si vijojnë:

- Neni 16 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: "*Në të njëjtin procedim nuk mund të marrin pjesë si gjyqtarë personat që janë ndërmjet tyre ose me pjesëmarrësit në gjykim, bashkëshortë, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave) ose krushqi e afërt (vjuhërr, vjehërrë, dhëndër, nuse, kunatë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka).*" Sipas kësaj dispozite ligjore subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ai dhe z. D. Xh. nuk janë gjini e afërt.

- Neni 17 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: "*1. Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete: a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditor i tij, i bashkëshortit ose i fëmijëve të tij; b) kur është kujdestar, përfaqësues apo punëdhënës i të pandehurit ose i njëjës nga palët private ose kur mbrojtësi a përfaqësuesi i njëjës prej këtyre palëve është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit të tij; c) kur ka dhënë këshilla ose kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit; ç) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njëjën prej palëve private; d) kur ndonjë prej të afërmeve të tij ose të bashkëshortit është cenuar ose dëmtuar nga vepra penale; dh) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit kryen ose ka kryer funksionet e prokurorit në të njëjtin procedim; e) kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë të parashikuara nga nenet 15 dhe 16; ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie. 2. Deklarimi i heqjes dorë i paraqitet kryetarit të gjykatës përkatëse".*

- Neni 26 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: "*1. Prokurori ka për detyrë të heqë dorë kur ekzistojnë arsye njëanshësie për rastet e parashikuara nga neni 17. 2. Mbi deklarinimin e heqjes dorë vendosin, sipas detyrave përkatëse, drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë, i prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit dhe Prokurori i Përgjithshëm. Për drejtuesit e prokurorive vendosin titullarët e prokurorive të një shkalle më lartë".*

- Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit, në nenin 3, pika 1, parashikon se: "*Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike". Neni 4 parashikon se: "Konflikti i interesit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përfshin disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij. Konkretisht, germa b) përkufizon: "Konflikt në dukje i interesit është gjendja, në të cilën interesat private të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose*

mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë”.

- Në ligjin nr. 96/2016, neni 3/4 parashikon se: “Magjistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykime”; neni 4/2 parashikon se: “Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar: a) dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij; b) reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë; c) statusin e funksionit të magjistratit”.

Vlerësim përfundimtar

96. Nisur nga fakti që shtetasi D. Xh. ka qenë drejtor i faturimeve në shoqërinë “CEZ Shpërndarje” dhe të gjithë të akuzuarit kanë qenë faturistë në varësi të tij, subjekti i ka pasur mundësitë dhe duhet të verifikonte çfarëdolloj lidhje gjinore me këtë shtetas për shkak të mbiemrit të njëjtë. Edhe nëse marrim të mirëqenë pretendimin e subjektit se nuk e ka njohur shtetasin D. Xh. dhe nuk ka pasur relata me të në momentin e nisjes së hetimeve, pasi u njoh me pretendimin e të pandehurve në seancat gjyqësore, nga Komisioni vlerësohet se ai duhet të jepte dorëheqjen nga përfaqësimi në gjykimin e çështjes, duke paraqitur kërkesë me shkrim mbi të cilën do të vendoste më pas drejtuesi i prokurorisë, me qëllim për të shmangur çdo situatë që mund të çonte në një konflikt interesi, qoftë edhe në dukje me shtetasin D. Xh., i cili në seancën e datës 22.9.2016 ka deklaruar: “*Kemi lidhje, e kam kushëri të largët, por këtu po e njoh*”.

Për më tepër, në kushtet kur në cilësinë e të pandehurve ka qenë jo një apo dy persona, por 15 shtetas të gjithë punonjës/faturistë pranë shoqërisë “CEZ Shpërndarja” ku z. D. Xh. ka qenë drejtues (në procesverbalin e seancës gjyqësore të mbajtur në datën 17.10.2016, ka deklaruar “*Kam qenë drejtues i faturimeve në kompaninë CEZ ... Në muajin shkurt jam larguar, kam dhënë dorëheqjen të vitit 2011*”, si dhe, në kushtet kur në mënyrë të përsëritur është kërkuar dorëheqja e subjektit nga pjesëmarrja në gjykimin e çështjes, në zbatim të nenit 4/2 të ligjit nr.96/2016, subjekti duhet të merrte të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij, reputacionin e organit që përfaqëson, besimin e publikut në sistemin e prokurorisë dhe statusin e funksionit të magjistratit, në funksion të garantimit të paanshmërisë në proces.

Pyetja që shtron subjekti si argument se përse të akuzuarit nuk e kishin ngritur këtë pretendim më parë, nuk e zhvesh atë nga detyrimi ligjor për ushtrimin e detyrës me objektivitet duke shmangur çdo shkak situatë konflikti interesi apo njëanshmërie, ashtu sikurse parashikohet në dispozitat e sipërpërmendura.

Ndodhur në kushtet e sipërpërmendura, sipas nenit 26 të Kodit të Procedurës Penale, i cili i referohet nenit 17 të këtij ligji, subjekti ka pasur për detyrë të heqë dorë për shkak se kanë ekzistuar shkaqe të rëndësishme njëanshmërie. Nga ana tjetër, sipas përkufizimit të konfliktit në dukje të interesit, *interesat private të zyrtarit duken në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë*. Siç vërehet, qenia në kushtet e këtij lloji konflikti interesi nuk kërkon domosdoshmërisht ardhjen e ndonjë pasoje. Në këto kushte, subjekti ndodhet në kushtet e një konflikti në dukje të interesit gjatë trajtimit të çështjes objekt denoncimi të shtetasit B. K., fakt që është mbajtur në konsideratë gjatë vlerësimit përfundimtar të aftësive profesionale të subjektit, në drejtim të etikës profesionale.

97. Denoncim nga shtetasi H. Sh.⁹⁸

Shtetasi H. Sh. denoncon subjektin e rivlerësimit, midis të tjerash, edhe për tejkalim të afateve ligjore gjatë hetimit të procedimit penal nr. ***, për të cilin ka vendosur pushimin më 2.9.2016 dhe se nuk ka kryer asnjë veprim hetimor.

97.1. Me qëllim verifikimin e pretendimeve, me kërkesë të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁹⁹ vuri në dispozicion fashikullin e procedimit penal nr. ***. Në përfundim të hetimit administrativ, nga shqyrtimi i akteve të dosjes duket se:

i) Subjekti ka regjistruar procedimin penal pa autor rreth 7 muaj pas regjistrimit të kallëzimit penal, tej afatit 30-ditor sipas udhëzimit nr. ***, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, dhe 9 muaj pas regjistrimit të procedimit penal vendosi pushimin, pa konkretizuar asnjë veprim hetimor si pyetja e shtetasve K. Sh. dhe D. Sh. në lidhje me pretendimet e ngritura në kallëzim.

ii) Arsyetimi i pushimit të procedimit nga subjekti, me argumentin se për të njëjtin fakt është regjistruar procedimi penal nr. *** dhe është dërguar për gjykim shtetasi D. Sh., është jologjik, pasi ky procedim i referohet faktit penal të ndodhur më 26.5.2015 nga shtetasi D. Sh., ndërsa në procedimin penal nr. *** të trajtuar nga subjekti, fakti i kallëzuar i referohet ngjarjes së ndodhur më 29.5.2015 nga shtetasi K. Sh.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkuan sqarime dhe dokumente në lidhje me këto konstatime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

97.2. Në parashtrimet e veta subjekti ka paraqitur sqarime si vijon:

- Në lidhje me regjistrimin e procedimit penal nr. ***, 7 muaj pas regjistrimit të kallëzimit penal përtej afatit të përcaktuar në udhëzimin nr. ***, datë 21.11.2005, subjekti i rivlerësimit parashtrroi se shkak ka qenë ngarkesa në punë, duke shpjeguar se në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale nuk parashikohet ndonjë afat kohor konkret.

- Në lidhje me konstatimin se 9 muaj pas regjistrimit të procedimit penal është vendosur pushimi, pa konkretizuar veprime hetimore si pyetja e shtetasve K. Sh. dhe D. Sh., ka sqaruar se në datën 6.1.2016 ka përpiluar urdhrin për delegimin e veprimeve hetimore OPGJ-së, ku është përcaktuar edhe pyetja e shtetasve D. e K. Sh.. Sipas subjektit, OPGJ-ja ka kërkuar të pyesë shtetasit në fjalë, por urdhrat për paraqitjen e tyre janë kthyer në prokurori me shënimin “Nuk u gjend” nga ftuesi i Prokurorisë.

- Në lidhje me konstatimin se në këtë rast ka të bëjë jo me një fakt penal të vetëm, por me dy fakte të ndryshme penale me argumentin se procedimi penal nr. *** është regjistruar për ngjarjen e ndodhur në datën 26.5.2015, ndërsa procedimi penal nr. *** është regjistruar për ngjarjen e ndodhur në datën 29.5.2015, subjekti pretendon se është i pabazuar dhe në interpretim të gabuar të ligjit material penal. Subjekti pretendon se në të dyja kallëzimet penale është e njëjta ngjarje, e cila përbën të njëjtin fakt penal.

Në mbështetje të prapësimeve të tij, subjekti paraqiti kopje të dosjes së procedimit penal nr. ***, fashikullin e gjykimit të procedimit penal nr. ***, kopje të vendimit nr. ***, datë 25.1.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të pa firmosur dhe vulosur, si dhe statistikën e ngarkesës në punë, shkresë datë 13.9.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, sipas së cilës kundër vendimit të pushimit të hetimeve të procedimit penal nr. *** nuk është paraqitur ankim në gjykatë.

⁹⁸Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 1.3.2018, në dosjen e Komisionit.

⁹⁹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.6.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

Vlerësimi i Komisionit

97.3. Në analizë të parashtrimeve të subjektit, në përfundim të procesit, u evidentua se pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë pasi:

- Subjekti ka regjistruar procedimin penal pas një kohe relativisht të gjatë prej 7 muajsh nga regjistrimi i kallëzimit penal, ndërkohë që në bazë të udhëzimit nr. ***, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, kërkohet kryerja e një minimumi verifikimesh dhe afati i regjistrimit të procedimit është maksimumi 30 ditë. Ngarkesa në punë e subjektit, sikurse ai pretendon, nuk mund të përbejë shkak për një tejkalim të tillë afati.

- Sa i takon pretendimit se në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale nuk parashikohet ndonjë afat kohor, është i vërtetë, por, bazuar në nenin 24/4 të Kodit të Procedurës Penale *urdhrrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshme për prokurorin më të ulët.*

- Konstatimi se pas regjistrimit të procedimit penal, për një periudhë 9-mujore deri në pushimin e procedimit, nuk janë pyetur shtetasit D. dhe K. Sh., sipas subjektit është i gabuar, pasi ai ia ka deleguar këto veprime OPGJ-së. Ky pretendim vlerësohet i pabazuar, pasi bazuar në nenin 24/1 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore. Po ashtu, bazuar në nenin 304 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori drejton veprimtarinë hetimore dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm. Sipas kësaj dispozite ligjore, subjekti duhet të merrte masat për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore për të mundësuar pyetjen e këtyre dy shtetasve, gjë që nuk rezultoi ta ketë bërë.

- Sa i takon pretendimit se në të dyja kallëzimet penale është e njëjta ngjarje, e cila përbën të njëjtin fakt penal, nga Komisioni vlerësohet se nuk qëndron, pasi: së pari, në kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. *** të shtetasit E. Gj., në ngarkim të shtetasit D. Sh. për veprën penale të vetëgjyqësisë, nuk rezultoi të jetë përmendur ngjarja e datës 29.5.2015 dhe as shtetasit K. Sh. apo D. Sh.; së dyti, në vendimin për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, subjekti nuk i referohet procesverbalit për marrjen e të dhënave nga kallëzuesi H. Sh., i cili specifikisht ka deklaruar se në datën 29.5.2015 ka parë shtetasin K. Sh. që po kosiste grurin tek ara e tij, si dhe është shprehur edhe për ngjarjen e datës 26.5.2016.

Në konkluzion të të gjithë sa më sipër është arsyetuar, nga Komisioni vlerësohet se në këtë çështje ka pasur zvarritje për shkak të regjistrimit të procedimit penal tej afatit, si dhe 9 muaj pas regjistrimit të procedimit penal ka vendosur pushimin, pa kryer hetime të plota të drejtuara prej tij, pa shkaqe ligjore. Këto shkelje janë të përsëritura nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar të çështjes.

98. Denoncim nga shtetasi M. P.¹⁰⁰

Denoncuesi pretendon se subjekti ka zvarritur procesin në ngarkim të tij, qëllimisht, për 1 vit e 1 muaj dhe se ka informacion se është i korruptuar. Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur nga denoncuesi, u konstatua se:

- me urdhrin datë 29.10.2014, prokurori Julian Xhengo ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike”, në ngarkim të shtetasit M. P.;

- me vendim të datës 29.1.2015 prokurori Julian Xhengo ka vendosur zgjatjen e afatit hetimor për një periudhë tremujore, nga data 29.1.2015 deri më 29.4.2015, me argumentin se shtetasi M. P. ka mohuar të ketë ndërhyrë në sistemin e matjes së energjisë dhe se pretendon se mund të ketë ndërhyrë dikush tjetër dhe është e nevojshme kryerja e veprimeve për verifikimin e pretendimeve;

¹⁰⁰Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 5.4.2018, në dosjen e Komisionit.

- me vendim të datës 29.4.2015 prokurori Julian Xhengo ka vendosur zgjatjen e afatit hetimor për një periudhë tremujore, nga data 29.1.2015 deri më 29.7.2015, me të njëjtin argument (*copy paste*) si vendimi i mëparshëm;

- me vendim të datës 29.7.2015 prokurori Julian Xhengo ka vendosur zgjatjen e afatit hetimor për një periudhë tremujore, nga data 29.7.2015 deri më 29.10.2015, me të njëjtin argument (*copy paste*) si dy vendimet e mëparshme.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektivit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me zvarritjen e afateve të hetimit, veprimet e kryera prej tij, shoqëruar me akte nga dosja e procedimit penal nr. ***.

Qëndrimi i subjektivit të rivlerësimit

98.1. Në parashtrime subjektivit ka paraqitur sqarime, si vijon:

- Së pari, ka pasur disa diskutime me zv/Drejtnesin e Prokurorisë për mënyrën se si do të konkludohej në përfundim, por këto diskutime nuk janë pasqyruar në procesverbale. Sy dyti, një fakt i tillë ka ardhur për shkak të ngarkesës në punë. Së treti, i pandehuri është njohur me vendimet për zgjatjen e afateve dhe nuk i ka ankimuar në gjykatë dhe se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit M. P.

Në mbështetje të pretendimeve të tij subjektivit paraqiti shkresën datë 31.8.2022 të Gjykatës së Lartë, bashkëngjitur, dosjen e gjykimit të procedimit penal nr. *** në ngarkim të shtetasit M.P. dhe vendimin nr. ***, datë 25.4.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 7.3.2018, nga Gjykata e Apelit, me anë të të cilit shtetasi M. P. është deklaruar fajtor.

Vlerësimi i Komisionit

98.2 Në analizë të parashtrimeve të subjektivit, në përfundim të procesit, u evidentua se pretendimet e subjektivit nuk qëndrojnë pasi:

- Argumenti se ka pasur diskutime me zv/Drejtnesin e Prokurorisë për mënyrën e konkludimit, mbetet i paprovuar.

- Sa i takon konstatimit për zgjatjen e afateve sipas dy vendimeve me të njëjtin arsyesim marrë me *copy paste* nga vendimi i parë, me argumentin e vetëm se është e nevojshme kryerja e veprimeve për verifikimin e pretendimeve të të pandehurit, subjektivit pretendoi se kjo ka ardhur për shkak të ngarkesës në punë. Ndërkohë, i pyetur në seancë dëgjimore në lidhje me mosarsyesimin e vendimeve për zgjatjen e hetimeve, subjektivit u shpreh se kjo ka ndodhur për të ruajtur sekretin hetimor. Asnjë prej argumenteve të subjektivit nuk justifikon shtyrjen e afatit të hetimeve me dy vendimet e fundit me të njëjtin arsyesim, i cili duhet të bëhet vetëm në rastet e çështjeve komplekse ose për arsye objektive, sipas nenit 324/2 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se "*Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur*", pasi në rastin konkret nuk u vërtetua kompleksiteti i çështjes dhe as arsye objektive të tilla që të justifikojnë shtyrjen e afateve hetimore me dy vendime, pas të cilave nuk rezulton të jetë kryer ndonjë veprim hetimor.

- Ndonëse nuk rezultoi të jetë bërë ankim kundër vendimeve për zgjatjen e afateve, sikurse subjektivit pretendon, kjo nuk justifikon zgjatjen e hetimeve apo moskryerjen e veprimeve hetimore, në përputhje me parashikimet e nenit 324/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Në konkluzion të të gjithë sa më sipër, nga Komisioni vlerësohet se në këtë çështje ka pasur zvarritje të hetimeve nga ana e subjektivit të rivlerësimit, për shkak të shtyrjes dy herë të afatit të hetimeve për shkaqe jo të justifikuar sipas parashikimeve të nenit 324/2 të Kodit të Procedurës

Penale. Këto shkelje janë të përsëritura nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar të çështjes.

Pretendimet e denoncuesit në lidhje me korrupsionin mbeten të pavërtetuara.

99. Denoncim nga shtetasi A. Ç.¹⁰¹

Denoncuesi pretendon se prokurori Julian Xhengo ka ngritur akuzë ndaj tij, pa të drejtë ligjore dhe fakte, çështja ka zgjatur përtej afatit ligjor 3-mujor dhe pas më shumë se dy vjetësh e ka njoftuar si person i pandehur, si dhe nuk ka kryer asnjë veprim hetimor nga data 19.12.2014 deri më 2.9.2016, kur ka regjistruar emrin e personit që i atribuohet vepra penale.

99.1 Për verifikimin e pretendimeve në lidhje me kohëzgjatjen e hetimeve, me kërkesë të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁰² vuri në dispozicion fashikullin e procedimit penal nr. ***. Në përfundim të hetimit administrativ, nga shqyrtimi i akteve të dosjes, duket se:

i) Regjistrimi i procedimit penal është bërë mbi tre muaj pas regjistrimit të kallëzimit të penal, tej afatit 30-ditor, parashikuar udhëzimit nr. ***, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar.

ii) Nga data 19.12.2014 e regjistrimit të procedimit penal dhe deri në datën 2.9.2016 të regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, ka zgjatur 1 vit e 8 muaj pa u kryer asnjë veprim hetimor dhe nisur nga natyra e veprës penale dhe në bazë të pikës 3 të udhëzimit nr. ***, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, mosregjistrimi i emrit të personit me regjistrimin e procedimit penal ka çuar në zvarritje të hetimeve.

iii) Nuk rezulton të jenë administruar procesverbalet e kallëzimit të veprës penale D. M. dhe Q. D.; nuk rezulton të jetë administruar dëshmi penaliteti për të pandehurin.

iv) Shkresa për dërgimin e kërkesës për gjykim është pa datë dhe nënshkrim ndërsa nuk rezulton të jetë dokumentuar njoftimi i palës së dëmtuar, sipas parashikimit të nenit 331/3 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nuk është dokumentuar data e dërgimit të kërkesës në gjykatë.

v) Nuk rezulton të jetë i dokumentuar njoftimi i akuzës mbrojtësit të të pandehurit, sipas parashikimit të nenit 34/1 të Kodit të Procedurës Penale.

vi) Shtetasi A. Ç. është pyetur në cilësinë e të pandehurit nga OGJ-ja pa praninë e avokatit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 304/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe pikës 2 të udhëzimit nr. 3, datë 8.3.2007, të Prokurorit të Përgjithshëm¹⁰³.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkuan sqarime dhe dokumente në lidhje me këto konstatime:

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

99.2. Në parashtrime subjekti ka paraqitur sqarime të detajuara, bazuar në dokumente shkresore, si vijon:

- Në lidhje me konstatimin se regjistrimi i procedimit penal është bërë mbi tre muaj pas regjistrimit të kallëzimit të penal, tej afatit 30-ditor, parashikuar udhëzimit nr. ***, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, pretendon se: *“Së pari shtetasja A. Ç. nuk kërkonte*

¹⁰¹Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 30.4.2018, në dosjen e Komisionit.

¹⁰²Shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.6.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

¹⁰³“2. Njoftimi i akuzës dhe pyetja e të pandehurit janë veprime hetimore të prokurorit, të cilat duhet të kryhen nga ai vet dhe përjashtimisht me urdhër delegimi të posaçëm të tij mund të kryhen nga oficeri i policisë gjyqësore.

2.1 I pandehuri duhet dëgjuar nga prokurori, për të vlerësuar pretendimet e tij dhe për të vendosur se çfarë duhet të bëhet me to. 2.2 Nuk duhet të ndodhë që prokurori të shikohet me të pandehurin vetëm në sallën e gjyqit”.

ushtrimin e ndjekjes penale ndaj shtetasit A. Ç. dhe se nga ana e OPGJ-së u bënë përpjekje për verifikimin nëse kishte ndonjë çështje tjetër penale të regjistruar për këtë fakt penal dhe, më pas, ky oficer u transferua në një prokurori tjetër”.

- Në lidhje me konstatimin se për periudhën prej 1 vit e tetë muaj nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, subjekti pretendon se një gjë e tillë ka ardhur për shkak të mbingarkesës në punë.

- Në lidhje me konstatimin se nuk rezulton të jenë administruar procesverbalet e kallëzimit të veprës penale D. M. dhe Q. D., subjekti pretendon se është pasaktësi apo lapsus i Komisionit, pasi në rastin konkret nuk rezultojnë të jenë të dëmtuara shtetaset D. M. dhe Q. D.

- Në lidhje me konstatimin se shkresa për dërgimin e kërkesës për gjykim është pa datë dhe nënshkrim, si dhe nuk rezulton të jetë dokumentuar njoftimi sipas parashikimit të nenit 331/3 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti sqaroi se kërkesa mban datën 7.11.2016, ndërsa nëse bëhet fjalë për shkresën përcjellëse të dërgimit të fashikullit të hetimit në Gjykatë sqaroi se, megjithëse, ka paraqitur kërkesën në gjykatë për vënien në dispozicion të fashikujve të gjykimit për gjitha çështjet për të cilat i është kërkuar të japë shpjegime në rezultatet e hetimit administrativ nuk i është vënë në dispozicion, por fakti që kjo çështje është gjykuar nga Gjykata tregon që kjo çështje është përcjellë nga Prokuroria në Gjykatë. Subjekti nuk paraqiti dokumente shkrese për të vërtetuar pretendimin se ka paraqitur kërkesën në gjykatë për vënien në dispozicion të fashikujve të gjykimit.

- Në lidhje me konstatimet se nuk rezulton të jetë i dokumentuar njoftimi i akuzës mbrojtësit të të pandehurit dhe se shtetasi A. Ç. është pyetur në cilësinë e të pandehurit nga OPGJ-ja pa praninë e avokatit, subjekti sqaroi se i pandehuri nuk ka zgjedhur mbrojtës dhe as kërkuar nga organi procedues që t'i caktohej një mbrojtës. Sa i përket konstatimit se është pyetur në cilësinë e të pandehurit nga OPGJ-ja pa praninë e avokatit, sqaroi se mbrojtja e detyrueshme për të pandehurin në Kodit të Procedurës Penale të asaj kohe, ishte e përcaktuar vetëm në rastet e të pandehurve që nuk kishin mbushur moshën 18 vjeç dhe në rastet e personave me të meta fizike apo psikike. Gjithashtu, sqaroi se mbrojtësi ka kërkuar pavlefshmëri të akteve hetimore, por nga ana e gjykatës nuk janë pranuar.

Në mbështetje të pretendimeve të tij subjekti paraqiti dosjen e procedimit penal nr. *** dhe vendimin nr. ***, datë 5.5.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe statistikat e ngarkesës në punë.

Vlerësimi i Komisionit

99.3. Në analizë të parashtrimeve të subjektit, në përfundim të procesit, u evidentua se pretendimet e tij qëndrojnë pjesërisht, ndërkohë që ngelen problematikat si vijojnë:

- Argumentet e subjektit në lidhje me regjistrimin e procedimit penal pas një kohe relativisht të gjatë prej 3 muajsh nga regjistrimi i kallëzimit penal, nuk justifikojnë shtyrjen e afatit, pasi sipas udhëzimit nr. ***, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, kërkohet kryerja e një minimumi verifikimesh dhe afati i regjistrimit të procedimit është maksimumi 30 ditë.

- Pas regjistrimit të procedimit, subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë relativisht të gjatë prej dhe 1 vit e 8 muaj pa shkaqe ligjore, pasi, mosveprimi nga ana e subjektit nuk justifikohet me ngarkesën në punë.

- Sa i takon pretendimit se Komisioni ka konstatuar në mënyrë të pasaktë mangësinë e procesverbaleve të shtetaseve D. M. dhe Q. D., është i pabazuar dhe jo i përshtatshëm, pasi në vendimin e njoftimit të akuzës dhe kërkesës për gjykimin e çështjes ndaj shtetasit A. Ç., ndër të tjera, subjekti është shprehur se akuza mbështetet në procesverbalet e shtetaseve D. M. dhe Q. D., fakt ky i konstatuar edhe nga mbrojtësi i të pandehurit në gjykatë.

- Sa i takon shkresës përcjellëse të dërgimit të fashikullit, vlerësohet se subjekti nuk dha sqarime të plota, pasi nuk paraqiti dokument shkresor të vërtetuar se ka bërë kërkesë në gjykatë për marrjen e këtij fashikulli. Në dosje nuk rezulton të jetë dokumentuar marrja dijëni nga i pandehuri e kërkesës për gjykim, sipas parashikimit në nenin 331/3 të Kodit të Procedurës Penale: “Kërkesa u njoftohet të pandehurit dhe të dëmtuarit”.

Në konkluzion të të gjithë sa më sipër, nga Komisioni vlerësohet se në këtë çështje, përveç mangësive të tjera evidentuar si më sipër, ka pasur zvarritje të hetimeve nga ana e subjektit të rivlerësimit për shkak se regjistrimi i procedimit penal është bërë tre muaj pas regjistrimit të kallëzimit penal. Pas regjistrimit të procedimit, për një periudhë kohore prej 1 vit e 8 muaj nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, pa shkaqe ligjore, duke treguar kështu një mënyrë pune jo efektive. Këto shkelje janë të përsëritura nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar të çështjes.

100. Denoncim nga shtetasi Y. H.¹⁰⁴

Shtetasi Y. H. denoncon subjektin së bashku me një gjyqtar dhe OPGJ, si grup i strukturuar kriminal për shkelje të ligjit, tejkalim të kompetencave dhe shpërdorim detyre për arrestimin e tij, zvarritje të procesit, kontakt të papërshtatshëm, pasi nuk është pyetur dhe nuk ka pasur dijëni mbi kallëzimin ndaj tij, se çështja është mbajtur në sirtar prej 1 vit e ca dhe se nuk ka pasur prova. Nga analizimi i dokumenteve të paraqitura nga denoncuesi, rezultoi se:

- i) nga data 29.12.2015 e regjistrimit të procedimit deri në datën 30.3.2017 të dërgimit të vendimit për pushimin e çështjes, ka zgjatur mbi një vit e tre muaj;
- ii) nga data e kërkesës së caktimit të masës së sigurisë 8.7.2016, e cila duket se është dhe data e regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, deri më 30.3.2017 të dërgimit të vendimit të pushimit të procedimit penal, çështja ka zgjatur mbi 8 muaj e 22 ditë, tej afatit 3-mujor;
- iii) nga data e zgjatjes së afatit të hetimeve deri më 30.3.2017, nuk rezulton të jetë kryer ndonjë veprim hetimor nga ana e prokurorit në kuptim të grumbullimit të provave.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkuan sqarime dhe akte të ndodhura në dosjen e procedimit penal nr. ***, në lidhje me këto konstatime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

100.1. Në parashtrimet e veta subjekti ka paraqitur sqarime të detajuara bazuar në dokumente shkresore, si vijon:

Nga data e zgjatjes së afatit të hetimeve deri më 30.3.2017, janë kryer veprime hetimore në kuptim të grumbullimit të provave, pasi gjatë kësaj kohe janë pyetur shtetasit Y. H. (datë 12.10.2016), M. H. (datë 22.11.2016), Sh. J. (datë 27.12.2016), K. N. (datë 17.01.2017), A. H. (datë 16.2.2017), O. C. (datë 23.2.2017), si dhe janë administruar akte nga fashikulli i mosfillimit të hetimeve për kallëzimin penal nr. *** të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (datë 9.1.2017). Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti paraqiti fashikullin e procedimit penal nr. *** dhe vendimin nr. ***, datë 6.6.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vlerësimi i Komisionit

100.2. Në analizë të parashtrimeve të subjektit, në përfundim të procesit, u evidentua se pretendimet e subjektit qëndrojnë dhe në këtë çështje nuk ka pasur zvarritje të hetimeve nga ana e subjektit të rivlerësimit. Kjo çështje është ankimuar nga kallëzuesja në dy shkallët e gjyqësorit, të cilat kanë vendosur rrëzimin e kërkesës së saj, ku arsyetohet se prokuroria ka kryer një hetim të plotë.

¹⁰⁴Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 8.10.2018, në dosjen e Komisionit.

Sa i takon pretendimeve të denoncuesit në lidhje me vendimmarrjen, vlerësimin e provave dhe logjikën nga ana e prokurorit, bazuar në nenin 73, pika 4, të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet, vlerësimi i pretendimeve të denoncuesit del jashtë tagrit të vlerësimit të Komisionit, si dhe vendimi i pushimit është bërë edhe objekt shqyrtimi në dy shkallët e gjyqësorit, duke e lënë në fuqi.

101. Denoncim nga shtetasi S. H.¹⁰⁵

Denoncuesi ngre pretendimin për zvarritje të procesit hetimor, moskryerje të procedurës së rregullt ligjore, pasi nuk është thirrur asnjëherë nga ana e tij, se edhe pse ka kërkuar informacion lidhur me çështjen e tij për falsifikim deklarate noteriale nga noterja M. Ll. Gjithashtu pretendon se nuk ka marrë informacion nga ana e prokurorit dhe ngre dyshimin se subjekti është korrupsionist nga noterja M. Ll.

101.1. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkuar sqarime të informojë nëse kallëzimi penal nr. ***, viti 2018, që sipas vendimit të prokurores F. V. të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës datë 17.10.2018, i ka kaluar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është trajtuar nga subjekti i rivlerësimit dhe në rast se po, të sqarojë mbi veprimet e kryera prej tij duke shoqëruar dhe me aktet nga dosja. Në parashtrimet e tij lidhur me këtë kërkesë subjekti ka sqaruar se:

- Procedimi është regjistruar në datën 31.10.2018 mbi bazën e vendimit për shpalljen e moskompetencës tokësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Pas kryerjes së hetimeve prej tij, ka vendosur dërgimin për gjykim të çështjes penale nr. *** në ngarkim të shtetases M. N. dhe me vendimin nr. ***, datë 17.5.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur deklarimin fajtores të të pandehurës.

- Në mbështetje të prapësimeve të tij, subjekti vuri në dispozicion fashikullin e gjykimit të çështjes penale në ngarkim të të pandehurës M. N.; vendim nr. ***, datë 17.5.2021 dhe nr. ***, datë 7.3.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vlerësimi i Komisionit

101.2 Në analizë të parashtrimeve të subjektit, në përfundim të procesit, u evidentua se pretendimet e subjektit qëndrojnë.

102. Shtatë denoncime nga shtetasi S. T.¹⁰⁶

Denoncuesi ngre pretendime për një grup gjyqtarësh dhe prokurorësh, si grup i strukturuar kriminal në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me pasurinë e familjes së tij. Në lidhje me subjektin pretendon se ka zvarritje të procesit pasi ai po heton procedimet penale nr. ***, nr. ***, nr. ***, me kallëzues S. T. dhe pas 3 vjetësh ende nuk kanë përfunduar. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuar sqarime të informojë dhe të japë sqarime në lidhje me pretendimet e denoncuesit për zvarritje të hetimeve duke shoqëruar me akte nga dosja.

102.1 Në prapësimet e tij subjekti ka sqaruar se: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 13.3.2017, ka regjistruar procedimin penal nr. *** mbi bazën e kallëzimit penal nr. *** të paraqitur nga ky shtetas. Më këtë procedim penal janë bashkuar më pas procedimet penale nr. ***, si dhe procedimi penal nr. ***, i dërguar për kompetencë nga Prokuroria e Posaçme Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit. Subjekti sqaroi se ky procedim penal është në hetim dhe paraqit shkresë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë datë 7.9.2022, sipas të cilit procedimi nr. *** ndodhet ende në fazën e hetimeve paraprake. Bazuar në nenin E, pika 2, fjalía e fundit, të Aneksit të Kushtetutës së

¹⁰⁵Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 9.5.2019, në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁶Shihni denoncimin nr. *** prot.; nr. ***, nr. ***, datë 22.5.2019 dhe nr. *** prot., datë 19.6.2019 dhe nr. *** prot., datë 13.9.2019 dhe nr. *** prot., datë 15.1.2020 dhe nr. *** prot., datë 28.7.2020, në dosjen e Komisionit.

Shqipërisë, i cili parashikon se vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, nga ana e Komisionit ky procedim penal nuk iu nënshtrua verifikimeve të mëtejshme.

103. Denoncim nga shtetasi E. L.¹⁰⁷

Denoncuesi ngre pretendimin se prokurori Julian Xhengo ka zvarritur procesin mbi tre muaj, si dhe ngre pretendime në lidhje me vendimmarrjen e subjektit, sa i përket kallëzimit penal të paraqitur në datën 4.2.2019, pasi nuk ka kryer veprime hetimore për identifikimin e personit që e kishte kërcënuar në ambientet e gjykatës. Me qëllim verifikimin e këtyre pretendimeve, me kërkesë të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁰⁸ vuri në dispozicion fashikullin e kallëzimit penal nr. ***. Në përfundim të hetimit administrativ, nga shqyrtimi i akteve të dosjes, duket se: (i) vendimi i mosfillimit të procedimit është marrë rreth 4 muaj pas regjistrimit të kallëzimit, pra shumë kohë përtej afatit 15-ditor të parashikuar nga neni 291, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale; (ii) mbetet e paqartë data e njoftimit të vendimit kallëzuesit, si dhe nëse ndaj tij është ushtruar ankim në gjykatë. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkuan sqarime dhe dokumente në lidhje me këto konstatime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

103.1. Në parashtrime subjekti ka sqaruar si vijon:

- Në lidhje me marrjen e vendimit të mosfillimit të hetimeve tej afatit 15 ditor të parashikuar nga neni 291/1 i K.Pr.Penale, subjekti pranon se ky konstatim është i bazuar por sqaron se një gjë e tillë ka ardhur për shkak të mbi ngarkesës në punë.

- Në lidhje me paqartësinë e njoftimit të vendimit të mosfillimit të hetimeve për shtetasin E. L., ka sqaruar se nga ana e tij është përpiluar shkresa përcjellëse për njoftimin e vendimit të mosfillimit të hetimeve në adresën që ky shtetas ka dhënë në kallëzimin penal. Ai shpjegoi se ky shtetas rri brenda oborrit të godinës së prokurorisë dhe ka paraqitur 25 kallëzime penale për të cilat nga prokurorë të ndryshëm të kësaj prokurorie është vendosur mosfillimi i hetimeve.

- Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur dosjen e mosfillimit të hetimeve, ku ndodhet shkresa përcjellëse por pa datë, kërkesë datë 31.08.2022 drejtuar Prokurorisë Tiranë, ku subjekti ka kërkuar informacion mbi kallëzimet e denoncuesit dhe vendimmarrjen e prokurorëve për këto kallëzime, kthim përgjigje datë 08.09.2022 e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë ku pasqyrohen 25 kallëzimet e paraqitura nga ky denoncues për të cilat është vendosur mosfillim, akt ekspertimi mjeko ligjor nr. *** datë 08.11.2021 sipas të cilit ky shtetas vuan nga sëmundja e shëndeti mendor.

Vlerësimi i Komisionit

103.2. Në analizë të parashtrimeve të subjektit, në përfundim të procesit, u evidentua se pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë pasi:

- Vendimi i mosfillimit të procedimit, i marrë pas një kohë relativisht të gjatë prej 4 muajsh, tej afatit prej 15 ditë të parashikuar në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, është pa shkaqe ligjore dhe nuk justifikohet me ngarkesën në punë, pasi në këto raste kërkohet kryerja e një numri minimal veprimesh verifikuese.

- Sqarimet e subjektit se ka përpiluar shkresën përcjellëse për njoftimin e vendimit të mosfillimit të hetimeve në adresën që ky shtetas ka dhënë në kallëzimin penal, vlerësohen jo të plota e të qarta, pasi në kallëzim, kallëzuesi ka paraqitur adresë të plotë, numër telefoni dhe adresë *email*-i. Në bazë të nenit 291/2 të Kodit të Procedurës Penale, vendimi i mosfillimit, duhej t'i njoftohej menjëherë, në mënyrë që kallëzuesi të ushtronte të drejtën e ankimit në

¹⁰⁷Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 21.10.2019, në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁸Shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.6.2018 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

gjykatë dhe është detyrë e prokurorit të mbikëqyrë dërgimin pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.

Këto shkelje janë të përsëritura nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar të çështjes. Subjekti nuk dha sqarime nëse ndaj vendimit të mosfillimit të hetimeve është ushtruar ankim, sikurse iu kërkua nga Komisioni, ndërkohë që, në kërkesën drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk e ka kërkuar një informacion të tillë. Për këto arsye, sqarimet e subjektit vlerësohet se nuk janë të plota. Sa i takon pretendimit në lidhje me vendimmarrjen, vlerësimin e provave nga ana e prokurorit, në zbatim të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 del jashtë tagrit të Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit apo të vlerësojë interpretimin ose logjikën e prokurorit.

104. Denoncim nga shtetasi K. G.¹⁰⁹

Denoncuesi ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për dijëni dhe Komisionit ndaj subjektit dhe prokurorit M. M. dhe disa shtetasve dhe institucioneve shtetërore, nga përmbajtja e të cilit ai ngre dyshimin se subjekti në bashkëpunim me prokuroren M. M. kanë shkelur nenin 319/ç të Kodit Penal dhe mund të kenë përfituar të mira materiale, si dhe shkelje të afateve hetimore, sa i takon dosjeve penale nr. ***, nr. *** dhe nr. ***. Me qëllim verifikimin e pretendimit për shkelje të afateve hetimore, me kërkesë të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹¹⁰ vuri në dispozicion fashikujt e procedimit penal nr. ***, bashkuar me procedimet nr. *** dhe nr. ***. Në përfundim të hetimit administrativ, nga shqyrtimi i akteve të dosjes, duket se:

i) nga data e regjistrimit të kallëzimit penal nr. ***, datë 15.2.2017, deri në datën 21.9.2021, të kërkesës për pushimin e procedimit, çështja ka zgjatur mbi 4 vjet e 7 muaj, konkretisht:

ii) nga data e regjistrimit të kallëzimit penal nr. ***, datë 15.2.2017, deri në datën 20.6.2017 të bashkimit të procedimit penal nr. *** me procedimin penal nr. ***, datë 3.5.2017, në procedimin nr. ***, nuk rezultojn të jetë kryer asnjë veprim në kuadër të procedimit nr. ***, për të cilin nuk ka as datë; nga data 20.6.2017 deri më 8.5.2019 të bashkimit të procedimit nr.*** me procedimin nr. ***, çështja ka zgjatur më shumë se 2 vjet e 2 muaj dhe gjatë kësaj kohe vërehen intervale prej 3, 4 dhe 9 muaj, pa kryer ndonjë veprim hetimor;

iii) nga data 8.5.2019 e bashkimit të procedimeve nr. *** dhe nr. *** deri në datën e regjistrimit të emrave të personave nën hetim, rezultojn të jenë kryer veprime hetimore në intervale kohore nga 9 muaj, 5 muaj, 2 muaj;

iv) nga data 22.9.2020 e regjistrimit të emrave të personave nën hetim dhe deri në përfundim të afatit 3-mujor më 22.12.2020 të hetimeve paraprake është kryer vetëm një veprim hetimor datë 16.11.2020, ku është kërkuar informacion në AKBN;

v) pas përfundimit të afatit 3-mujor, subjekti ka vendosur zgjatjen e afateve tri herë të procedimit penal nr. ***, me të njëjtin arsyetim: *“Rezultojn se duhen kryer veprime hetimore të mëtijshme të nevojshme (një pjesë e veprimeve hetimore që duhen kryer janë kërkuar të kryhen nga shtetasi K. G., ndërsa veprime të tjera duhen kryer në varësi të rezultateve të veprimeve të kryera)*, pra pa përcaktuar se cilat veprime konkrete janë të nevojshme të kryhen. Ndërkohë:

- nga data 22.12.2020 deri më 16.3.2021 nuk rezultojn të jetë kryer ndonjë veprim hetimor;

- nga data 22.3.2020 deri më 22.6.2021 nuk rezultojn të jetë kryer ndonjë veprim hetimor në kuptim të grumbullimit të provave;

- nga data 22.6.2021 deri më 21.9.2021 nuk rezultojn të jetë kryer ndonjë veprim hetimor në kuptim të grumbullimit të provave.

¹⁰⁹Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 25.2.2021, në dosjen e Komisionit.

¹¹⁰Shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.6.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkuan sqarime dhe dokumente në lidhje me këto konstatime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

104.1. Në parashtrime subjekti ka paraqitur sqarime si vijon:

- Komisioni nuk ka në dispozicion gjithë dosjen e hetimeve të kësaj çështjeje në tërësi për shkak se me vendimin e datës 27.4.2021 është vendosur ndarja e procedimit penal në dy procedime, nr. *** dhe nr. ***, e cila aktualisht është nën hetim. Sipas subjektit, shumë akte të tjera procedurale, të cilat nuk janë pjesë e kërkesës për pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. ***, të vitit 2017, janë pjesë e fashikullit të hetimeve për procedimin penal nr. ***, të vitit 2021, në ngarkim shtetasit K. G. etj. Subjekti ka dhënë disa shpjegime të kufizuara për sa i ka kërkuar Komisioni, sipas tij, nga detyrimi për ruajtjen e sekretit hetimor. Subjekti paraqiti kthim përgjigje të Prokurorisë së Rrethit Tiranë datë 7.9.2022, sipas të cilit procedimi nr. *** ndodhet ende në fazën e hetimeve paraprake.

- Në lidhje me konstatimin se nga momenti i regjistrimit të procedimit penal deri në datën e bashkimit të këtyre procedimeve nuk është kryer ndonjë veprim hetimor, subjekti pretendon se është i pasaktë, pasi sipas tij, është dërguar letërporosia në fjalë dhe pritej përgjigje e saj.

- Subjekti pretendon se nga oficerët e policisë gjyqësore gjatë periudhës 2017 – 2019 janë kryer veprime hetimore për administrimin e një sasive voluminoze dokumentacioni.

- Sa i takon konstatimeve në pikat (iv) dhe (v) sipas të cilave, për periudhat në të cilat është zgjatur afati hetimor nuk janë kryer veprime hetimore, subjekti ka sqaruar se vetëm në periudhën e vendimeve të zgjatjes së afatit të hetimeve 22.9.2020 - 22.6.2021, janë pyetur prej tij shtetasit R. S. (datë 9.11.2020), I. B. (datë 17.12.2020), A. Ç. (datë 4.12.2020), A. Z. (në datat 24.11.2020 dhe datë 4.12.2020), si dhe është administruar një sasi e konsiderueshme dokumentacioni nga shtetasi Isuf Berberi, i cili normalisht kërkon kohë për t'u analizuar dhe verifikuar. Po kështu, gjatë kësaj periudhe, nga oficerët e policisë gjyqësore janë pyetur shtetasit Gj. D. (datë 20.1.2021), A. D. (datë 22.1.2021), O. V. (datë 13.4.2021), S. H. (datë 1.4.2021), Q. H. (datë 14.4.2021), R. I. (datë 15.4.2021), S. T. (datë 29.3.2021), S. T. (datë 29.3.2021), A. F. (datë 23.4.2021), E. G. (datë 23.4.2021), A. Z. (datë 1.4.2021), A. Ç (datë 1.4.2021), A. B. (datë 21.5.2021), D. D. (datë 16.4.2021), E. P. (datë 24.5.2021), G. Ll. (datë 25.10.2021) etj., që sipas subjektit ndodhen në dosjen e procedimit penal nr. ***.

- Ai ka sqaruar se për asnjë nga vendimet për zgjatjen e afatit të hetimeve për këtë procedim penal deri më tani nuk është ushtruar ankim nga personat nën hetim. Sa i takon këtij pretendimi të subjektit në dosjen e procedimit penal nr. ***, nuk rezulton të jenë ankimuar.

- Sa i takon shtetasit K. G., subjekti i rivlerësimit pretendon se ky shtetas ka paraqitur një memo në prokurori dhe se janë kryer një sërë veprimesh hetimore të kërkuara prej tij. Sipas tij, ky shtetas ka paraqitur edhe një kallëzim penal ndaj tij për të cilin është vendosur mosfillimi, duke vënë në dispozicion një kopje të fashikullit dhe se në dijeninë e tij ndaj këtij vendimi nuk është bërë ankim nga kallëzuesi.

Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti paraqiti: kthim përgjigje të Prokurorisë së Rrethit Tiranë datë 7.9.2022, sipas të cilit procedimi nr. *** ndodhet ende në fazën e hetimeve paraprake; dosjen e mosfillimit të hetimeve të kallëzimit penal nr. ***; si dhe shkresën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹¹¹ sipas së cilës nuk është bërë ankim nga gjykata kundër mosfillimit të hetimeve të kallëzimit penal nr. ***.

Vlerësimi i Komisionit

¹¹¹Shihni dokumentet e paraqitura nga subjekti, protokolluar me nr. ***, datë 13.9.2022, pranë Komisionit.

104.2. Në analizë të parashtrimeve të subjektit, në përfundim të procesit, u evidentua se pretendimet e subjektit qëndrojnë pjesërisht, ndërkohë që ngelen problematikat si vijojnë:

- Pretendimi sipas të cilit, pas regjistrimit të procedimit penal nr. ***, datë 22.2.2017, deri më 20.6.2017, ka kryer veprime hetimore, me argumentin se në datën 17.5.2017 i ka dërguar autoriteteve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës kërkesë për ndihmë juridike, është i pabazuar, pasi kjo letërporosi është dërguar në kuadër të procedimit nr. ***.

- Subjekti nuk ka kryer veprime hetimore për periudha kohore që variojnë nga 9 muaj, 5 muaj, 4 muaj, 3 muaj, afate të cilat nuk mund të justifikohem me ngarkesën në punë apo volumin e dokumentacionit, sidomos në kushtet kur subjekti në mënyrë të përsëritur rezulton të ketë pasur tejkalime të afateve që kanë çuar në zvarritje të hetimeve. Sa i takon pretendimit se gjatë periudhës 20.6.2017 – 22.9.2020 janë kryer disa veprime hetimore, të cilat ndodhen në dosjen penale nr. *** dhe për shkak të ruajtjes së sekretit hetimor nuk mund t'i vëre në dispozicion të Komisionit, vlerësohet si një justifikim nga ana e subjektit, pasi ai nuk ka bërë asnjë përcapje për të vërtetuar se veprimet hetimore të kryera përbejnë sekret hetimor. Për më tepër veprimet hetimore i përkisnin çështjes nr. ***, e cila ishte mbyllur në datën 21.9.2021, kur subjekti ka kërkuar pushimin e këtij procedimi penal. Po kështu, pretendimi i subjektit që veprimet hetimore i kanë kaluar çështjes nr. ***, e cila u vërtetua të jetë në shqyrtim e sipër, mbeten në nivel deklarativ.

- Në lidhje me konstatimin se pas regjistrimit të emrave të personave nën hetim datë 22.9.2020 deri më 22.6.2021 nuk ka kryer veprime hetimore, subjekti ka sqaruar në lidhje me disa veprime të kryera prej tij, por nuk i ka vërtetuar veprimet hetimore të pretenduara, po me të njëjtin arsyetim se veprimet e dokumentuara ndodhen në dosjen e procedimit penal nr. ***.

- Sa i takon vendimit të tretë të zgjatjes së afatit të hetimeve, rezulton se në datën 27.4.2021, subjekti i rivlerësimit ka vendosur ndarjen e procedimit penal në procedimin me nr. *** në ngarkim të shtetasve I. B. dhe R. S.i, duke arsyetuar se për këta shtetas kanë përfunduar hetimet, si dhe, atë me nr. ***, në ngarkim të shtetasit K. G. etj., me arsyetimin se për këta shtetas është e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore; (ii) në datat 11/12.5.2021 ka njoftuar shtetasit I. B. dhe R. S. për përfundimin e hetimeve të procedimit nr.***. Pra, siç shihet edhe pas përfundimit të hetimeve të këtij procedimi, subjekti sërish në datën 22.6.2021 vendos zgjatjen e afatit të hetimeve të procedimit penal nr. *** deri më 22.9.2021, me të njëjtin argument si dy vendimet e mëparshme, pa kryer veprime hetimore. Në parashtrime, subjekti nuk ka dhënë asnjë sqarim në lidhje me këtë konstatim. Në këto kushte, zgjatja e afateve vlerësohet e pajustificuar objektivisht dhe ligjërisht, bazuar në kërkesat e nenit 324/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se në trajtimin e procedimit penal nr. *** konstatohen disa periudha kohore relativisht të gjata pa kryer veprime hetimore në mënyrë të vijueshme, si dhe ka pasur zgjatje të hetimeve pa shkaqe legjitime afatet hetimore, të cilat kanë çuar në zvarritje të hetimeve nga ana e subjektit. Këto shkelje janë të përsëritura nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar të çështjes. Pretendimet e denoncuesit në lidhje me korrupsionin mbeten të pavërtetuara.

105. Denoncim nga shtetasja D. Xh.¹¹²

Denoncuesja ngre pretendimin për falsifikim, pengimin e ardhjes së të vërtetës dhe shpërdorim detyre ndaj prokurorit Julian Xhengo, si dhe zvarritje të hetimit në lidhje me procedimin penal nr. ***, për kallëzimin e denoncueses ndaj OPGJ-së O. Gj., për manipulim dhe falsifikim të provave për ngjarjen e aksidentit, ku ka ndërruar jetë bashkëshorti i saj në vitin 2015. Denoncuesja pretendon se edhe pse kishin kaluar 3 vjet, subjekti nuk kishte bërë asnjë veprim dhe nuk ishte njoftuar nga prokurori mbi vendimin për mosfillim të hetimit për kallëzimin penal

¹¹²Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 8.7.2021, në dosjen e Komisionit.

nr. *** dhe pas insistimit të saj i është dërguar në vitin 2021. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi veprimet e kryera në lidhje me zvarritjen e afateve hetimore, si dhe sa i takon njoftimit të vendimit të mosfillimit për kallëzimin penal nr.*** duke shoqëruar me aktet e dosjes.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

105.1 Në parashtrime subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore¹¹³, si dhe ka parashtruar si vijon:

Në lidhje me pretendimin e ngritur në kallëzim mbi veprimet e OPGJ-së O. Gj., sipas subjektit është vendosur mosfillimi i procedimit penal me arsyetimin se nuk ka pasur elemente të veprës penale dhe ky konstatim është gjetur i drejtë edhe nga gjykata pas shqyrtimit gjyqësor. Në lidhje me pretendimin tjetër të ngritur në kallëzim, mbi përpilimin e praktikave të rreme nga ana e punonjësve doganorë, subjekti nuk ka dhënë sqarime mbi verifikimet e kryera prej tij, ndërkohë që ka informuar se lidhur me këtë pretendim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** regj., datë 30.3.202, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për të vijuar hetimin. Siç vërehet në këtë vendim, Gjykata, ndër të tjera, ka arsyetuar se: *“... jo të gjitha pretendimet e ngritura në kallëzim i janë nënshtruar procedurave ligjore verifikuese, konkretisht, nuk janë verifikuar pretendimet e kallëzueses për praktikën e kamionit tranzit, pretendime të konstatuara nga prokurori”*. Pra, subjekti, nuk ka dhënë asnjë sqarim në lidhje me këtë konstatim të gjykatës, i cili tregon një mosveprim prej tij.

105.2. Në lidhje me njoftimin e vendimit të mosfillimit të hetimeve shtetases D. Xh., subjekti ka sqaruar se pavarësisht se njoftimi i personave është pjesë e veprimtarisë së administratës, kjo shtetase ka paraqitur ankim ndaj vendimit të mosfillimit të hetimeve dhe se Gjykata ka vendosur shfuqizimin e vendimit të prokurorisë dhe urdhërimin për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”. Sipas tij, fakti që kjo shtetase ka marrë dijeni për vendimin, konfirmohet nga fakti që ajo ka paraqitur ankim në gjykatë kundër këtij vendimi. Subjekti ka sqaruar se kjo çështje është nën hetim dhe në këtë pikë kërkon mirëkuptimin e Komisionit për pamundësinë e dhënies së informacioneve në lidhje me veprimet hetimore të kryera.

Vlerësimi i Komisionit

Në analizë të pretendimeve të subjektit dhe dosjes së paraqitur nga subjekti, nuk rezultojnë shpresa përcjellëse për njoftimin e vendimit, si dhe nuk rezultojnë të jetë e dokumentuar marrja dijeni e këtij vendimi. Pretendimi se është detyrë e administratës të njoftojë vendimin, nuk vlerësohet tërësisht i bazuar, pasi është detyrë e prokurorit të mbikëqyrë dërgimin pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit, sipas parashikimit të nenit 291/2 të Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton qartë se vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit. Subjekti duhet të kishte marrë të gjitha masat për të mikqyruar njoftimin e kallëzueses mbi vendimin e mosfillimit të procedimit penal. Këto mosveprime të subjektit, të cilat kanë sjellë si pasojë mosushtrimin e të drejtës së ankimit në kohë ndaj këtij vendimi nga ana e kallëzueses dhe, si pasojë, tejzgjatjen e procesit të saj në dyert e drejtësisë, janë marrë në konsideratë në vlerësimin përfundimtar të aftësive profesionale të subjektit.

Gjithashtu, nga Komisioni vlerësohet se në këtë çështje nga ana e subjektit duhet të ishte kryer verifikimi i çdo pretendimi të ngritur në kallëzimin penal nr. ***, gjë që nuk e ka bërë, sikurse

¹¹³Shihni dosjen e mosfillimit të hetimeve të kallëzimit nr. ***, vendimin nr. *** regj. datë 30.3.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shkresën e Prokurorisë së Rrethit Tiranë sipas të cilit rezultojnë se më 7.5.2021 është regjistruar procedimi penal nr. *** mbi bazën e kallëzimit nr. *** të shtetases D. Xh. dhe se çështja ndodhet në fazën e hetimeve paraprake.

edhe gjykata evidenton. Konkretisht, sikurse është konstatuar edhe nga subjekti në vendimin e mosfillimit të procedimit penal, duhet të ishin kryer verifikime mbi praktikat e punonjësve të doganës.

Sa i takon procedimit penal nr. *** mbi bazën e kallëzimit nr. *** të shtetases D. Xh., bazuar në nenin E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë, i cili parashikon se vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, nga ana e Komisionit ky procedim penal nuk iu nënshtrua procesit të rivlerësimit.

Analizë e dosjes së shoqërisë “**” sh.p.k.**

106. Denoncim nga shtetasi Q. B.¹¹⁴

Denoncuesi ngre pretendimin për korrupsion ndaj subjektit dhe dy gjyqtarëve, sa i takon kallëzimit nga ana e tij për punonjësit e AKBN-së, për shpërdorim detyre, testim investimesh të pakryera fatura dhe situacione fiktive për shoqërinë “****” sh.p.k. Bashkëngjitur ka paraqitur kopje kontrate datë 30.11.2010 mes palëve “****” sh.p.k. dhe personit fizik “****”, situacion punimesh Refraktare sh.a dhe faturë tatimore. Me kërkesë të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹¹⁵ vuri në dispozicion fashikujt e procedimit penal nr. ***. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes rezultoi se:

- Në datën 12.7.2013 është regjistruar kallëzimi penal nr. *** i shtetasit Q. B., më 22.11.2013 prokurori Julian Xhengo ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal pa autor, për veprën penale “shpërdorim të detyrës”, më 1.9.2014 prokurori Julian Xhengo ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, duke konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

- Pas ankimit të kallëzuesit, Drejtori i Drejtorisë së Hetimit të Krimit Ekonomik Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në Prokurorinë e Përgjithshme, në datën 18.11.2014 ka vendosur shfuqizimin e vendimit për pushimin e procedimit penal nr. ***, pasi ky vendim është marrë pa u kryer një hetim i plotë në lidhje me gjithë pretendimet e kallëzuesit.

Pas shfuqizimit të vendimit, nga ana e subjektit rezulton të jenë kryer disa veprime hetimore në funksion të plotësimit të hetimeve dhe në datën 23.4.2015 ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

- Nga të dhënat e raportit profesional rezulton se denoncuesi ka ushtruar ankim dhe vendimi i pushimit të subjektit të rivlerësimit është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor në të dyja shkallët, duke e lënë në fuqi, ndërsa ILD-ja¹¹⁶ ka informuar se shtetasi Q. B. ka paraqitur kallëzim penal në SPAK, i cili është përcjellë për trajtim të mëtejshëm pranë ILD-së dhe ankesa është në fazën e shqyrtimit fillestar.

106.1. Në përfundim të hetimit administrativ, nga shqyrtimi i akteve të dosjes, duket se:

i) regjistrimi i procedimit penal është bërë mbi 4 muaj pas regjistrimit të kallëzimit penal, pra tej afatit 30-ditor;

ii) nga regjistrimi i procedimit penal në datën 22.11.2013, deri në datën e pushimit të procedimit penal 23.4.2015, çështja ka zgjatur 1 vit e 5 muaj, pasi regjistrimi i procedimit është bërë pa autor dhe, për rrjedhojë, nuk ndodhet përpara kërkesave të nenit 323/1 të Kodit të Procedurës Penale për kryerjen e hetimeve paraprake brenda një afati 3 muaj. Duket se ka pasur zvarritje të hetimeve si pasojë e veprimeve hetimore të ndërmarra në intervale kohore nga 1 muaj deri në 4 muaj, jo në mënyrë dinamike dhe të vijueshme, si dhe ka moskryerje të hetimeve të plota në tërësinë e zbardhjes së pretendimeve të kallëzuesit të veprës penale;

¹¹⁴Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 26.10.2021, në dosjen e Komisionit.

¹¹⁵Shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.6.2018 dhe shkresën nr. *** prot., datë 6.6.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

¹¹⁶Shihni shkresën nr. *** prot., datë 7.4.2022, të Zyrës së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, në dosjen e Komisionit.

- iii) prokurori nuk është shprehur me vendim në lidhje me memot e paraqitura nga kallëzuesi në përputhje me nenin 110/2 të Kodit të Procedurës Penale;
- iv) edhe pas konstatimit në vendimin e shfuqizimit të vendimit datë 1.9.2014, prokurori sërish nuk analizon veprimet konkrete të kryera, të cilat nuk parashikohen nga ligji si veprë penale dhe cili element i figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës për të cilin është hetuar, mungon në rastin konkret.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektivit iu kërkuan sqarime dhe dokumente në lidhje me këto konstatime:

Qëndrimi i subjektivit të rivlerësimit

106.2. Në parashtrime subjektivit ka paraqitur argumentet, si vijojnë:

- Në lidhje me regjistrimin e procedimit penal 4 muaj pas regjistrimit të kallëzimit penal, subjektivit sqaroi se: së pari, nga zv/Drejtuuesi i Prokurorisë rezulton se këtë material ai e ka dërguar në sekretarinë e Prokurorisë në datën 19.7.2013 dhe në cepin e majtë të këtij formulari është shënuar “Prokurori është me leje”, por ai nuk mban mend nëse në atë periudhë ka qenë me lejen e zakonshme vjetore apo jo. Së dyti, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore janë kryer veprimet hetimore të deleguara.

- Në lidhje me konstatimin se ka zvarritje të hetimeve së pari, sqaron se veprimet hetimore janë kryer dhe është marrë vendim për pushimin e hetimeve në datën 1.9.2014. Pra, hetimet janë kryer për një afat prej afërsisht 10 muaj nga regjistrimi i procedimit penal, si dhe nëse shihen statistikatat e prokurorisë për çështje të ngjashme, një afat i tillë është afati mesatar i hetimit të dosjeve të ngjashme.

- Në lidhje me konstatimin se prokurori nuk është shprehur me vendim në lidhje me memot e paraqitura nga kallëzuesi, subjektivit ka sqaruar se çdo pretendim i ngritur nga kallëzuesi në memo është marrë parasysh dhe është trajtuar gjatë hetimit të çështjes dhe në vendimmarrjen në përfundim të hetimit.

- Në lidhje me konstatimin se nuk janë kryer hetime të plota në tërësinë e zbardhjes së pretendimeve të kallëzuesit sqaron se ky konstatim është i pabazuar për shkak se hetimet janë kryer të plota duke theksuar se vendimi për pushimin e hetimeve, mbi bazën e ankimit të kallëzuesit, i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe se gjykata ka lënë në fuqi këtë vendim.

Në mbështetje të pretendimeve, subjektivit ka paraqitur fashikullin e pushimit të procedimit penal nr. *** dhe procesverbalet e seancave gjyqësore, vendimin nr. ***, datë 28.6.2022, të ILD-së për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të paraqitura nga shtetasi Q.B. ndaj subjektivit dhe gjyqtarëve, duke u shprehur se Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 27.9.2017, ka lënë në fuqi vendimin nr. *** akti, datë 28.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka rrezuar kërkesën e Q. B. për shfuqizimin e vendimit datë 23.4.2015 për pushimin e procedimit penal nr. ***.

Vlerësimi i Komisionit

106.3. Në analizë të parashtrimeve të subjektivit, në përfundim të procesit, u evidentua se pretendimet e subjektivit qëndrojnë pjesërisht, ndërkohë që ngelen problematikat si vijojnë:

- Subjektivit ka regjistruar procedimin penal pas një kohe relativisht të gjatë, tej afatit 30-ditor, pa arsye të legjitimuara dhe të justifikuara, ndërkohë që në bazë të udhëzimit nr. ***, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, kërkohet kryerja e një minimumi verifikimesh dhe afati i regjistrimit të procedimit është maksimumi 30 ditë.

- Nga regjistrimi i procedimit dhe deri në pushimin e tij datë 1.9.2014 vërehen periudha prej 3 muaj pa kryer veprime hetimore, si dhe pa kryer verifikime të plota për pretendimet e ngritura

në kallëzim, ashtu siç u konstatua nga vendimi i Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit të Krimin Ekonomik Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në Prokurorinë e Përgjithshme.

- Subjekti nuk shprehet me vendim në lidhje me memot e paraqitura nga palët, sikurse parashikon neni 110 i Kodit të Procedurës Penale: *“1. Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim. 2. Organi procedues shprehet me vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve”*.

Këto shkelje janë të përsëritura nga subjekti i rivlerësimit dhe janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar të çështjes.

Pretendimet e denoncuesit në lidhje me korrupsionin, mbeten të pavërtetuara. Në lidhje me pretendimet për vendimmarrje të gabuar, vlerësimin e provave, në zbatim të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, është jashtë tagrit të Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit, themelin e çështjes apo të vlerësojë interpretimin ose logjikën e prokurorit.

Informacion i marrë nga Ministria e Drejtësisë¹¹⁷

107. Me kërkesë të Komisionit, Ministria e Drejtësisë ka informuar Komisionin se për subjektin e rivlerësimit Julian Xhengo, pas verifikimeve të kryera, janë evidentuar ankesat si vijojnë: (i) ankesa nr. *** prot., datë 4.10.2019, e shtetasit Suri Topi dhe shkresa kthim përgjigje, me anë të së cilës informohet se lidhur me ekzistencën e ndonjë shkeljeje të mundshme, kjo kompetencë i ka kaluar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; (ii) ankesa nr. *** prot., datë 16.9.2020, e shtetasit S. S. dhe shkresa kthim përgjigje me anë të së cilës është informuar se për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj prokurorëve është Inspektori i Lartë i Drejtësisë institucioni përgjegjës; (iii) ankesa nr. *** prot., datë 24.12.2020, e shtetas M. P. dhe shkresa drejtuar ILD-së për verifikim ankese. (iv) ankesa nr. *** prot., datë 13.4.2021, e shtetasit S. T. dhe shkresa kthim përgjigje me anë të së cilës është informuar se lidhur me pretendimet për zvarritje të hetimeve nga ana e prokurorit është Inspektori i Lartë i Drejtësisë institucioni përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor. Ankesa rezulton t'i jetë drejtuar edhe ILD-së.

107.1. Në lidhje me verifikimin e ankesave të mësipërme, si dhe ankesave të tjera të mundshme, iu kërkua informacion mbi shqyrtimin dhe hetimin e tyre nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e cila ka informuar¹¹⁸ se:

- Ankesat e shtetasit S.T. ndodhen në fazën e shqyrtimit fillestar.
- Ankesa e shtetasit S. S., pas shqyrtimit fillestar është vendosur arkivimi i ankesës. Ankesat e znj. M. P. dhe z. I. S., pas shqyrtimit fillestar është vendosur arkivimi i ankesës.
- Ankuesi K. Z. është drejtuar me ankesë “kallëzim penal”.
- Ankuesi Q. B. ka depozituar në SPAK kallëzimin penal, i cili është përcjellë pranë saj.
- Ankuesja Ë. H. dhe këto ankesa ndodhen në fazën e shqyrtimit fillestar.
- Ankuesit Ë. L. dhe Y. H. janë drejtuar me ankesa, për të cilat pas shqyrtimit fillestar është vendosur arkivimi i tyre.
- Shtetasit D. D., N. Gj. dhe K. Ç. kanë paraqitur ankesa dhe ndodhen në fazën e shqyrtimit fillestar.

107.2. Sa më sipër, në lidhje me ankesat e shtetasve S. T., K. Z., Q. B., E. H., Ë. L. dhe Y. H., duke qenë se kanë paraqitur denoncime pranë Komisionit, ato janë trajtuar edhe te shqyrtimi i

¹¹⁷Shihni shkresën nr. *** prot., datë 8.6.2021, të MD-së, në dosjen e Komisionit.

¹¹⁸Shihni shkresën nr. *** prot., datë 7.4.2022, të Zyrës së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, në dosjen e Komisionit.

denoncimeve të publikut. Sa i takon ankesave të shtetasve S. S. dhe M. P., nga Komisioni nuk u vlerësua e nevojshme kryerja e verifikimeve të mëtejshme.

Rivlerësimi profesional sipas kritereve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

108. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, në mënyrë të përmbledhur për subjektin e rivlerësimit u konstatua se:

- Subjekti ka zvarritur në mënyrë të përsëritur hetimin e çështjeve penale pasi:

i) Në mënyrë të përsëritur regjistrimi i procedimit penal është kryer tej afateve ligjore pa shkaqe të justifikuara ligjërisht.

ii) Në mënyrë të përsëritur pas regjistrimit të procedimit penal, pavarësisht se subjekti nuk ka regjistruar emrat e personave që i atribuohet vepra penale, moment nga i cili do të fillonte afati i hetimeve sipas parashikimit të nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale, ka zvarritje në kryerjen e hetimeve, pasi për periudha kohore relativisht të gjata dhe pa shkaqe të justifikuara, subjekti nuk kryen asnjë veprim hetimor.

iii) Në mënyrë të përsëritur ka zgjatur afatet e hetimeve pa shkaqe ligjore dhe me të njëjtin arsyetim të marrë me *copy paste* nga vendimet e para, ndërkohë që nuk ka kryer asnjë veprim hetimor pas marrjes së këtyre vendimeve.

- Në shqyrtimin e një çështjeje penale në gjykatë nuk ka marrë pjesë në 22 seanca dëgjimore, pa vërtetuar/dokumentuar mospjesëmarrjen për shkaqe të justifikuara ligjërisht dhe objektivisht (me përjashtim të një rasti).

- Janë evidentuar dy çështje penale ku subjekti nuk shprehet me vendim në lidhje me memot e paraqitura nga palët, sikurse parashikon neni 110 i Kodit të Procedurës Penale.

- Në një rast është gjendur në kushtet e konfliktit në dukje të interesit dhe ushtrimit të detyrës në kundërshtim me ligjin.

- Janë evidentuar mangësi të tjera të trajtuara në mënyrë të detajuar në këtë vendim, të cilat tregojnë një mënyrë pune jo efektive dhe me mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.

109. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas kritereve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 2, të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe pasi dëgjoi relatorin e çështjes, e cila sipas detyrimit ligjor të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, ka propozuar vlerësimin e subjektit “i paaftë” Komisioni vlerësoi se:

i) subjekti nuk ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016;

ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016;

iii) subjekti i rivlerësimit ka cenuar etikën e prokurorit dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, jo vetëm se në një rast është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit duke ushtruar detyrën në kundërshtim me nenin 4/2 të ligjit nr. 96/2016, por edhe për shkak të mangësive të tij të përsëritura në drejtim të aftësive profesionale dhe organizative;

iv) mangësitë e vërejtura të cilat tregojnë një cilësi të papranueshme në pune, hetim të dobët dhe mungesë efektiviteti/eficiencë, jo vetëm që e bëjnë atë të papërshtatshëm sipas parashikimit të germës “c” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, por, nga ana e Komisionit vlerësohet se ato nuk mund të korrigjohen përmes programit njëvjeçar të edukimit. Në këtë rast, sipas parashikimit të pikës 4 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

IV. SEANCA DËGJIMORE

110. Në datën 9.9.2022, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Julian Xhengo, në përfundim të së cilës, kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Julian Xhengo dhe shpalli vendimin në seancën e datës 14.9.2022, sipas pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

V. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

111. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, si dhe gjatë seancës dëgjimore. Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë i gatshëm dhe bashkëpunues pasi i është përgjigjur brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë shpjegime shpesh jo në mënyrë shteruese për informacionin e kërkuar, sidomos në lidhje me pretendimet e ngritura në disa nga denoncimet. Këto elemente janë mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

VI. KONKLuzion PËRFUNDIMTAR

112. Bazuar në parimet e parashikuara në pikën 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në Aneksin e Kushtetutës dhe në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi që vendimmarrja për subjektin Julian Xhengo të bazohet në përfundimet e arritura në lidhje me kriterin e pasurisë së figurës dhe atë të vlerësimit profesional, si dhe në vlerësimin tërësor të procedurave sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2014. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se:

- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Julian Xhengo rezultoi i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016.

- Nga vlerësimi tërësor i rrethanave, në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, janë vërtetuar fakte dhe rrethana, që tregojnë se subjekti i rivlerësimit Julian Xhengo ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, pasi u mbledh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit në pikat 4 dhe 5 të nenit 61, pikat 6 dhe 7 të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “c”, të pikës 1, të nenit 58 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Julian Xhengo, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 14.9.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese

Firdes SHULI
Relatore

Olsi Komici
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Ertugena Sokoli